ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues • Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 16 JANAR 2021. NUMËR 113. VITI IV I BOTIMIT. ÇMIMI 50 LEKË. WWW.EXLIBRIS.AL EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL BOTIM I ONUFRI SHPK

NESËR 553-VJETORI I VDEKJES SË HEROIT TONË KOMBËTAR

Kësaj periudhe të fundshekullit XVIII i përket edhe vepra letrare në dorëshkrim, e pabotuar dhe e panjohur deri më sot, për të cilën duam të njoftojmë për të parën herë lexuesit e revistës *ExLibris*, në pritje që të përgatitet një botim kritik i saj. Kjo vepër nuk është përfshirë në repertorët bibliografikë skënderbegianë, sepse është zbuluar këto kohët e fundit.

NJË VEPËR E PANJOHUR MBI SKËNDERBEUN

Nga Matteo Mandalà



Croia ricuperata, "L'autore a chi legge", f. 1v

NJERIU, LIBRI DHE KULTURA NË NJË DITË DIMRI

nga Xhevair Lleshi (fq. 5)

Ecën në shëtitoren rreth e qark liqenit të Tiranës, e cila për fat është bërë e re, por që megjithatë duket sikur është restauruar diçka që buron nga kultura e vjetër, gjë që nuk është e vërtetë. Por sa do të donim të qe e tillë! Deri këtu, pavarësisht hamendësimit, s'ka asgjë të keqe...

Duhet t'i hapim dyert pa i rënë ziles!

VIRION GRAÇI LULZIM HAZIRI

Dialog për letërsinë shqipe

SHËNIME PËR LIBRAT

AZEM DELIU

Puthësi i paligjshëm/Shënimet e krimbit Smolinski

nga Ballsor Hoxha (fq. 12)

ERNEST MARKU

"Libri i Fishtës"

nga Prend Buzhala (fq. 10)

MATTEO MANDALÀ

"Mitet e historiografisë arbëreshe"

nga Zija Çela (fq. 11)

PSE DUHET TË LEXOJMË KADARENË?

Nga David Bellos (fq. 19)

Arsyeja kryesore dhe më e rëndësishmja pse duhet të lexojmë Kadarenë është se ai është një rrëfimtar i shkëlqyer. Rrëfen histori të mrekullueshme - dhe rrëfen shumë.

BIBLIOTEKË

Mirash Martinoviq (fq. 9)

Valltarja në gurë

James Joyce (fq. 22)

Eveline

Luljeta Lleshanaku nominohet për çmimin "Poeti Europian i Lirisë 2022" në Poloni

(fq. 21)

Radikalizmi i Charles Dickens

Nga GARETH JENKINS



(fq. 20)

Loja e vdekjes dhe e përjetësisë në lirikën dashurore të Fatos Arapit

nga Alisa Velaj (fq. 14)

Dashuria është vetë koha dhe koha merr trajtë vetëm e vetëm falë dashurisë. Poeti është gati ta ndalë kohën për të shpejtuar ardhjen e asaj....

Gjuhëtari dhe studiuesi i famshëm belg

NJË VËSHTRIM PAS: ÇFARË QE E RËNDËSISHME NË JETËN TIME AKADEMIKE?

nga Jan Blommaert (fq. 16)

(4 nëntor 1961 - 7 janar 2021)

Kësaj periudhe të fundshekullit XVIII i përket edhe vepra letrare në dorëshkrim, e pabotuar dhe e panjohur deri më sot, për të cilën duam të njoftojmë për të parën herë lexuesit e revistës *ExLibris*, në pritje që të përgatitet një botim kritik i saj. Kjo vepër nuk është përfshirë në repertorët bibliografikë skënderbegianë, sepse është zbuluar këto kohët e fundit.

NJË VEPËR E PANJOHUR MBI SKËNDERBEUN

"Croia ricuperata, overo il Gran Scanderbeg. Poema eroico."

Nga Matteo Mandalà

Lucio Doglioni Cadola (1730-1803)

Gjatë përgatitjeve për kremtimin e 550 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastriotit katedra e albanologjisë pranë universitetit të Palermos nisi një fushatë kërkimesh mbi veprat, e njohura e të panjohura, kushtuar figurës së heroit kombëtar shqiptar. Ky projekt, që shkonte përtej një kërkimi të thjeshtë bibliografik, synonte të hulumtonte procesin e shndërrimit letrar të heroit shqiptar nga shkrimtarët dhe poetët në gjuhën italiane. Në qendër të kërkimit u vunë edhe veprat e autorëve si Matteo Maria Boiardo, Ludovico Ariosto dhe Torquato Tasso, të cilët qenë nismëtarët e gjinisë letrare epiko-kalorësiake dhe me gjuhën e tyre poetike dominuan letërsinë italiane gjatë periudhave të humanizmit, rilindjes dhe barokut, duke përhapur stereotipat e idealeve kalorësiake që do të përfshinin edhe imazhin e Skënderbeut.

Të ngjizura në valën e kërcënimit osman që terrorizoi botën perëndimore, këto vepra rrëfenin episode historike ose duke u bazuar në to rikrijonin rrëfenja betejash epike mes ushtrish dhe fuqish që përfaqësonin besime fetare dhe tradita kulturore të ndryshme. Personazhet ishin shpesh të stisura ose ndonjëherë portretizoheshin sipas të dhënave pak a shumë realiste që buronin nga kronikat e kohës ose nga rrëfimet e udhëtarëve. Domethënëse janë, për shembull, referimet e hapura ndaj *stradiotëve*, që identifikoheshin shpesh si shqiptarë, dhe që mbushnin vepra të suksesshme me përhapje të gjerë për kohën, si p.sh. romani *Guerrin Meschino* i njohur ndryshe me titullin *Il Meschino da Durazzo* që shkroi Andrea da Barberino rreth vitit 1410, por që u botua vetëm në vitin 1473; ose poezia e përhapur gjerësisht që u kushtohej bëmave të *Manoli Blessi*-t dhe që ishte një lloj parodie e veprave të Boiardo-s dhe Ariosto-s; ose poema *Jeruzalemi i çliruar*, ku Tasso portretizonte me nota ekzotike luftëtarët që vinin nga Ballkani.

Të tjera vepra që shquhen për cilësinë e lartë artistike, kanë meritën se ushqyen mitin letrar të Skënderbeut njëkohësisht me rrëfimet e suksesshme të Ariosto-s dhe Tasso-s. Në këtë kontekst spikatin, nga njëra anë, *Dy këngët e*

GVERRINO DET-
TO IL MESCHINO,
CON ACCVRATISSIMA
diligenza nuouamente corretto.
di maniera che in ogni ſua
parte e fatto chiaro,
& illuſtre.
IL CONTENVTO NELL'OPE-
ra leggeſi nella faccia ſeguente.


SCANDERBEG
PRINCIPE D' ALBANIA
AZIONE ACCADEMICA
DA RAPPRESENTARSI
NEL GIORNO NATALIZIO
Dell' Altezza Sereniſſima
DI
FRANCESCO
TERZO
DUCA DI MODENA, REGGIO, MIRANDOLA ec.
Nel Domeſtico Teatro
COMPOSTA, RECITATA, E DEDICATA
Alla medeſima
SERENISSIMA ALTEZZA
DA' SIGNORI CONVITTORI
DEL COLLEGIO DE' NOBILI DI MODENA
L' ANNO MDCCLXX.
In MODENA, per gli Eredi di Bartolomeo Soliani Stampatori Ducali. Con licenza de' Superiori.

poemës heroike të *Skënderbeut* (*Due canti del Poema heroico di Scanderbec*), shkuar nga Baldassarre Scaramelli dhe që panë dritën e shtypit në vitin 1585 në dy botime të ndryshme; nga ana tjetër poema e gjatë heroike *Scanderbeide* për hartimin e së cilës autorja Margherita Sarrocchi (1560-1617), mike e ngushtë e Torquato Tasso-s dhe e Galileo Galileit, punoi intensivisht duke na lënë një version të pabotuar në dorëshkrim, si edhe tri botime (1606, 1623, 1702), nga të cilat dy të fundit panë dritë pas vdekjes së autores.

Suksesi i mitit të Skënderbeut nuk u kufizua vetëm në periudhën gjatë së cilës lulëzoi tradita e letërsisë kalorësiake, por u shtri edhe gjatë shekujve që vijuan, duke u kthyer në modë thuajse gjithmonë në momente krizash dhe konfliktesh të armatosura mes Europës perëndimore dhe Perandorisë Osmane, kur rizgjoheshin idealet kalorësiake të Rilindjes europiane. Gjatë shek. XVIII ishte teatri ai që e lartësoi dhe e vuri në qendër heroin shqiptar: përveç *dramës muzikore* të famshme që kompozoi në vitin 1718 Antonio Vivaldi mbi libretin *Scanderbeg* të Antonio Salvit, pati edhe disa vepra të tjera kushtuar Gjergj Kastriotit që nxitën interesin dhe admirimin e publikut italian. Përmendim këtu operën komike të Antonio Zaniboni-t *Bëmat e Princit Skënderbeg* (*Le valorose azioni del Principe Scanderbech*, 1730), dhe dy vepra dramaturgjike që u vunë në skenë në *Collegio de' Nobili* në Modena: vepra e parë mban titullin "Aleksandri, Zoti i Shqipërisë" (*Alessandro Signor d'Albania* - 1737) ndërsa e dyta titullohet *Skënderbeu, Princi i Shqipërisë* (*Scanderbeg Principe d'Albania* - 1770).

Kësaj periudhe të fundshekullit XVIII i përket edhe vepra letrare në dorëshkrim, e pabotuar dhe e panjohur deri më sot, për të cilën duam të njoftojmë për të parën herë lexuesit e revistës *ExLibris*, në pritje që të përgatitet një botim kritik

I FATTI,
E LE PRODEZZE
DI MANOLI BLESSI
STRATHIOTO,
DI M. ANTONIO MOLINO,
DETTO BVRCHIELLA.
CON PRIVILEGIO.
ETERNA
IN VINEGIA APPRESSO GABRIEL GIOLITO DE' FERRARI, M D L X I.

i saj. Kjo vepër nuk është përfshirë në repertorët bibliografikë skënderbegianë, sepse është zbuluar këto kohët e fundit. Sot kopja digjitale e dorëshkrimit është vënë në dispozicion të studiuesve falë nismës së drejtorit të Bibliotekës *Civica* në Belluno, z. Giovanni Grazioli, të cilin gjej rastin të falënderoj për bashkëpunimin dhe gatishmërinë për të promovuar botimin kritik të poemës. Lajmin për ekzistencën e saj e mora nga një skedë katalogu, hartuar në vitin 2006 nga Roberta Sarzetto dhe botuar në qershor të vitit 2009 në sitin zyrtar të Krahinës së Venecias. Skeda e përshkruante hollësisht dorëshkrimin me të dhëna të sakta për numrin dhe përmasat e fletëve, përmbajtjen, gjendjen e ruajtjes, si edhe parashtronte disa hipoteza mbi autorësinë bazuar në disa shënime në faqet e ballinës së parme dhe të prapme.

Titulli i veprës përsëritet disa herë: shfaqet fillimisht i paplotë mbi ballinë: *Croia ricuperata*; pastaj shfaqet në fl. 1r tashmë në formë të plotë, shkruar nga një dorë tjetër dhe me bojë të ndryshme nga pjesa tjetër e dorëshkrimit: *Croia ricuperata, overo il gran Schanderbehc. Poema eroico di auttore bellunese, con gli argomenti del medesimo auttore*. Së fundi, titulli, që ne e konsiderojmë autograf, shfaqet në fl. 3r me disa variante grafike interesante: *Croia ricuperata, overo il Gran Scanderbeg. Poema eroico*. Vijon nëntitulli shkruar me të njëjtën bojë dhe nga e njëjta dorë që ka shkruar titullin në fl. 1r: *Bellunese, con gli argomenti del medesimo autore*. Kjo hollësi është

e rëndësishme sepse na bën të mendojmë se titulli autograf origjinal është pikërisht ai i fl. 3r, ku shfaqen disa emra të cilët, sikurse e thotë me të drejtë edhe Sarzetto, mund t'i referohen qoftë autorit të dorëshkrimit, qoftë pronarit të tij. Këtij problemi do të përpiqemi t'i japim zgjidhje vetëm pasi të kemi sqaruar disa aspekte të tjera që kanë të bëjnë me tekstin. Me siguri dorëshkrimi ishte në zotërim të një dere të fisme nga Belluno, të familjes Doglioni Cadola, pasi emrat e tre anëtarëve saj, Giulio, Giuseppe dhe Lucio, hasen përkatësisht në ballinë dhe në fl. 1r: paçka se janë shkruar në mënyra të ndryshme dhe ndoshta janë të gjithë autografë, ka gjasa që Giulio të mos ketë pasur marrëdhënie të drejtpërdrejta me dorëshkrimin, ndërsa Giuseppe do të ketë qenë pronari i fundit i tij, pasi e mori nga Lucio. Në fakt Lucio Doglioni (1730-1803) ishte një personalitet i rëndësishëm në Belluno dhe një nga intelektualët më të shquar të qytetit. Anëtar i disa akademive prestigjioze, autor i shumë studimeve mbi historinë e qytetit të tij të lindjes, njohës i shkëlqyer i veprës së Mommsen-it, bibliofil i apasionuar, dhe nga fundi i jetës vikar ipeshkvnor, Lucio Doglioni ka një profil që na autorizon ta konsiderojmë si një nga njerëzit më të interesuar për ta zotëruar këtë dorëshkrim. Për më tepër Lucio Doglioni, ndryshe nga dy kushërinjtë e tjerë, është më i afërt me periudhën historike së cilës i përket *Poema heroike*, aspekt ky jo pak i rëndësishëm për zgjidhjen e enigmës së autorësisë së veprës.

Hartimi i poemës u krye fill pas vitit 1775, vit që përmendet me saktësi në hyrjen e shkurtër drejtuar lexuesit që shoqëron tekstin. Autori, pasi kishte lexuar një libër mbi *Historinë e të famshmit Gjergj Kastrioti, i quajtur Skënderbeg* i cili «e kishte çuar jetën duke luftuar dhe duke korrur fitore mbi osmanët, vendosi të përshkruante në vargje bëmat e tij heroike që do t'i japin zulmë për gjithë shekujt e ardhshëm». Këtej rridhte synimi për të rrëfyer "bëmat e paharrueshme të këtij heroi të pavdekshëm" duke përshkruar «herë një betejë, herë një rrethim qyteti, herë histori dashurish ose dyluftime epike e gjëra kësodore që gjenden rëndom në shumë poema, sidomos te *Jeruzalemi* i Tasso-s, që mendova të imitoja sa të mundja». Zgjedhja për të ndjekur mësimin e madh që rridhte nga Rilindja italiane dhe sidomos nga një prej autorëve më të shquar të saj, Tasso-s, nuk ishte e rastësishme, por shprehje e një strategjie narrative e cila në kontekstin letrar të epikës kalorësiake rrokte natyrshëm përshkrimin e "bëmave të paharrueshme" të Skënderbeut.

Poema përmban 18 këngë, të cilat nga ana e tyre formohen prej një numri të ndryshëm strofash tetëvargëshe që frymëzohen nga gjuha dhe poetika e Tasso-s, ndërkohë që refuzojnë *ex silentio* impostimin e stisur dhe imagjinar të Ariostos. Sikurse poeti i *Jeruzalemit të çliruar*, edhe autori anonim i kësaj poeme shfaq të njëjtën rreptësi morale, të njëjtat vlera të përshpirta kristiane, të njëjtën përshtatje me përsosmërinë klasike që karakterizonin vizionin pedagogjik dhe heroik të filozofisë së Tasso-s. *Kruja* zëvendëson *Jeruzalemin*, ndërsa Skënderbeu zëvendëson kalorësin Goffredo di Buglione: të dy heronjve u bie barra të shpëtojnë qytetet e tyre nga zgjedha dhe thundra e të

Croia ricuperata, titulli, f. 1r



Croia ricuperata, titulli, f. 3r



Croia ricuperata, Canto Primo, f. 4v

pafeve. Çlirimi i tyre përbën synimin kryesor të bëmave të heronjve tanë, prandaj edhe të dy poemat vërtiten rreth arritjes së këtij synimi. I vetmi dallim që largon dy historitë ka të bëjë me raportin me realitetin prej të cilit varen dy rrëfimet përkatëse: për Tasso-n shndërrimi letrar nuk përbënte problem, pasi ruhej i pandryshuar raporti mes idealit kalorësiak, synimit pedagogjik dhe realitetit historik; përkundrazi, për autorin tonë ky raport prishej nga një fakt që cenonte qashtërsinë e bëmave ta Skënderbeut. Sikurse dihet, Kruja u çlirua falë një mashtrimi që ua hapi dyert e kështjellës shqiptarëve pa qenë nevoja të derdhej asnjë pikë gjaku, mirëpo ky fakt, i dëshmuar historikisht nga kronikat e kohës, në sytë e autorit të poemës nuk përkonte me imazhin e figurës së Skënderbeut që synonte të përshkruante. «Mirëpo unë, – na thotë vetë autori në hyrje – në një poemë heroike të këtij lloji nuk mund ta përshkruaja Princin më të famshëm dhe më luftarak të kohës së tij si dikë që shtie në dorë një qytet të tërë me dinakëri dhe mashtrim pa e zhveshur fare shpatën. Prandaj bëra sikur Skënderbeu, me të mbledhur rreth vetes gjithë miqtë dhe kushërinjtë e shumtë që kishte në Epir, ngriti në këmbë një ushtri prej 6000 vetash dhe kështu, pas tre muajsh rrethimi, i mposhti turqit dhe u bë Zot i Krujës». Me fjalë të tjera, heroi shqiptar nuk mund të shkëputej nga profili i heroit klasik që përshkruante kultura letrare e kohës: luftëtar sypatrembur dhe jo mashtrues, i drejtpërdrejtë, i fortë, që nuk ngurron të vringëllojë armët kur e kërkon nevoja. Ideali kalorësiak kthehej kështu në rolin e vet pedagogjik gjatë një periudhe të historisë italiane kur kërkohej rivlerësimi i modeleve të moçme heroike. Pikërisht kjo nevojitej gjatë shekullit XVIII, kur krizat politike dhe konfliktet në Europën juglindore ringjallnin fantazmat e dikurshme që kishin tronditur ndërgjegjen europiane duke e ftuar atë t'i kthente sytë nga miti i heroit që diti t'u vinte fre për një çerek shekulli hordhive osmane. Asnjë vërejtje kritike nuk do ta ndalonte dot strategjinë narrative të autorit tonë anonim, as edhe shtrembërimi i vetëdijshëm i së vërtetës historike, pasi në vlerësimin e kritikës do të peshonte më shumë mesazhi politik që poema synonte të përcillte. *Jeruzalemi* i Tasso-s *u çlirua* dhe *Kruja* e autorit tonë *u rifitua* falë fuqisë së armëve dhe shpirtit heroik të dy protagonistëve, që tashmë mund t'i konsiderojmë eponime të një stine letrare që përputhet plotësisht me frymën historike të kohës.

Teksti përmban shumë ndërhyrje ndreqëse, të cilat e vështirësojnë punën e transkriptimit dhe përgatitjen e botimit kritik. Jemi gjithsesi të sigurt se kjo dëshmi letrare do ta pasurojë më tej fondin e çmuar të veprave kushtuar Gjergj Kastriotit dhe do të konfirmojë faktin se miti i tij nuk u përket vetëm shqiptarëve, çka vërteton edhe një herë se ai mit nuk është vetëm prodhim i nacionalizmit shqiptar, sikurse dëgjojmë të thuhet shpesh nga çmitizuesit shqiptarë të orës së fundit. Një dukuri kulturore e këtyre përmasave që rrallëherë ia gjejmë shoqen në botë, meriton të studiohet përmes metodash rreptësisht shkencore.

NJERIU, LIBRI DHE KULTURA NË NJË DITË DIMRI (OSE: KLITHMA DRITE NË PARKUN E MADH)

nga Xhevair Lleshi

Përsiatje

Ecën në shëtitoren rreth e qark liqenit të Tiranës, e cila për fat është bërë e re, por që megjithatë duket sikur është restauruar diçka që buron nga kultura e vjetër, gjë që nuk është e vërtetë. Por sa do të donim të qe e tillë! Deri këtu, pavarësisht hamendësimit, s'ka asgjë të keqe. Duket se kemi kuptuar ca shenja gati të pavërejtshme që befas na tronditin me ndjesinë e një ngashënjimi që herë-herë duket si një trishtim i pa fund. Dhe ne jemi një grup i madh njerëzish që i nënshtrohemi mbrojtjes nga Covid-19 me ajër të pastër nga Parku i Madh. Të mbrohesh me ajër të pastër është një luftë e bukur, pa e përkatësuar këtë si një gjë të tepërt. Sepse prej kohësh ne bëjmë jetën e mbrojtur brenda në shtëpi, ose nën pushtetin e maskave e, për këtë shkak, na bëhet se kërkojmë një kanxhë ku të kapemi e të justifikohemi në një farë mënyre. Dhe ecim, dëgjojmë veten ose muzikë, shmangim afrinë me të tjerat përballë shpërthimit të të qeshurave, mërzisë, cinizmit, mërisë. Një asociacion dhe bashkëbisedim njerëzor i shëtitësve, një kastë e re të privilegjuarish jo nga fati, por nga vullneti...

«Si je? Na ka marrë malli! Ç'bëhet, mo? Nga ishe fshehur tërë këto kohë? Kujdesu për veten! Si është moti andej? Bie shi! Jo, jo nuk bën ftohtë... Mbyllu brenda, mos dil! Veç të çmendem, kjo më ka ngelur tani! Ç'thua mo?... Fundja le të bjerë, na duhet edhe erë edhe shi... S'e kam humbur ende toruan. Dy hapa e kam Dinastinë, atij i them parashikues unë, që kur e ndërtoi lokalin, hotelin dhe mjediset, duke parashikuar luftën e habitshme dhe të tmerrshme kundër Covid-19.» Aty mund të surbësh edhe me një të uruar, pa u afruar kokë më kokë me ndonjë mik... E megjithatë gjithkush prej nesh mund të ndjekë bisedat që rrok veshi. «Ju shikoni punët, pa unë... Baba, të kam çuar fjalë që dje mbrëma, dalja e përditshme është e dëmshme... Të lashë edhe dy libra. Po, njëri është «Përsiatje hulumtuese» të profesor Xhevat Lloshit, ku mund të lexosh «Kultura korçare e sallonit». Po. E vërtetë. Aty flitet për kulturën e shpellave të cilës i këndojmë, duke harruar se qytetërimi shqiptar kalon nëpër sallonin korçar të kulturës... Ke nevojë për gjë tjetër? Ç'të mungon, mo? Asgjë. Karta e kreditit? Mos u mërzit, de, po e mbyll bisedën... Bëjuani qejfin burrave! Nuk u shkon për shtat!...»

Mjaft dëgjoja zërat që kalonin përskaj meje. Edhe muzikën që e kam si një qenie të dytë. Por edhe më interesante është biseda që fillon e përfundon me veten, në mënyrë të papritur ose edhe me një ndjenjë e pakëndshme që e kaplon këdo prej nesh, e që shpesh, sidomos këto kohë na mungon pothuaj gjithmonë. Përsëri më rrok veshi :«Do të jenë ngushtë, kushedi! Të zestë ne! Mos e përmend më! Të shkretët... E mo, lëre, bëjnë sikur nuk u vete mendja... E, dashuria? Po interes është dhe pikë. Lëre, e djallosa! Nuk pihet uji nga shishja! Nuk të lë ai, salloni qytetar i Korçës! Gogol?... Më ngjall vetëm mëshirë dhe mërzi!...»

E gjithë kjo më tingëllon bukur dhe ëmbël dhe mendoj që do të qe e papërshkrueshme një ditë dimri në Parkun e Madh. A mund t'i regjistroje dot të gjitha fjalët e thëna duke shëtitur, ecur, vrapuar e duke ndenjur në të? Do t'i ngjante një poeme të pafundme, ose një romani me mijëra faqe. Kaq bukur dhe ëmbël do të tingëllonin. Prandaj dhe do t'më pëlqente të gjeja në një shteg skulpturën monumentale, atë të improvizuar, faqe muresh ku mund të shkruheshin vargje, puthje, dedikime, psherëtima, ide, mendime fluturake, fjalë që bëjnë përshtypje të thukët, për miqtë, shokët... Po një sallon mode, libri, muzike, veshjeje, baleti, fëmijësh, sporti etj. Dhe ke qejf ta dëgjosh çdo çast. Ndriçimi i plotë, lodrat, revistat, muzika, një rrugë aktive ditën dhe natën, biçikleta... Por duke u menduar më thellë njeriu kërkon edhe strehë, kafe të thjeshta, shërbime të tjera dhe kudo (kudo!) libra. Ditë dhe natë. Se edhe nata tërheq në gjithë gjatësinë e saj. Ngrohtësi në dimër dhe fresk në verë. Dhe betim në vjeshtë e premtim në pranverë. Shpesh herë mund të hasësh edhe oratori, rrep, improvizim, teatër rruge, një njeri si dordolec që tremb dikë, artistë që fotografojnë, shfaqin, deklamojnë... Dhe ti dëgjon: «Por me gjuhë kaq t'moçme, e mjera,/ Si i'bij' kje qi pa prind mbet,/ Për t'huj t'mbajshin nder dhena t'tjera,/ Si t'kishte kush për motrë t'vet...»/ Dhe të bëhet zemra mal kur dëgjon këto vargje nga Dom Ndre Mjeda, këngëtari lirik i gjuhës shqipe...

Këtu në Parkun e Madh arrin kulmin në fantazira të çuditshme, që të bëjnë të harrosh kotësinë dhe mërzinë e jetës së këtyre ditëve, ndonjë zë që ngrihet pa ose me dashje. Dhe kjo ndodh jo rrallë. E përditshme me diell të bukur, si të gdhendur në shpirt, po edhe me një shi po kaq të këndshëm. Askujt nuk i vjen çudi si ngjet kjo, sepse vjen natyrshëm, se në Park nuk mblidhen dështakët, as të pashpresët, as pleqtë gërnjarë, jo! Përkundrazi! Këtu edhe shëtitësit i pëlqen shkëlqimi, seksi, paraqitja e re. Rinia. Por ja që mungon libri. Qoftë edhe reklamat me librat e rinj, ose reklamat me drita dhe ato elektronike për librin, për efektet e veçanta të dijes, obeliskë të përkohshëm kulturorë, vargje të Lahutës, vargje të gjuhës shqipe dhe për gjuhën shqipe...Imagjinata realiste të çon kudo, në të gjitha shtigjet. Këtu s'ka krekosje të beftë, që s'u shkon fare fytyrave të lodhura e hijerënda që nganjëherë shfaqin intelektualët e mbetur në këtë vend. Ngaqë duke ecur në Park shpesh të fton një mik që e takon papritur, veç që shtysa të ngut për t'u kthyer në shtëpi, mbetesh ngushtë në mendimet e tua, edhe pse jashtë teje bie shi...

Rrugët e preferuara të Parkut të Madh duket se janë bërë të lëbyrta nga valët e rrëmbyera të shiut dhe drita e lënduar e vetëtimave që ndriçojnë gjithë hapësirën përqark. Them se duket si klithmë drite, disi e ftohtë dhe secili prej nesh ndjen fërgëllima të befta dimri, siç mund të ndodhte e kundërta në verë. Kështu edhe dimri përfton estetikën e tij të veçantë... Po, kjo është një ditë si e qelqtë që duket se pi uiski dhe shkakton një gjendje gati magjike, që sajon një buzëqeshje të çuditshme dhe pothuaj sfiduese prej ere dhe shiu. Po ja dikush ia nis papritur këngës, që i detyron zërat të dëgjohen të trishtë, të lodhur e përplot ankim. Fundja të tillë e tjetërson shiu! Por s'dihet pse mua më duket e bukur...

Njerëzia, një mizëri me maska, si për të fshehur fytyrën, duket se kanë ardhur enkas për të luajtur teatër. Aty ata ngjishen brenda rrezes së çadrës laramane, nën shiun e zymtë (për ironi!) që breron shtruar e, bashkë me vetëtimat që ndriçojnë, të ngjallin një keqardhje të madhe për atë që mungon dhe vështrojnë lart mbi drurët e Parkut dhe më tej retë e ngarkuara që gremisen duke hapur humnera pafund në qiell. Varreza gjigantë e perëndive? Varreza fluturuese, më thoshte në mendimet e mia Roland Gjoza, një tregim i njerëzve të ngarkuar me halle të Faruk Myrtajt që digjen e shkrumbohen befas nga rrufetë gjëmuese. Aty-këtu, në çastet e heshtjes dhe qetësisë e ndien se do të shkonin më mirë vargjet e Fatos Arapit, shkëputet ndonjë psherëtimë që nuk e gjen aty Xhevahir Spahiun, një telefonatë Korçe nga Skënder Rusi, i qan zemra që nuk e sheh aty Faslli Halitin dhe këtë e shoqëron me një ofshamë e trishtë. Aty bën pohe e bujë zulma e Moikom Zeqos dhe trishtimi i madh i Ali Podrimjes, drita më e mirë e Petro Markos duke gjetur pranë ethet njerëzore, bashkë me veset më të tmerrshme: egoizmin, lakminë dhe zilinë. Aty gjen ngushëllim pune piktori Buron Kaceli në atë ndërkohën, kur dikush mban ligjëratën e lavdisë dhe, heshtja u vë veshin fjalëve nëpër shi, po edhe nën rrezet e diellit, fjalëve përplot ëndje për atë që është, ndonëse e mbuluar me maskën e Covid 19, ku bëjnë majë edhe librat, edhe ata nën okelion «me maska»... Duke ecur ke të drejtë të meditosh, t'u besosh gënjeshtrave të mrekullueshme që trillohen për të harruar koronavirusin (të gjitha kurorat mbretërore janë shpallur të padobishme për shkak të emrit!), për t'u larguar njëfarësoj prej saj. Megjithatë gjithkush e gjen rastin të mendojë për veten, paratë, gratë, udhëtimet që e presin (sikur të udhëtohej sërish!) dhe dalëngadalë i duket sikur fiton siguri. Edhe vetë dimri, sa del rrezja e parë e diellit, ndien sërish shijen e fortë të jetës... Ç'mrekulli! Veçse pa libra! E pse ndodh kështu? Sa mirë do të ishte që të ashtuquajturat biblioteka në qytetin e Tiranës, të ktheheshin në sallone libri!...

Befas u çanë retë dhe mbi parkun e madh u ngrit lart dielli (dhe çfarë dielli!) me një butësi e ëmbëlsi përdëlluese. Si çdo gjë e dimrit, kur fiton vesk ajo që zakonisht mungon... Zëra të dridhur. Oratorì befasuese dhe disi e trembur. Rrëfim në pak minuta. Jeta e një njeriu të mirë. Një trillim i habitshëm. Ca ndodhi që s'kanë ngjarë kurrë. Dhe të gjithë besojnë të habitur. Fjalët e dimrit të befasojnë. Veshur rëndë. Superpeshë. Entuziazmi që vazhdimisht duartrokasin. Ah, sikur të kishim gjallë teatrin kombëtar, por ja që dora mizore e shembi, ndonëse aty pranë dëgjohet rënkimi i Maks Velos. Në një sallë teatri? As në teatrin veror antikovid. Ai i gjorë kërkon menjëherë të falur për atë sjellje plot marrëzi. Dimri edhe turpin e shtyn nëpër radhët e shtrënguara të njerëzve me maskë. Kështu që vetë dimri ia mbath nga sytë këmbët... Për një vepër arti? Apo për një libër fëmijësh që mund të jepej elektronikisht në Parkun e Madh... Apo mezi pret të vijë 25 prilli! Ndoshta!...

Këtu, në rrugët e ndriçuara të Parkut të Madh mbaron ceremoniali i dimrit dhe brenda çastit përjeton të gjitha stinët. Dhe kjo të krijon ndjesinë e të jetuarit të të katër stinëve njëherësh. Fundja atij që lëshon pe i takon të falënderohet nga miqtë, njerëz të panjohur, veçmas nga gratë, ato që artistikisht çdo ditë arrijnë të befasojnë këdo, ndonëse ato dendur i kanë sytë të mbushur me lot. Nga era? Atëherë fajin e ka trishtimi! Mbase, por ato dinë të thonë fjalë kaq të ëmbla dhe përdëlluese, sa të shteret pikëllimi pa anë e fund e të davaritet dalëngadalë. Gratë dinë të buzëqeshin bukur e me një shpresë sado e mekur të jetë do të shfaqet në shpirtin njerëzor e do të hyjë brenda nesh... Gratë edhe talenti i tyre aq estetik nuk është parë e dëgjuar akoma, sepse në prag gjithnjë është e rrallë, kurrë e shpërblyer, gati për të shpërthyer. Revolucionin e grave e ngre lart arti, letërsia, libri...

Ecën ditës, (mëngjes, drekë e darkë) në Parkun e Madh. Shpesh të rëndojnë mendimet edhe në një ditë me shi. Dhe mendimi ngurtësohet para shpërthimit në ditë me diell, duke kërkuar të ulesh në një tavolinë në respekt të largësisë, që ta shtysh emocionin si ditën me shi. Gjithsesi Parku duket i veshur me shumë mërzi, ndonëse nuk duhetj harruar se atje nuk mungon fryma e ngrohtë e njeriut, që është si një mall i rëndë i papërcaktuar, si një dhimbje e ëmbël... Por sidoqoftë flitet për histori të vërteta, ku nuk stiset asgjë, secili rrëfen diçka të dhembshur nga jeta e vet dhe për çudi nuk e ndjen vetminë, atë vetminë si lëngim, që në një ditë dimri të mundon për shumë e shumë kohë. Njeriu i thjeshtë i ngarkuar me njëmijë halle me një fjalë të vetme kërkon të bëjë mrekullinë dhe ta shndërrojë natyrën e tij duke e bërë të virtytshme, ta heroizojë, po nganjëherë ta bëjë të urryer, apo edhe të nderuar, kështu trillet e besueshme nisin të ngjallin admirim të fshehtë. Dhe këto mendime vijnë gjatë një shëtitjeje në jetën e përditshme, por dhe në ëndrra, që na ndihin me praninë e tyre të padukshme, këtu midis nesh, gjatë një shëtitjeve të vetme, ndonëse e përditshme, duke sjellë mrekullinë e shndërrimit të saj për hir të një trilli dashuror. Në meditimin e përditshëm gjallojnë personazhe të famshëm të kohërave të shkuara që sollën ato që dimë, apo personazheve të sotëm, duke na dhuruar ditë të shëmtuara si askurrë tjetër, që betohen ditë e natë me të ardhmen tonë të ndritur për marrëveshje miliardëshe, por me lugën bosh... (Gënje edhe njëherë pa të shohësh!).

Kjo është një ditë dimri e ngarkuar me mërmërima admirimi e mahnitjeje, e përshkuar me trishtim, ekstazë dhe hare e krisur. Dhe vjen mendja e bërë ujem. Ujemi i shkrimtarit apo i mullixhiut? Po ku t'i gjejmë këto kohë ata? Se jo vetëm shkrimtarë e mullixhinj s'mund të gjejmë! Domethënë as edhe ata, të dy të munguar gati sa s'shpërthejnë nga ajo fjalë që ta bënte mendjen trokë. Dhe vijnë raste të pakëndshme, të paparashikuara, të heshtur, të nënshtruar si para një idhulli, kur papritur feks krejt pavëmendshëm një rrethanë përplot kulturë dhe kushdo prej nesh mund të gjejë monumentet rrugës së Parkut të madh, teatrin e kukullave, buzëqeshjet lojcake, libri në reklamat ndanë rruge, erën që pëshpërit fjalë dashurie...

Tiranë, më 12.01.2021

VIRION GRAÇI LULZIM HAZIRI

Duhet t'i hapim dyert pa i rënë ziles!

V.Graçi: Përshëndetje i dashur Lulzim. Në numrin e mëparëshëm të ExLibris ishte një cikël poetik nga krijimtaria juaj që zgjoi interesin dhe kureshtjen e lexuesëve. Kur keni nisur të shkruani poezi?

L.Haziri: Një pyetje e zakonshme kjo për të nisur një bisedë mes dy miqsh dhe krijuesish që nuk janë takuar më parë. Që biseda të mos na rrjedh si kjo pyetje "shkepje cigaresh", përgjigjja mund të merret e pazakonshme për një popull që shkruan shumë, apo që pretendon se shkruan shumë, siç jemi ne shqiptarët. Kam filluar të shkruaj "vonë", pas moshës njëzetvjeçare, dhe kam nisur të shkruaj aksidentalisht. Poezia ime lindi nga dështimet. Me humbjen e një viti të studimeve sikur mu dha një vit i ri mundësie. I dëshpëruar dhe i lodhur nga studimi i makinerisë, zbulova bibliotekën e babait të cilën e kisha harruar. Nisa të lexoj prozë dhe poezi si i përhënur. Pasi mendova se u ngopa së lexuari nisa t'i kopjoj poezitë që mendoja se janë të mira. Kështu shfaqeshin, tek-tuk, edhe disa vargje të dobëta të cilat fillova t'i ndaj nga poezitë e të tjerëve. Vetëm këto vargje nisa t'i shtypi me makinën e shkrimit. Ishin vargjet e mia! Asnjëri nga shokët nuk humbte kohë që t'i lexonte. Më habiti guximi im për t'i dërguar ato nëpër gazeta dhe besimi që redaktorët tregonin për to. Pas dy-tre vite botimi nëpër shtypin e kohës (Zëri i rinisë, Rilindja, Fjala…) u "dorëzua" edhe Ali Podrimja dhe ma botoi përmbledhjen e parë poetike "Kënga lind në vetmi" (NB Rilindja, 1989). Nuk kam pasur dhe nuk kam probleme me botimin e poezive ose librave, sa kam pasur dhe kam me shkrimin e tyre. Më kanë penguar njerëzit të cilët moshën time e merrnin kriter për vlerësimin e krijimtarisë sime. Nuk e kuptonin se unë isha një poet ndoshta mesatar për nga skolastika, por isha bashkëkohor, në kuptimin e krijuesit që i tejkalon kufinjtë dhe kornizat e t*ë kaluarës.* Ishte koha kur bashkëkohësia, të qenit bashkëkohor, nënkuptonte atë që shkruhej në atë çast. Koha të cilën e jetoja, zhvillimi i hovshëm kulturor ndër shqiptarët këtej kufirit, me qendër Prishtinën, jeta ime e re në një ambient urban i cili tjetërsonte dhe gëlltiste mëvetësinë e krijuesit, më impononte që në shkrime të kap esencën e botës

së tillë, duke përdorur një sens dhe gjuhë artistike, mbase specifike, e cila dallonte nga fryma e realizmit socialist që mbretëronte në Shqipëri, apo nga poezia/hermetike/moderne eKosovës (Shkreli, Podrimja, Musliu etj. që atëbotë ishte në kulmin e saj). Këtë dija ta bëj më së miri dhe e bëja me sinqeritet… Duket që të dy jemi të një brezi, atij të viteve '80 të shekullit të kaluar. "Shekullit të kaluar", sa më vetëdijëson kjo, sa të urtë më bën, dhe sa më trishton në të njëjtën kohën.Të shkruaje poezi në një sistem të tillë shtetëror, siç ishte Shqipëria e asaj kohe, a ishte e vështirë, duke pasur parasysh se, mbase nuk e kap si duhet "realitetin"?! Kush ishte më i fortë, rreziku apo kënaqësia?

V.Graçi: Mund të them se kam hyrë vonë në poezi, po të kemi parasysh zhanrin, jo frymën poetike, mendimin poetik, gjetjet poetike që mund e duhet t'i kenë edhe veprimtari të tjera, zhanre të tjerë letrarë. Kur isha i vogël pak ose aspak vëmendje i kushtoja mësimit përmendësh në shkollë të poezive që përmbante program mësimor; jo se nuk më pëlqenin, por nguroja t'i recitoja me tonin e duhur, me gjestet e duhura. Kështu më ngeli një lloj largësie relative nga poezia, ose, thënë më saktë, poezia më shkonte vetëm nëpër mend, vetëm nëpër përfytyrim. Edhe poezinë më të bukur, nëse e dëgjoj nga dikush, më del zemre. Dua leximin e nëpërmendshëm. E të mos largohem nga pyetja juaj: diku nga viti '87 ku isha (vetëm një vit) student te fakulteti Gjeologji-Miniera, nisa të shkruaja poezi. Në atë fakultet që nuk ishte i modës për shoqërinë e asaj kohe, kishte djem me nivel të lartë kulturor, me ndjeshmëri, e për habi, edhe me prirje për t'u ikur ligjërimeve standard, rrymave që diktonin poezinë e kohës, në nivel leximi, kuptohet. Vazhdimisht shkruaja për ta shkarkuar kaosin im mendor, dhimbjen time metafizike, vizionet e mia mistike dhe kështu u mbushën me vargje pa rimë mjaft faqe. Në rininë tuaj të hershme, çfarë vendi zinte poezia? Çfarë pasojash e përfitimesh mund të kishte publikimi i tyre?

L.Haziri: Tash, nga kjo perspektivë kohore dhe nga kjo periudhë e anarkisë së vlerave, them se kam qenë me fat që kam nisur të shkruaj në një kohë kur sadopak kultura ishte pavarësuar nga ndikimi politik dhe me institucionet kulturore udhëhiqnin njerëzit e kulturës. Zaten, Kosova këtë luftë e kishte fituar që në kohën e Esad Mekulit dhe vazhdonte ta pavarësojë këtë hapësirë kulturore. Ishte koha e autoriteteve letrare, koha e librave dhe koha e ëmbëltores "Elida". Shtëpia botuese "Rilindja" vazhdonte t'i begatojë dhe t'i shtojë kolanat e saja të cilat priteshin me interesim, autorët e Rilindjes kombëtare ishin botuar që të gjithë në edicione luksoze dhe të përgatitura nga studiues kompetentë. Ekzistonte edhe një ëmbëltore me emrin "Elita", emri i së cilës sikur e shenjonte klientelën e saj. Aty mblidheshen krye më krye elita kulturore e kohës. Aty mund të pije kafe me Ali Podrimjen, Ibrahim Rrugovën, e më rrallë me Anton Pashkun. Një tavolinë në këtë agorë të mendimit alternativ nga e cila doli edhe elita politike që do t'ju prijë proceseve demokratike pas rënies së Lidhjes komuniste jugosllave, vazhdimisht zihej nga shoqëria ime. Nuk përziheshim me tavolinat tjera, sepse kryesisht ishim të një provenience tjetër kulturore – rokerë. Unë isha ai "spiuni" që e përligjja këtë botë "dekadente" në sytë e shumë prej elitës kulturore. Me botimin e poezive të mia, sikur doja të dëshmoj se bota ndryshon, dhe se rok-kultura e cila vijëzohej në shumë nga poezitë e mia, në botë tashmë është shndërruar në establishment kulturor.

Në këtë ambient nuk kishte asnjë rrezik botimi i poezive. Përkundrazi. Ishte koha kur botimi i poezive paguhej me vargje të botuara dhe me shikime mosbesuese nga tavolinat e "Elitës". Shqetësimi im i vetëm ishte vendlindja ime, Gostivari ku jetoja. Prishtina ishte vendqëndrimi im. Unë botoja në shtypin e kohës në Prishtinë. Botova librin tim të parë në një shtëpi botuese prestigjoze e cila në vit botonte nga 4-5 libra të autorëve fillestarë dhe kthehesha në Gostivar, në qytetin pa asnjë poet, qytet që nuk më njihte, nuk kishte dëgjuar për mua, apo qëllonte që të dëgjoje nga ndonjë poet i Kosovës. Dëshpërimi më i madh për mua në jetë ka qenë çasti kur një student i Gostivarit kishte dëgjuar nga Abdullah Konjushevci emrin tim dhe më pyeti se *në mos e njihja një farë Lulëzim Haziri!!!* Isha poeti i vetëm në historinë e këtij qyteti që kishte botuar një libër për të rritur. Isha si i ndarë nga vendlindja dhe nga Shqipëria; jo që nuk e ndiqja poezinë që botohej në Shqipëri, qoftë përmes botimit të tyre në Prishtinë, qoftë përmes ndonjë numri të "Nëntorit" që më binte në dorë ilegalisht, por e njëjta nuk më bënte përshtypjet e pritëshme. Ç'ndjenjë mund të ngjallin tek ti këto fjalë? Pse shkruanit poezi në një ambient të tillë? U shkaktonte kënaqësi akti i shkrimit?

V.Graçi: Në fazën fëminore shkrimi i poezive 'origjinale', riprodhimi përmendësh i poezive nga



krijimtaria e poetëve të njohur, shërbente për tu shqitur nga shoqëria shkollore si fëmijë me talent, i mençur, me prirje letrare, çka çmohej shumë si në mjedise familjare, ashtu dhe nga autoritetet. Në diktaturë, ligjërimi jo racional, poetiko-futurist dhe pathosi ishin tipare gati normative edhe të udhëheqësve tanë shtetërorë, komunistëve me pozitë dhe prijësve të grupeve të ndryshme. Pra, te një fëmijë që donte poezinë, e recitonte bukur atë, familja, mësuesit shikon dhe një veprimtar të ardhshëm shoqwro/politik, një drejtues të ravijëzuar në horizont. Në rininë para universitare poezia mund të ishte punë serioze, çështje shkrimi në fshehtësi a gjysmë ilegalisht se sa zanat, shfaqje në publik me interpretime/botime. Të rinjtë e kohës sime derdhnin nëpër vargje gjërat që nuk guxonin t'i shprehnin me miqtë më të afërt, me shoqet më të afërta; jo vetëm pakënaqësitw materiale, por, e sidomos, sa u përket pakënaqësive shpirtërore. Fataliteti infatil, mungesa e prespektivës individuale në mesin e optimizmit të përgjithëshëm revolucionar, ishin burimet kryesore nga ku ushqehej e rritej një poezi e dëshpërimit, e metonimisë, e hermetizmit, e pa kuptueshmërisë, në fund të fundit. Më vonë, për ata që kryenin degë filologjie për të qenë profesionalisht poetë-shkrimtarë, ndodhte përshtatja me modelet mbizotëruese të kohës, me autoritet letrare të bashkëkohësisë ose të traditës më të afërt, plus elementin popullor, mbështjetja në krijimtarinë folklorike, sa i përket figuracionit, mendwsisw... Në poezitë e tuaj ndihet Kosova, kam hasur motive nga Prishtina; Bregu i Diellit është një toponim dhe topik i shpeshtë, njëkohësisht funksionalizohet si hapësirë përjetimesh nëpër vargjet e tua. Ç'vend zë në jetën tuaj Prishtina si qytet? Vendet e saj më të pëlqyera? Ndonjë ndodhi për të cilën e falenderoni fatin? E ndonjë ndodhi ju ju trishton ende?

L.Haziri: Sa mirë që vazhdoni të më pyesni për këtë periudhë dhe për këtë vend. Një mik i imi nga Prishtina më thotë: "Ti je poeti më i madh i Prishtinës që nuk jeton **këtu.**" Mbase, ligjërimi për këtë qytet lidhet me atë që theksova në fillim "sensi i kohës". Për aq sa shkruaj, jam munduar që të mos bëj shumë kompromise me veten dhe me emocionet e mia, sepse poezia është mbi të gjitha emocion. Gjithë mundimin e kisha që të gjendem natyrshëm në një qendër, duke qenë i vetëdijshëm se vija nga një provincë kulturore. Pastaj, e kisha shumë më lehtë pasi e kisha asimiluar në vete këtë provincë. E njëjta nuk më paraqitej as si kujtesë, as si reminishencë. Thjeshtë, e jetoja kohën**, isha në qendrën e saj**. Isha në Prishtinë. Por, kjo është tepër apoetike. Magjia fillonte kur kthehesha në një dhomë të vogël në Breg të Diellit (toponim i një lagjeje të Prishtinës) brenda së cilës shndërrohesha në njeri të letrave, në njeri të ëndrrave. Aty lindnin gjithë ato poezi për Prishtinën. Jo vetëm poezitë e mia, në atë dhomë të vogël kanë lindur edhe shumë këngë të rok- grupeve muzikore "Minatorit" dhe "Gjurmëve" për Prishtinën, të cilët i kisha "shokë të idealit". (Hahahhaa). Sot e kësaj ditë Prishtina nuk e di se ka ekzistuar një dhomë dy me tri e një studenti prej Gostivari, në të cilën kanë lindur poezitë dhe këngët për këtë qytet. Kjo e mba gjallë ende magjinë time që më lidh me Prishtinën.

Besoj se edhe përvoja jote me Tiranën është e njëjtë. A përjetove qytetin e mundësive që t'i jepte? A i shfrytëzove mirë këto mundësi? Apo mbete një gjirokastrit që mëson në Tiranë? A na përkufizojnë qytetet neve, apo ne u përshtatemi atyre?

V.Graçi: Përgjigjia e kësaj pyetjeje mund të meritonte njw sagë mw vete, po të jetonim në kohën e romaneve të sagave familjare; Gjirokastra ka qenë qyteti i parë që kam parë; theksoj, *kam parë*, e jo *kam njohur*. E kam parë si kartolinë, anën e tij tërheqëse, kalanë, lagjet me shtëpitë karakteristike, thyerjet mbresëlënëse të terrenit, grija e çative mbuluar me pllakë guri. E gjithë kjo kartolineri natyrore më ndodhte sepse jam nga një fshat i Gjirokastrës, nga Kolonja, dhe në qytet shkoja si turist, si vizitor, me prindërit ose me fëmijët e tjerë të shkollës, me të dalluarit. Kështu, me prindërit më takonte të ulesha në ëmbëltore, gjelltore, restorante; me ta më ndodhte të takoja njerëz të rritur që përfaqësonin shumëçka pwr prindërit e mi. kurse ekskursionet shkollore na çonin nëpër qenda

pune e prodhimi, uzina mekanike bujqësore, uzina metalike, te punishtja e përpunimit të qumështit, te ajo e sherebelës, te fabrika e miellit, fabrika e duhan-cigareve si dhe në vende historike: në muzeun e armëve në kala, te aeroplani armik i vendosur në sheshin e kalasë e të tjera vende si këto. "Sheshi i Çerçizit" ishte domethënës dhe tërheqës, më vonë vendin e tij për mua e zuri "Sheshi i linjave urbane" aty ku niseshin autobuset për në qytetet e tjera dhe fshatrat përqark. Pra, Gjirokastra për mua nuk ka qenë përditshmwri e rëndomtë, por ndodhi e këndshme, turizëm kulturor. Pas vitit '92 u bëra pjesë e saj me kohë të plotë kur u ktheva nga studimet e fillova punë aty. Qyteti "im" u bë Korça ku kalova katër vite të shkollës së mesme; ishte mosha ajo na lidhte emocionalisht me botën që na rrethonte; çdo gjë regjistrohej vetiu në kujtesë duke u bymyer vazhdimisht; bymimi, zbukurimi, mbitheksimi ndoshta janë karakteristika të çdo adoleshenti dhe jehona tw proceseve psiqike të mëvonëshme kur duam ta ringjallim në rrëfime atë moshë. Korça ofronte kulturë, ose, duke parë lagjen e shtëpive të ish-borgjezëve e ish tregëtarëve korçarë, të krijohej përshtypja se jeta socialiste nuk ishte kudo njësoj; të krijohej përshtypja se në regjimin e anatemuar si anti-popullor të Ahmet Zogut, kishte pasur shije të mira për jetën e qytetëruar, ca parajsa të vogëla që i mbijetonin në formë stuhisë komuniste, godina publike me prestigj arkitekturor, dha ca zakone festive për ditët me diell, të dielave, daljen në piknikë familjarë.Tiranën e njoha në moshën studentore: përherë ka ekzistuar iluzioni se ambiciet profesionale dhe idealet, më së miri sprovohen të sendërtohen në kryeqytet. E. Hoxha, E.Çabej, I. Kadare, e të tjera simbole të staturave më të vogla, ishin realizuar si të tillë, me sa dija unë, në Tiranë. Por, në vitin '87 kishte marrë fund epoka e ëndërrimeve të përbashkëta; kishte filluar kriticizmi, decentralizimi shpirtëror, dekonstruktivizmi nëntokësor, nëse mund t'i përkufizoj kështu. Në Tiranën jo zyrtare të rinjtë e të rejat ishin duke u divorcuar me buzëqeshje e anekdota nga serioziteti politico-burokratik i prindërve të tyre.

Midis qyteteve të "tu": Gostivar-Prishtinë-Shkup-Tetovë, a kishte nuancime?

L.Haziri: Veç ndonjë sëmundje e rëndë, siç ishte ajo e babait, më kthente mua nga Prishtina. Babai vdiq shpejt dhe i ri dhe unë u desh të rikthehem në vendlindje, në Gostivarin apoetik. Nga Prishtina nuk munda as të ndahem siç ndahen dy të dashuruar që ua ndërpren dashurinë barra e planifikuar. Kopjen e parë të librit "Kënga lind në vetmi" ma solli miku im Naser Gjinovci. Ma dha në një çajtore të qytetit, sepse nuk

kishte ende vende të denja për sihariqe të tilla.

Në ambientin e ri, në qytetin e Gostivarit, filluan të më shymen ato dritat e tunelit krijues. Do më duheshin vite të tëra që sërish të rifilloj të shkruaj, por si rezultat i leximit dhe gnosologjisë, e jo përjetimit. Në ndërkohë fillova të ndikoj në ndërrimin e qytetit, në fisnikërimin e tij, në nisjen e iniciativave kulturore, në të cilat ftoja miqët e mi poetë.

Në ndërkohë që udhët me Kosovën u ndërprenë me tela me gjemba të vënë nga pushteti serb, qendër kulturore e shqiptarëve të Maqedonisë ngadalë nisi të bëhet Tetova e cila sot e kësaj dite, përkundër dy universiteteve, nuk ka arritur të konsolidohet tamam në qendër kulturore. Mbase mungoi një Esat Mekul, Anton Pashk apo Ali Podrimja që me autoritetin dhe forcën e integritetit personal do të ndikonte në pavarësimin e kulturës nga politika. Për çudi, hapja e dy universiteteve në Tetovë në vend që t'i jepte vlera të reja kësaj qendreje kulturore edhe pas çerek shekulli, gjithë autoritetet kulturore e letrare ende janë të kohës së Prishtinës.

Ti me të drejtë do të pyesje, po Shkupi, qyteti që dikur ishte qyteti më i madh me shqiptarë, ku është Shkupi?! Unë do të them, Shkupi mbeti një qytet ku vetëm zhvillohen manifestime dhe pihet çaj...

Kur këto qytete i vëmë kundruall qyteteve me shumicë maqedonase, nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm, përveç atij dallimit sasior që vjen si rezultat i përkrahjes më të madhe të shtetit të aktiviteteve kulturore. Maqedonasit, kultura maqedonase, ka mbetur peng i frustrimeve historike, megallomanisë primitive ballkanase dhe mbylljes nga ndikimet e çdo vlere që vjen nga jashtë, aq më tepër nga fqinjët.

V.Graçi: Kohë më parë, një botues i huaj donte të dhëna për letërsinë shqipe në MV, shqiptarë të Kosovës e të Maqedonisë ritheksuan emrin tënd si njeriu që më së miri mund të bënte një panoramë të saktë. Si e keni fituar një besueshmëri të tillë? Ç'mund të thoni për panoramat përkatëse letrare?

L.Haziri: Kjo që thua më bën nder, aq më tepër që nuk jam njeri aktiv i letrave, nuk punoj në ndonjë institucion apo gazetë kulturore dhe nuk kam studiuar letërsinë. Mbase ka të bëjë më shumë me integritetin tim i cili më ka ndihmuar në jetë. Nuk bëj kompromise me shkrimin dhe me vlerat. Jo vetëm shqiptarët, po edhe botuesit, selektorët dhe redaktorët maqedonas më kërkojnë sugjerime për autorë në përpilimin e antologjive të ndryshme, manifestime kulturore, siç janë "Mbrëmjet Strugane të Poezisë", apo autorë për tu përkthyer në gjuhën maqedonase. Një status i këtillë, i plotësuar edhe me angazhime të tjera që nënkuptojnë përgjegjësinë në vendime e qëndrime, më shkakton siklet dhe konflikte. Me këtë të dytin, kur nuk mjafton forca e argumentit ballafaqohem me menefregizëm (më pëlqen kjo fjalë e re e juaja), apo ironi.

Tek e ceke *Antologjinë e tregimit ballkanik*, në të cilën isha selektor për autorët e Maqedonisë, të them se më mirënjohës më janë shprehur disa autorë maqedonas, se sa ato shqiptarë.

Si përjetohen këto gjëra në një skenë më të ngjeshur me autorë? Sa ka hatërmbetje mes autorëve, xhelozi, grupime e kruzhoqe të vogla letrare? Besoj se sa më e madhe të jetë skena, këto drama e komedi të vogla janë më të theksuara, apo jo ?

V.Graçi: Deri diku kemi të njëjtat të meta e virtute ne shqiptarët; për shkak të jetesës së shtetëzuar, materialisht e në derivatet e jetës shpirtërore, pak e kemi të kultivuar ndjenjën e organizimit me shoqata, pen-klube, festivale; më tepër presim me sytë nga qielli, nga shteti domethënë. Por shteti nuk mund të jetë më ai i dikurshmi.

Në librin tuaj *Testamentet prej mëndafshi* ka larmi të procedeve poetikë: poezi lirike, poezi të peizazhit, poezi të ironisë sociale. Keni lëvruar me sukses e origjinalitet dhe baladën, në disa raste si dhe një numër jo të vogël poezish me prozodi klasike. Si ka evoluar koncepti yt për poezinë?

L.Haziri: Libri i fundit *Testament prej mëndafshi* është libër i drojës që më ka shoqëruar, ndjenjë të cilën nuk e kisha në librat e mëparshëm. Mbase, me kalimin e kohës jam bërë më i përgjegjshëm. Poeti Salajdin Salihu këtë e sheh si pjekuri edhe më të madhe artistike. Droja ime ka qenë se kam ndryshuar më shumë se sa duhet, aq sa mos më njohin as lexuesit e mi. Kjo drojë i bën mirë letërsisë, ndonëse mund të bëhet edhe e dëmshme.

Disa ndryshime i sjell mosha e cila e ushqen poezinë. Ajo që nuk arriti ta bëjë koha është ndërkomunikimi më i qëndrueshëm kulturor mes shqiptarëve. Ende nuk hasa ndonjë libër tëndin në ato dy librari që i kemi ne shqiptarët e Maqedonisë (të dyjat në Tetovë, pranë njëra tjetrës).

Je një nga autorët që lexohet në Shqipëri dhe Kosovë. Cili është reagimi yt emocional për këtë. Aq më tepër në këtë vend vetëm vitin e kaluar janë finansuar mbi 300 libra të autorëve shqiptarë nga ana e Ministrisë së Kulturës?!

V.Graçi: I kam vizituar në Tetovë libraritë; uroj zotin që *jan*ë pasi, qytete edhe më të mëdha se Tetova, në Shqipëri, nuk kanë më të tilla; blerja e librave lihet për ditët e panairit ose është porosi në stacionet e autobusëve ndërqytetës: *ma gjej këtë libër*. Jam i bindjes se libri duhet të na bashkojë, kultura laike-librore, në radhë të parë. Autorë të shquar nga Shqipëria e Kosova, sikurse i përmendët ata të Kosovës më parë, e kanë përforcuar hartën tonë identitare; copëzimet gjeopolitike e shtetërore duhet të kenë si kundërmasë qarkullimin e vlerave tona më të mira në arte, letërsi, gjuhësi, teatër, muzikë, etj, etj. Sa për ilustrim: Arbën Xhaferi ka qenë pasuri e përbashkët ndërshqiptare, e factor unifikues, sikurse është i tillë dhe Ismail Kadare, krijimtaria e tij letrare. Nuk më ngushëllon fakti kur një shqiptar nga 'jashtë' interesohet në Tiranë, qoftë dhe për ndonjë libër timin; duhet që librat të jenë pranë tyre si "kështjellë drite e shprese". Shifra prej 300 librash të sponsorizuar pwr njw vit, është frikësuese; nuk premton cilësi, nuk e shenjtëron librin, përkundrazi. Librin duhet ta mbajw gjallw dashuria e lexueswve, jo vetwm sponsorizimi nga lart. Dëshirat dhe sfidat i kemi të përbashkëta? Po rrugëzgjidhjet? Cilat mund të jenë? Mund të na përmendni disa personalite letrare me ndikim përbashkues?

L.Haziri: Mund të rropatemi unë e ti duke organizuar ndonjë aktivitet të përbashkët, ndonjë promovim, lexim apo debat kulturor, i cili do të kënaqte shijen tonë krijuese, por atë që mund ta bëjë politika përmes levave të saj institucionale, atë që mund ta bëjnë shtëpitë botuese, universitetet tona dhe mediet, besoj se krijon një kohezion të qëndrueshëm kulturor. Këto institucione duhet të ngriten mbi deklamimin "jemi një kulturë, një letërsi". Ministritë e kulturës duhet të mundësojnë qarkullimin më të lehtë dhe më të privilegjuar të librit nëpër kufinj, shtëpitë botuese duhet të botojnë dhe promovojnë më shumë libra të autorëve shqiptarë (së paku 10 nga ato 300!), duhet të debatojmë më shumë, siç debatojmë unë e tinë këtë bisedë, ...dhe shumë e shumë mundësi tjera që unë nuk i di por, besoj, nëpunësit e ministrive i dinë mëmire se unë. Me këtë të fundit, nuk besoj se politizohet letërsia, përkundrazi, krijohet hapësirë më e madhe me ajër të freskët. Sepse, jemi të mbyllur brenda dhomave të një shtëpie dhe secili hap dritaret, por jo edhe dyert.

Për fund, duke dashur që të mos tingëlloje si laritje, por ajo që bën gazeta *Exlibris* me botimin e autorëve nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe diaspora, dhe këtë e bën me ngul, atë që bëri psh., Onufri me botimin e librit me poezi të poetes së re Nurie Emrullait, dëshmon se interkomunikimi vetëm mund të na i freskojë përmbajtjet kulturore. Se, letërsia shqipe në Maqedoni nuk është vetëm Luan Starova, Kim Mehmeti apo Resul Shabani, por këtu krijojnë edhe shkrimtarë të tjerë të cilët mund ta begatojnë letërsinë shqipe. Duhet vetëm të hapim dyert pa zile!

Ju falenderoj. Kënaqësi që biseduam.

NË NEKROPOLEN NË VINJANI, PRANË IMOTSKIT (HRVATSKJA), QËNDRON GURËVARRI, NË TË CILIN ËSHTË GDHENDUR PORTRETI I VALLTARES, KRYEVEPËR E MJESHTRIT TË PANJOHUR.

TAKIMI ME LIBRIN, GURIN DHE ME POETIN

Nese poezia është takim- e i atillë më është shfaqur deri tani-atëherë takimi me Valltaren ka qenë i trefishtë dhe gjithsesi i pambaruar.Takim me Librin,me gurin dhe me Poetin.

Në muajin shkurt, kryeredaktorja e revistes " Mundësitë" e Qarkut Kulturor të Spliti dhe ligjëruese e Fakultetit Filozofik në Split Katarina Dalmatin më luti ti përzgjedh poezitë për përmbledhjen Valltarja në gurë. I kam përzgjedhur ato të cilat pas leximit me zë në banesen time të përkohshme në Katovicen polake tingëllonin imotikisht. Takimi me librin është zhvilluar edhe më vonë, atëherë kur kisha dëshirë për lirikë shkëmbore,kur Mirashi me pedantëri dhe paimponueshëm e dërgoi versionin përfundimtar. Duke e ditur se autori dëshironte që vargjet t i përcillte me fotografi gurëvarrezash,në të cilet gjendet frymëzimi i tij , i ofrova ndihmen time.

Takimi me gurë u bë gjatë ditëve të gushtit, kur unë me babain, sipas zakonit të banorëve të Krahines se Imotskit, shkoja për pazar në Hercegovinen e afërt. Gjatë mungeses sime shtatëvjeçare nga Kroacia,e kam përseritur këtë rrugëtim, kurdo që jam kthyer në shtepi në Zagvozd. Edhe babai edhe unë kalonim pranë shenjes se lokalitetit Rudezh shumë herë, pa ditur s e në majen e fshatit fshihej grumbulli prej dhjetë gurëvarrezash, prej të cilëve njeri do ta frymëzojë poetin e madh malazez. Deri t e shkurret në mes as që do mbërrinim pa ndihmen e banorëve vendas. Na e tërhiqnin verejtjen se ato ishin mbulluar nga dheu duke na treguar në gurëvarrin e ngritur, lart, në hyrje, pranë murit të tharë e të ultë. Kemi ecur gurishtes, ferrave dhe nepër insekte ,kemi vështruar dhe kemi pyetur se vallë a ka në afërsi edhe ndonjë gurëvarr, me figurë njerëzore. Vetëm gurrëvarret e Rudezhit thanë ata. Hoqem dorë.

Derisa ishim në Hercegovinë, Mirashi e kontaktoi Domagoj Nikoliqin, i cili tashmë e kishte gjetur Valltare dhe e kishte fiksuar me fotoaparat , duke i ngjyrosur ornamentet dhe fytyrën e saj , mbase shquheshin dobët. Sipas udhëzimeve të Domagojit dhe sipas fotografisë të gurëvarrit që ma kishte dërguar, u ktheva në shkurre. E kërkova figuren e



Valltarja në gurë

poezi nga

MIRASH MARTINOVIQ

femres mes diellit e hënës . Dhe u gjeta në gurin sipër të cilit tashmë kisha shkelur. Mbuluar nga toka dhe nga fletët. E fjetur. E gdhendur.Valltarja.

E pashkathtë për shkrepje fotografie të gurëvarrit, u përpoqa ta kapja fytyren e saj. Stina e motit dhe piku i ditës nuk ishin në favorin tim . E kuptova pse Domagoj e kishte ngjyrosur me shkumës.

Autori me padurim e priti foton autentike, burimore të Valltares, vetëm atë që vitet, stinët,të reshurat dhe dheu nuk e kishin shlyer- pak, fort pak. Pastaj Mirashi kishte konkluduar se do të mund të shkruaja fjalen hyrëse për këtë libër të tij, pasiqë isha nga trojet e gurëvarreve dhe e baladave të Krajines dhe varri i Vukut dhe Hasanages. Të prirura për rrëfime,vallezime e mitizime dhe për dialogun me natyren dhe me historinë.

Iu përvesha punës që serish ta rilexoj Valltaren. Sigurisht do të duhej që në këtë sprovë t i thoja disa fjalë kësisoj-Valltarja në gur përbëhet nga Legjenda hyrëse dhe 53 poezive të pasistemuara nëpër cikle, kurse tematikisht të spirancuara perreth gurit, malit, flores dhe faunes se shkëmbit. Poeti flet përmes zërit të vajzës /nuses/amvises, furnizuese të Krajines se Imotskit. " E mrekulluar " verbalisht është prezente në poezinë "Mrekullibërsja" shtrihet në tërë librin. Kështu , lexuesi i porosisë së Valltares e merr drejtpërdrejt, spontanisht, instiktivisht, me të gjitha ndjenjat. Sëbashku me subjektin lirik i dorëzohet shijimit ëmbël-ithtë të pritjes dhe soditjes aktive të saj nga shkurret,deri në mal, deri tek amshimi. Në fund, në pritje të dasmës, të ndryshimit, të lirisë, Valltarja zbulohet edhe si poete.

Fjalet i ka mbjellë
Secilen në shtëpizen e vet,

Ka lutur
O foshnjet e mija të palindura

Fjalet e mija
Të palindura

Do të duhej që në këtë sprovë të thuhej diçka ashtu. Sepse nese them se edhe unë jam kapur për muri dhe se pikërisht për shkak të gurëvarrezave dhe për shkak të oralitetit me të cilin Krajina ime frymon, e që Mirashi e ka zotëruar e ka kapur, e ka gdhendur në vargjet e veta, pra nese them se jam kthyer në shtepi dhe aty kam vendosur të mbetem –do të ishte shumë personale për një fjalë hyrëse. Edhepse takimi im me autorin LIVE nuk ka ndodhur, libri i tij më ka përforcuar bindjen se vetëm kur gurëvarri vrojtohet nga largësia,nga Mali i Zi ose nga Polonia,është e mundshem që të ndjehet, të përjetohet shtëpia. Më vendore sesa zakonisht

Faleminderit Valltares dhe faleminderit poetit.

Në Split, 12 shtator 2020
Ivana Çagal

PSE MË KE LINDUR

Pse më ke lindur
Më ka vrarë bukuria

Më kanë xhelozuar
Yjet

Që ato xhelojnë
Vdes para kohës

Kismeti më sodit
Mua

Kur e shohin se jam e bukur
Pse dikund nuk më hedhë

Mendon sëpaku për njl çast
Do të vret bukuria

Diellin e çuditur
A e ka parë

E që Dielli
E xhelozon

Diellin nuk e pret

NUMËROJ

I numëroj yjet
Në qiell
Diellin gjithësaherë
E pres

Ndonjëherë dëgjoj
Drenin
Sesi e grishë drenushen
Do të doja që kodren
Ta tund
Por guri

Përmes luleve
Të vrapoj
Deshi
Por guri

Nuk mundem

Desha që lulen
Ta mbledh
Që me lule
Të stolisem
Që me vesë
Të lahem

Grurin ta korrë
Ta lidhë në duaj
Kokrra të mbledhi
Mbjelli
Në hullinë e re

Të përzgjedhë
Dhëndrrin
Nuse të jem

Do të doja
Por si
Guri

Nuk më lejon

KAM ËNDËRRUAR

Kam ëndërruar
Bjeshkën e madhe
Në bjeshkë
Nga thellësia
Burimi vlon
Në burim dreni
E shuam etjen
Dhe dielli
Etshëm
Kurrsesi
Ta shuaj etjen
Mengjesi përgjumet
Përshtatet
Dhe mengjesi ngopet
Bjeshka ndriçohet

Vrapoj fushes
Se gjërë
Vrapoj bjeshkës
E etshme jam

MOLLA E ARTË

Kam ëndërruar
Mollen e artë

Bjeshkës kalërojnë
Krushqit
Papritmas vriten
Lindin varre
Në bjeshkë
Në mes
Molla e artë

Në mollë
Unaza
Në unazë qielli

Flet

KËNDOJNË

Këndojnë
krushqit e vdekur
Këndojnë këngë të pikëlluara
Cila bjeshkë, cila bjeshkë
Bisedë nuk ka
Oh, kjo bjeshkë
Shkëmbore
Bisedë nuk ka
Vajtoj numëroj
Krushqit
Nuk është dhëndrri im
Nuk ka varr të tij
Sodis në qiell

I dashuri im
Është yll

(Kundrim analitik i veprës së Ernest Markut: "Libri i Fishtës", Botimet Fishta, Lezhë 2020, fq. 438)

BIOGRAFEMA E LIBRIT FISHTIAN

Prend BUZHALA

Cili është Fishta i këtij libri?

Më saktësisht, ç 'përmban *"Libri i Fishtës"?*

Ky libër vjen si biografi e shkrimtarit dhe biografi e librit fishtian, është një kronikë shtjelluese e ngjarjeve të kohës dhe ndërtim i kontekstit të zhvillimeve historike, shoqërore, kulturore, letrare, gjuhësore, po edhe proklitike. Kund e kund, edhe letërsi folklorike, anekdotike. Një leksikon brenda vëllimit, që përmban veprat e Fishtës dhe shkrimin e tij imagjinativ (poezi, dramë) e shkrimin e tij diskursiv (shtjellime, publicistikë, eseistikë, studime, kronika, fjalime etj. etj.), të përcjella me nga një shënim komentues të autorit. Do të thoshim, është edhe historia e receptimit (e leximit nëpër kohë) e veprës së Fishtës për të gjallë të tij dhe pas vdekjes së tij. Pas veprës së Daniel Gjeçajt *"Gjergj Fishta: Jeta dhe vepra",* ky vëllim vjen më i ploti në këtë drejtim.

1. Njësitë tekstuale të biografemave

Kur Roland Barthes krijoi nocionin *biografemë* (biographème), kishte parasysh njësitë tekstuale që i ngërthenin pikat kryesore të jetës, librit dhe veprimtarisë, për ta thurë, mbi to, reflektimin apo mbitekstin biografik. Më saktësisht, për t'i dhënë liri kënaqësisë së tij të shkrimit: a është më shumë shkrimtar apo biograf i mirëfilltë autori i asaj vepre, për këtë vendos vetë autori. Janë ato detajet e vogla (biografemat) që shndërrohen në rrëfim të mirëfilltë jetësor; për të mos i dhënë librit një lexim datash "pa gjakun" historik e jetësor. Është njësoj si të thuash jeta e tij dhe jeta e kombit, historia e letrave shqipe dhe e kulturës sonë,. Është shpirti ynë nacional. Libri dhe Fishta janë një binomi i parë i pandashëm. Është receptimi i djeshëm e si sotëm i veprës së Fishtës në kohë e nëpër kohë. Vijnë, si dëshmi e shumëfishtë, kujtime, letra, dokumente, raporte shtetërore, religjioze apo të survejimeve e shërbimeve sekrete, shkrime analitike, polemika, korrespondenca, shkrime të shtypit të kohës,

Dhe të tilla detaje, pra, të tilla biografema, ky libër është i mbushur fillim e fund. Janë ato pjesë që e zbulojnë më mirë jetën e një shkrimtari, gjenezat e shkrimit a të frymëzimit, ashtu sikundër autori ato i jep në shumë pjesë të librit. Pjesët e tilla janë jo vetëm dëshmi po edhe rrëfim dinamik, i shkrirë natyrshëm në strukturën e kësaj vepre. Roland Bart na e sqaron se biografemat i referohen edhe artit të kujtesës, "një memento mori, për një evokim të mundshëm të tjetrit që nuk është më."

2. Nga receptimet e veprës së Fishtës e deri te shkrimi gjenealogjik

Që në ballë të librit lexojmë dy moto-tekste, që ngërthejnë kryenocionet: komb dhe kulturë. Në të vërtetë, sado që ky libër ngërthen një lëndë të gjerë e tejet të pasur dokumentare, dhe lëndë të pasur shtjellimi, autori që në fillim na e tërheq vëmendjen edhe te procedimi i mbarështrimit të kësaj lënde:

"*Ata (pra konsuelentët) ngulmonin në skrupolozitetin e paraqitjes sa më shkencore të materialit, kurse unë më tepër shqetësohesha, për të lehtësuar qasjen e lexuesit drejt një informacioni të qëmtuar me kujdes e të kuruar me dashuri."*

Kjo do të thotë që në sfondin e ligjërimit diskursiv të këtij librit gërshetohen dokumenti, citimi shkencor e burimet historike me romantikën e përshkrimit; më saktësisht, autori dëshiron të na e nxjerrë në pah madhështinë e Fishtës nëpër dekada e pas vdekjes së tij, nga njëra anë, ashtu sikundër rrënjët e kësaj madhështie i kërkon edhe te lashtësia jonë apo te kulti pellasgjik fishtian.

E pra, autori dëshiron që lexuesi të jetë ai si pjesë e tekstit, për ta identifikuar **receptimin shumështresor e shumëplanësh të veprës së Fishtës.**

Leximi i veprës së Fishtës dhe jetëshkrimi i tij, mbas shumë dekadash, na ballafaqon me njohjen aq gjeniale të Eliotit që e shfaqi në esenë e tij *"Tradita dhe talenti individual"* mbi dialektikën e së kaluarës në të tashmen dhe të së tashmes në të kaluarën. Do të na ballafaqonte me atë proces të komunikimit, në të cilin tipat e receptimit të veprës e të horizontit të pritjes (Jauss) riaktualizojnë gjithnjë lexime të reja, rilexime, lexime konvergjente e divergjente; do të na hidhte në vatrën e leximeve kontekstuale; do të na ballafaqonte me kontekstet shoqërore e historiko-letrare. Dhe këtë lëndë të ndërliqshme arrin ta pushtojë me sukses edhe autori Ernest Marku, ani se kësaj radhe nuk i ka cituar a po të jetë ballafaquar me studimet e shumta monografike që i janë bërë veprës së Fishtës e që është shenjë e mirë e kohës sonë: se vepra e një shkrimtari jeton nëpërmes leximeve dhe studimeve.

Janë edhe pasionet e autorit për të qëmtuar *shkrimin gjenealogjik,* shkrime aq të pakta në letrat tona, siç vijnë këtu pjesët për pemën gjenealogjike të familjes së Gjergj Fishtës (kapitulli *"Historia e të parëve dhe pema gjenealogjike").*

Autori e përcjell veprimtarinë e Fishtës nëpër ambiente të ndryshme: nëpër ambiente shkollimi e hapje shkollash, nëpër ambiente malesh, fshatrash të thella e nëpër ambiente urbane, akademike apo të laboratorit krijues; nëpër ambiente revistash, librash e gazetash, nëpër vizita, udhëtime, takime e konferenca ndërkombëtare në mbrojtje të shtetit shqiptar e të çështjes shqiptare, në Evropë e në Amerikë, nëpër kongrese shqiptare si ai i alfabetit apo në jetën politike gjatë gjithë atyre dekadave. Kur autori përpiqet ta japë panoramën e kontekstit historik, kulturor e shoqëror, ai arrin të japë edhe sinteza të pëlqyeshme.



3. Konteksti historiko-letrar, kulturor dhe shoqëror

Por Fishta nuk është vetëm shkrimtar.

Është Fishta i ideve të mëdha e kumbuese të kohëve, nëpër të cilat u përbirua kombi ynë; Fishta i ëndrrave të mëdha dhe i zhgënjimeve të mëdha; por, gjithnjë në fund, është ai Fishta i Madh që porosit: mos hiqni dorë nga ëndrrat e mëdha, nga idetë që çojnë përpara, mos hiqni dorë as nga shpresat e mëdha. Ai, duke e përjetuar gjendjen shoqërore e historike në dy shekuj, në dekadat e fundit të shekullit XIX e në katër dekadat e shekullit XX; duke e përjetuar dramën e kombit e duke u ndeshur me gjendjen e padurueshme të jetës shoqërore e historike; ka ditur si ta shquajë vizionin e tij, si ta zhvillojë punën titanike të palodhshme në dobi të letrave shqipe e të kombit shqiptar; ka ditur si t'i durojë dhimbjet aq therëse të tragjedive shqiptare, me bindjen e fortë se një ditë fitorja do të jetë në anën e lirisë, në anën e kombit, në anën e letrave shqipe e të shpirtit kulturor shqiptar. Dhe kush më shumës e ai ka investuar në këtë gjë!

Këto përqasje vizionesh, përpjekjesh, përjetimesh, vlerash, ndeshjesh dramatike, arrin të na i japë me dorën e sigurt edhe shkrimi i Ernest Markut. Dhe, duke e pasur parasysh kërkesën e shtresave të shumta të lexuesve, të duket sikur po e lexon romanin e jetës së Fishtës, me aq shumë aventura, përjetime e ndodhi të papritura e përplot rreziqe. Është Fishta që pothuajse secili regjim a shtet që trupoi këndej, ia ndalonin gazetat a revistat për të mos i botuar, e kërkonin për ta burgosur madje edhe likuiduar.

Duket sikur ekziston një rregull i pashkruar historik, që, te figurat e mëdha, do t'i hasim arketipin e kundërshtarit tendencioz dhe arketipin e bashkëpunëtorit. Nuk është e habitshme përse nëpër faqet e këtij libri parakalojnë personalitete shqiptare të kohës dhe personalitete të huaja, intelektualë dhe shkrimtarë, publicistë dhe fletorarë, politikanë dhe diplomatë, ambasadorë dhe guvernatorë, pashallarë dhe perandorë, klerikë dhe njerëz të thjeshtë.

Shpalosja e kujtimeve dhe shpalosja e vlerësimeve, arti epistolar fishtian dhe arti i oratorisë së tij, përbëjnë po aq përkushtim zhdrivillues e trajtues te vepra e Ernestit.

4. Struktura e librit

Kështu na paraqitet te pjesët e këtij libri, që mbajnë titujt: *Rinia, Bosnja, Kthimi, Shkodra dhe poezia, Alfabeti, Teatri, Luftërat dhe publicistika, K. e Paqes, Shqipëria e re dhe "Gomari i Babatasit", Nga i zhgënjyer në akademik, Viti i fundit, Koha pas, Ferri, Purgatori, Ngjarjet më të rëndësishme të Jetës, Nderimet që ka marrë dhe Pasqyrë e veprës letrare.*

Fishta, te ky libër, na shfaqet me portretin e tij më të plotë, po ashtu, edhe nëpërmes artit të oratorisë klasike shqiptare e nëpërmes artit epistolar, nëpërmes mjeshtërisë së polemikës, reagimit të rreptë, me gjithë intelektin e tij enciklopedik, me ballafaqimet e shumta me qarqe politike e politikanë të perandorive e shteteve evropiane të shekujve XIX e XX, me rryma mendimi e rryma idesh çorientuese, sa edhe ekstreme të tipave diktatorialë, aq edhe kaotike e anarkike; na shfaqet me shembujt e mëdhenj të jetës e të veprës së tij, shembuj sa të thjeshtë aq edhe domethënës e që i shërbejnë letrave tona dhe historisë sonë si mësuese e jetës dhe mësuese e përvojës historike.

Do ta kemi të zorshme ta konceptojmë se si ka arritur t'i përballojë aq shumë ato kohë të errëta dhe si ka arritur të japë aq shumë mund, vlera e krijimtari titanike në ato kushte të paimagjinueshme. Thuajse secila kohë e tillë ishte një sfidë për të dhe ishte ky

që i sfidonte ato kohë, gjithnjë duke dhënë mesazhe ndërgjegjësimi, mesazhe frymëzuese e mobilizuese. Sa herë që kombi ynë është gjendur në ngushtica të tilla historike, të brendshme e të jashtme, Fishta e shquan shtegun e ri për rrugëdalje, spikat një ide të re, gjen mënyra të reja për ta arritur qëllimin e lartë. Dhe nuk është e rastit përse ai te *"Lahuta e Malcis"* spikat vlerat e qëndresës e të përballimit të vështirësive. Vetë autori jep vlerësime për *"Lahutën..."*:

"Kjo është vepra që iu blatohet shqiptarëve, për t'iu përkëdhelur sedrën e krenarinë... Kjo vepër duhet lexuar edhe si një kundërpërgjigje që poeti iu bën eposeve të popujve të tjerë sllavë të Ballkanit, duke i nxjerrë shqiptarët si fitues moralë nga ky debat politiko-shoqëror, jo vetëm për faktin se ata janë autoktonë në këto troje, por edhe për faktin se, e drejta e shqiptarëve, për të jetuar të lirë në trojet e veta, prevalon mbi të drejtën e serbëve, për të pasur një dalje në detin Adriatik. Erudicioni i Fishtës, njohja prej tij e historisë dhe kulturës botërore, njohja e filozofisë së jetës së Perëndimit, njohja e teorive të së drejtës që mbizotërojnë atje, së bashku me talentin e jashtëzakonshëm dhe pasurinë e "pafundme" gjuhësore që "derdhen" në këtë vepër, e bëjnë "Lahutën e Malcis" kryepoemën kombëtare shqiptare, kurse autorin e saj Homerin e kohëve moderne."

5. Fishta i kohës sonë

Duket sikur secila vepër e Fishtës prek dimensione të reja të qenies personale dhe të asaj njerëzore. Kësisoj, te *"Gomari i Babatasit"* dhe *"Anzat e Parnasit"*, siç thotë autori, *"duke patur frikë se mos iu ushqen sedrën e sëmurë dhe krenarinë boshe, Fishta i kundërpërgjigjet entuziazmit të vet patriotik, me sarkazmën e 'Anzave të Parnasit'."* Ndërkohë që *"Mrizi i zanave"* dhe *"Vallja e Parrizit"* e shquan lirizmin e tij atdhetar dhe të të përshpirtshëm, kurse vepra dramatike shquan alegoritë, tematikën komplekse të shpirtit njerëzor, të historisë e të tragjedive njerëzore.

Secila kohë e ka Fishtën e vet.

Dhe secili lexues i Fishtës e ka historinë e leximit të veprës së tij. Dhe ky lexim është i mbushur me përvojat dramatike pothuajse të secilit prej nesh: duke filluar nga mohimet e ndalesat e leximit të veprës së tij nën regjimet totalitare e deri te shpërthimet e botimit të veprave të tij e te interesimet e gjithanshme sot për jetën e veprën e tij. Është e natyrshme që figurat e mëdha të ngjallin interesim të gjithanshëm aq sa edhe polemika, qasje e kundërqasje. Fishta i Ernestit nuk na vjen më afër nesh me të tjera përmasa dëshmie e studimi, ndryshe nga ato të shkrimit akademik e akademizues. Në letrat e sotme shqipe Fishta vjen nëpërmes studimeve monografike të mirëfillta, siç janë doktoratat apo studimet e mirëfillta analitike. Pothuajse Fishta shfaqet ndër krye-emrat e letrave shqipe që ngjall interesimin e pandërprerë, të përhershëm.

Letrat shqipe kanë nevojë edhe për qasje të tillë shpalimesh, jashtë këtyre kornizave, siç është *"Libri i Fishtës"* i Ernest Markut. . Një boshllëk të tillë e përplotëson ky libër. Po e quajmë "libër", sepse ashtu që në titull e quan autori.

Përtej një studimi të tillë të rrafshit analitik, ky libër na ofron diçka tjetër; na i vë në tryezën e leximit vëzhgimin, shkëputjen e detajit jetësor e libror, Fishtën e Gjallë të jetës, të Historisë, Fishtën e kohëve që i lamë pas dhe Fishtën e kohës sonë. Ka se çka t'i ligjërojë vepra e tij kohës sonë, me satirën e tij ndaj drejtuesve të shtetit, me idealet për shtet-bërje, me zgjimin e krenarisë së të qenit shqiptar, siç është vepra e tij epike, me përmasat e të përshpirtshmes, siç janë shkrimet e tij poetike spirituale, me ndriçimin e esencave shkencore e diskursive të qenies sonë që na i ofron shkrimi diskursiv fishtian, me Fjalën e Guximit përballë më të mëdhenjve të botës, kur cenohen interesat kombëtare.

Libri i mirë hap shumë dyer, dhuron dritë kur ndriçon fakte, rrjedha kohe, jete e vepre. Ky libër i Ernestit na bën të dukemi mirë dhe të ndjehemi mirë. Dhe të bërit libër është ai ideali i hershëm autorial, që nga Buzuku e këndej: ta kemi Librin Tonë. Në këtë rast: ta kemi Fishtën Tonë.

NJË KRYEVEPËR E REALIZMIT SHKENCOR

(Dialog me Matteo Mandalà)

Zija Çela

Zija ÇELA: Sa tërheqje në lexim! E ku? Pikërisht në shkencë, ku njeriu mund të thyejë kokën, nëse nuk është lexues i fushës.

Zoti Mandala, Matteo i dashtun, gjatë jetës sime kam pasur në dorë ca libra të këtij lloji, ndonjëri i paharrueshëm. Por me gjasë asnjëherë një të tillë, ku një konflikt madhor të jetë kaq intrigues nga kreu deri në fund, kaq thellësisht studimor, kaq thellësisht letrar dhe, njëherësh, me kaq volum plot bereqet. E kështu, për befasimin tim, më vjen si "romani" më i bukur i REALIZMIT SHKENCOR.

E kam lexuar ngadalë, për të shijuar më mirë paradoksin e madh. Por edhe duke bluar me vete herë-herë një pyetje enigmë. Si shpjegohet vallë që një shkrimtar i trillit, i cili i iken realitetit të drejtëpërdrejtë për të krijuar të vërtetën fiksionale, lexon me etje një shkencëtar, që falsifikimin e fiksionit e përjashton ngulmueshëm nga hudhitë e reales historike?!.. Një "përplasje" e skajshme antagoniste që, megjithatë, çuditërisht kthehej në harmoni. E ndieja, e ndieja si prodhohej pak nga pak mrekullishëm ky pajtim i ndërgjegjeve krijuese.

Matteo, ti sikur po më falisje me gjithë ato bukuri, ato dije që nuk shternin, ato episode të ndërlidhura e të ndërkallura që pasonin njëri-tjetrin, gjithë ato personazhe komplekse përgjatë rrëfimit hulumtues, gjithë ai informacion historik e kulturor, ato referenca të ndershme pa asnjë kusht dhe, mbi të gjitha, forca bindëse e argumentit, ajo energji e analizës së pamëshirshme (mizore!) që e ndante me aq precizion historiografinë e faktit nga ajo e sajimit, mitit e eposit, po ashtu siç veçonte fillesat burimore nga përdorimi ideologjik.

Dhe sa solid në strukturë! (Vite më parë, në një nga

romanet e mia jam përpjekur afërsisht për të njëjtin kompozicion, a thua se ende pa u njohur, Zoti e dinte se ndonjë ditë do të na bënte bashkë.) E kam si para syve përfytyrimin që më jep libri yt. Ai ka një strukturë si katedrale gotike, jo ftohtësinë, por madhështinë e saj dhe gjithë sa gjej brenda mua sikur më magjeps. Ka të drejtë Aurel Plasari kur, me sigurinë e sprovuar të botës së tij albanologjike, e cilëson si libër të pagoditshëm ndaj çdo sulmi.

E pra, sipas meje, ti ke shkruar një model të historiografisë shkencore, Matteo. Nisur nga e shkuara, na ke dhënë një kryevepër referuese për sot e për të ardhmen.

Dhe, tani, të kërkoj ndjesë për termin "roman". Por një romancier e sheh subjektivisht si kryeterm edhe në shkencë, kur përveç kritereve të saj të rrepta, gjen tek ajo gjithashtu bukurinë e epërme estetike.

Matteo MANDALA: Zija i dashur, s'ke përse të më kërkosh ndjesë. Ti si romancier që je, e nuhate më mirë se studiuesit e historisë thelbin e çështjes së librit tim: historiografia dhe letërsia - romani, pra - janë dy faqet e së njëjtës monedhë të ligjërimit njerëzor. Kur "flasim" për të kaluarën, këto dy forma ligjërimesh përputhen plotësisht. Na e mësuan mendimtarët e mëdhenj (Hegel e Croce, p.sh.) dhe romancierët më të mirë (nuk t'i përmend, se ti i njeh më mirë se unë duke qenë vetë një nga ata Mjeshtra të penës dhe të mendjes). Mua, si nxënësi yt [...], më takon vetëm të gëzohem për fjalët e tua plot dashuri e miqësi që i drejtove librit tim.

Ai libër më solli shumë nderime këtu në Itali, por vlerësimi yt ia kaloi të gjithave. Shumë faleminderit, i dashur Mjeshtër dhe Urimet tona më të mira për vitin 2021.

MEDITIM: Sa mëkatarë tregohemi herë pas here kur fryhemi, vetëpërkëdhelemi e llastohemi, bëhemi deri edhe mitomanë për dy gisht letër me pak gjë ose hiçgjë. Dhe çfarë përunjësie dëshmojnë mendjet e hapura, personalitete që kanë prirje të gjenialitetit, para modestisë së të cilëve të vjen të dorëzohesh me zemrën në dorë. (Shënimi im, Z.Ç.)

VEPRAT E AZEM DELIUT – LIRIA ME "KRIMBIN" E NJERËZORES/ HUMANES BRENDA

Ballsor Hoxha



...Pikërisht këtu është çështja, e dashur. E arsyeshmja s'e bën botën as më të mirë as më të keqe. Bota është e papërmirësueshme. Të thash se e ndiej në çdo çast praninë e vdekjes. Duket sikur ajo ka filluar të frymojë fare pranë meje. ... në fund të letrës, m' u si në fundin e një dremitjeje të gjatë e të mundimshme, gardiani pa pak lagështirë... ("Puthësi i paligjshëm")

Azem Deliu është shkrimtar i cili e rikthen një letërsi të largët prej arritjeve letrare të letërsisë shqipe, rikthen një letërsi mjeshtërore. Ai, në tërë vërtetësinë e mjeshtërisë letrare, krijon shoqërinë dhe botën në tërë lakuriqësinë e ankthit të saj ndaj pandreqshmërisë së po të njëjtës në përhershmëri.

Deliu në dy veprat e tij "*Puthësi i paligjshëm*" dhe në "*Shënimet e krimbit Smolinski*" shpërfaq mitin për lirinë/ideologjinë, apo njërën të pandashme nga tjetra. Dhe në tërë mjeshtërinë e tij, e shpërfaqë atë prej përbrenda saj si të paikshme nga ankthi i temporales, përkohshmërisë së njeriut dhe me këtë ankthin për të kontrolluar dhe për të 'vdekur' të paparashikueshmen njerëzore. Në të vërtetë, krahasuar këto dy vepra, është krejtësisht paradoksale, Deliu krijon lirinë përbrenda Ideologjisë më të tmerrshme, aty ku ndalohet dashuria, duke i dhënë lirinë infinite ndalesës, apo thënë më saktë rendit, dhe renditjes së çdo gjëje, deri në emocionet e njeriut. Derisa në novelën tjetër "*Shënimet e krimbit Smolinski*" e jep lirinë ashtu si është sot, pas ideologjive komuniste, si ankth, po ashtu, si ikje dhe si e paikshme nga paparashikueshmëria e njeriut, duke vendosur një "krimb" si personazhi i Smolinskit pëbrenda kësaj lirie.

1.
"*Puthësi i paligjshëm*" – ideologjia si liri

... - Ku jam? –

- Je në vendin tënd të punës....

- Unë punoj në burg zotëri – u çudit gardiani

- Pikërisht pra. Në vendin tënd të punës je. Veçse, ke ndërruar pak rol.

Në novelën "*Puthësi i paligjshëm*" sekuencat e narrativit, megjithëse realiste, kanë kalimet e tyre të cilat sikur nënshtrohen, dhe aq më shumë përshkallëzohen dhe shtrihen si – shtretër të burgut –, e burgu në të vërtetë siç thuhet në këtë novelë është "*mendja e njeriut*". Janë – shtretër burgu – në të cilin gjendesh, zgjohesh nga 'gjumi', i zënë, i kaluar, i shndërruar nga i privilegjuari në të burgosurin.

Më tutje, në fillim të novelës, personazhi "*34*" pasi që ka dëgjuar në një fjalim... *- A nuk jemi të gjithë shokë të barabartë? – ...,* pyetet në vete *... tentoi të kujtonte emrin e vet të parë dhe, kur e pa që s'po ia dilte, iu kthye pyetjes...*

Një herë pasi që është shtrirë – gjumi – dhe pafuqia e individit në një përkufizim të kudondodhshëm dhe gjithëpërfshirës, pasi që emrat, të harruar në këtë shtrat, janë hequr të papërdorshëm, individi, apo shtytja individuale në njeriun, vetë instinkti, kërkon identitetin e vet. Kërkon identifikimin e vet, kërkon kufirin e vet, atë që e bën.

Janë dy shtresa që mjeshtërisht shtrijnë në gjumë, në – shtratin e burgut të zvetënimit – individin: ndalimi i çdo gjëje, për të vënë një rend mbi çdo gjë; dhe më tutje harrimi/zvetënimi i njeriut në këtë ndalim, në këtë rend, në këtë pamundësi të prishjes së rendit. Në të vërtetë prishja e rendit është aq e thellë në këtë shoqëri të "*Puthësi i paligjshëm*" sa që njeriu e censuron, e kapë, e dënon dhe gjykon veten në intimitetin më të thellë të tij, qoftë edhe duke menduar:

... ja pikërisht tani, ai po pendohej për këmbëngulësinë e tij por, ai e dinte se pendimi ishte diçka që i takonte çastit, kurse qëndrimi përjetësisë. Pyetjen "A mund ta ndryshojë pendimi qëndrimin?" vetes ia tha në trajtën e përkthyer "A mund ta ndryshojë çasti përjetësinë?" dhe menjëherë thuajse frikësohej nga ikja e mundshme e pyetjes, u përgjigj "Përjetësia ndërtohet nga çastet, për të mos thënë që çdo çast është i përjetshëm." Por, mendoi menjëherë, a mos po them që çasti dhe përjetësia janë e njëjta gjë?...

Por, këtu, gjykimi i vetes për 'individualizëm' qoftë edhe në intimitetin më të thellë në të vërtetë është sipërfaqësor. Loja e autorit Deliu këtu, me – përkthimin – e pendimit në çast, dhe të qëndrimit në përjetësi është lojë e ndikuar (indirekt) nga Kierkegaard dhe pasuesi i tij Heidegger. Gjë që në të vërtetë, sipas Heidegger, njeriu në Temporalen, e ndanë kohën në një çast (influencuar nga Kiekegaard) dhe aq më shumë, në çast i cili i ikë dhe e bën të Pa-vërejtshme Temporalen e pevitueshme, si hije që ndjek njeriun në çdo gjë. Aq më shumë sipas Heidegger çasti bëhet i përhershëm si ikje nga ankthi i vdekjes në praninë, në rajonin e jetës sonë. Dhe në

këtë, Qëndrimi (apo Resolutness sipas koncepteve Heideggeriane) është vetë përballja/hapja e njeriut ndaj temporales/ankthit të vdekjes.

Në këtë dinamikë, në mes këtyre dy pjesëve të cituara dhe të shtjelluara lidhur të "*Puthësi i paligjshëm*" ndërmjet shtrirjes në gjumë të përhershëm të shoqërisë, në universalen e saj, dhe të nxitjeve dhe shpërthimeve si ky në pjesën e dytë të citimit, apo sikur në letrat e personazhit Shollohov, lexuar nga gardiani i burgut, është loja mjeshtërore autoriale e Deliut me atë që ai e quan Qëndrueshmëri, apo që sipas koncepteve Heideggeriane do të ishte Resoluteness (vendosmëri) përballë ankthit të vdekjes, apo në jetë.

Sipas po kësaj njeriu shpikë ideologjinë, dhe tërë shtjellën e qeniesimit si një Publike, e cila në të vërtetë krijon Pa – vërejtshmërinë e ankthit nga vdekja, apo thënë më saktë ankthit të temporales, ankthit të paqëndrueshmërisë së njeriut dhe aq më shumë të ankthit të pamundësisë së zotërimit apo pronësimit të ekzistencës.

Në të vërtetë kjo novelë, thellë në shtjellimin e saj shpërfaq, përmes episodeve të saj që fundosen dhe shtrihen në gjumë edhe më të thellë, pikërisht Publiken e njerëzimit e cila ideologjizon, përkufizon çdo gjë në pragmatizëm të përpiktë, deri në "*orar për puthje*", apo dënim me vdekje të "*puthjes së paligjshme*", për të evituar çdo individ, dhe individi si mundësi e rastit, apo mundësi e humbjes së kontrollit apo edhe mundësi e të paparashikueshmes.

Novela është një mjeshtëri e rrallë e krijimit të kalimeve të 'përgjumjes' së njeriut në ankthin e tij për të kapur/ndalur historinë, jetën dhe kontrollin mbi njeriun, gjë që krijon shtretër, shtresa të ndërdijshme të cilat kalojnë në njëra tjetrën dhe ndërthurin një 'përgjumje' totale të individuales, e me këtë të dashurisë, instinktit dhe tutje të vetë nevojës së njeriut. Është labirint i cili ka rënë (Heidegger) nën ankthin e të qenit gjallë, dhe me këtë, në tërë ironinë, letrare, e gjen të arsyeshme edhe – ndalimin e dashurisë -.

2.
"*Shënimet e krimbit Smolinski*" – liria si ankth

Novela "Shënimet e krimbit Smolinski" ka dy masa të shtjellimit, në të vërtetë një dinamikë të ndërveprimit të masës primitive, masës që është

ngritur në kërcënim ndaj çdo gjëje të ndryshme prej saj, me masën subjektive të personazhit, prej më të arrirëve në letërsinë shqipe, atij të Piotr Smolinski, shkrimtar polak i ardhur në Prishtinë përkohësisht. Kështu duke krijuar masën e lirisë primitive/ekstreme me një krimb përbrenda saj si personazhi i lartcekur.

Është masa primitive e cila ka rënë në ankthin e pranisë së vdekjes së pakontrollueshme, të paparashikueshme, nga vetë njeriu ndaj njeriut, dhe e cila po e ngushton çdo dallim dhe çdo veçanti në inercionin e primitives dhe në dehumanizimin e çdo personaleje.

Në anën tjetër është Smolinski apo Krimbi Smolinski, i cili si epitom i letërsisë shqipe, i personazhit të "ndyrë", "subterrenian", të një morali krejtësisht të pamëshirë ndaj moralit dhe ndjeshmërisë primitive, apo edhe Publike (Kierkegaard) shpërfaq me përsiatjet e tij dhe me veprimin e tij, ironinë e tërë shoqërisë njerëzore, dhe me këtë e nxjerrë shumëfytyrshe prej brenda saj, para vetes së saj.

Në të vërtetë personazhi Smolinski është i depersonalizuar, i cili në masë të lehtë vuan përbrendësimin dhe identifikimin subjektiv në disa karaktere të imagjinuara personale. Është krimb dhe shkrimtar, dhe herë të tjera njeri. Por paradoksalisht, një krimb në mesin e një lirie primitive apo thënë më saktë të një lirie ekstreme dhe ekstremiste, që arrin të reflektojë më tutje në fajin dhe fajet e veta të cilat e kthejnë prapa thënien e novelës "Puthësi i paligjshëm" – bota është e pandreqshme.

Në përshkallëzimin e mëposhtëm të narrativit të "Shënimet e krimbit Smolinski" siç është

1. Tregimi të cilin është duke e shkruar Smolinski në Prishtinë, ardhur nga Polonia, rreth një hakmarrjeje alla shqiptare ndaj një hebreu i cili ka qenë nën mbrojtje të një shqiptari, në ironi:

... pra, - vazhdoi ai, - nuk mjafton ta vras dikë që më ka bërë ketë ç' nderim. Duhet të sigurohem që ai të vuajë sa më shumë. ... do të shkoj te pleqnari ta pyes, nëse e di ai, se si po i vret Hitleri hebrenjtë. ... nga Hitleri po e mbroja, si Hitleri do ta vras!...

2. Makthi të cilin e vuan Smolinski derisa të gjitha personazhet, ato reale dhe ato letrare të vetë tij kthehen dhe e përdhunojnë:

"rrëshqit më ngadalë, krimb Bytyqi", - tha Paweli urtësisht... Oh dreq! Ishte Hajdini ai që hynte mbrapa meje... Sapo u ktheva pashë që s'ishte Hajdini... "Ç' është kjo poezia e ngjyrave tha burri"... duke bërë gati rripin e lagur për të më rënë këmbëve... Veç kur u ktheva përmbys ngaqë ndieja mjaftueshëm dhembje përpara, ndjeva pas një prej fshikullimave një zë malor burri t'ia bënte me të madhe "hiaaaa"... pashë mbrapa meje, në vend të babait, qerrexhiun e veprës që po shkruaja.

3. Përsiatja e Smolinskit rreth përvojës së tij në Prishtinë:

Është e çuditshme prirja e primitivëve për ta bërë doemos tjetrin si veten. Ngaqë s'e kuptojnë botën përtej vetes, mundohen ta mohojnë atë

4. Përsiatja e Smolinskit pasi që e kanë vrarë të dashurën e tij prishtinase, gjë që ka ndodhur në lidhje me tregimin e tij që ia ka dërguar kosovarëve për shtyp:

Ndërkohë që e gjithë bota e shante Hitlerin, për çudi, e gjithë bota e përsëriste atë

Në këtë përshkallëzim përvoja prej subjektives, në imagjinaren e saj, dhe tutje në ëndërr, më pastaj në përsiatjet e tij të vetëdijshme rreth primitivizmit dhe po ashtu ndaj *gjithë botës që përsërit Hitlerin*, janë një qark i cili qoftë edhe në liri dhe përtej tiranisë diktatoriale, apo thënë më saktë pas saj, ngutet dhe rikrijon të njëjtën në liri, për të mbrojtur veten në pakotrollueshmërinë dhe paparashikueshmërinë e njeriut, dallimin e tij, veçantinë e tij.

Në të vërtetë problemi në përsiatjen e personazhit Smolinski që gjen fajin për fajësimin e njeriut të vdekur si dhunues të vetin, përballë një bote që imiton Hitlerin, si në tregimin e tij, si në makthin e tij, dhe po ashtu edhe në vrasjen e gazetares së ngritur nga gazetare e kulturës në gazetare të politikës, është në paikshmërinë e lexuesit/njeriut nga e "pista" e botës, nga pandreqshmëria e saj, nga ndërthurja e të mirës me të keqen, dhe nga ankthi i njeriut për të kapur pikërisht këtë të keqe brenda tij, për ta kontrolluar me imagjinatë po aq megalomane dhe po aq të sëmurë sa ajo e personazhit Hajdin Bytyqi i cili e akuzon Smolinskin për spiun rus dhe e vret gazetaren Prishtinase për një tregim krejtësisht të parëndësishëm.

Në të vërtetë tregimi, i cili bën pjesë në narrativin e novelës "*Shënimet e krimbit Smolinski*" është jetësim dhe vazhdimësi e kësaj të keqeje të njeriut edhe 'ndër shqiptarë' si e paikshme në sjelljen e njeriut. Si faj i cili rri tutje prej çdo gjëje, prej çdo ndërveprimi dhe çdo ideologjie, në të cilën duhet të varet apo vritet secili që është jashtë ideologjisë.

Në tërë narrativin krijohen qarqe të tij, të cilat kthehen dhe ri-marrin, ri- dhunojnë, ri-kontrollojnë individin i cili e ka shkelur pragun e ideologjisë së ekstremit/primitives ku çdo gjë në tërë botën duhet të jetë si ti. Këto qarqe janë një dhe kanë një të vetmen zanafillë: Fajin. Nuk munden pa atë dhe kur e mbajnë i përkulen dhe qarkohen nën qarkun vicioz të dhunës.

Në novelën "*Shënimet e krimbit Smolinski*" krimbi është brenda lirisë, dhe me këtë ai sikur edhe sjellë, apo kudo që është sillet dhe vdekja rreth tij, në të vërtetë ai konstaton në fund se ndoshta edhe dheu hyn përmes tij, në vdekjen e paevitueshme kudo që shkon.

Përfundim

Vdekja dhe Faji, ekzistenciale, si të dhëna të paikshme dhe të para-lindjes së Publikes apo ideologjisë së njerëzimit në novelat e Azem Deliut janë edhe në realen e njeriut por edhe shpërfaqen si "krimb" prej brenda po kësaj ideologjie, si në ekstremizëm të post-komunizmit dhe po ashtu në tirani të diktaturës.

Në ndërthurjen e të ligës, të "ndytës", të keqes së njeriut përbrenda tij dhe në rajonin e asaj që ai e ka bërë të Pa – vërejtshme, të ankthit të përkohshmërisë së njeriut, secili është në vrap për të krijuar dhe për të skalitur heroizmin dhe pavdekshmërinë e tij. Secili është në akth për të qenë mbi, mbi njerëzoren e papërkryer, mbi njerëzoren e brishtë, mbi njerëzoren e papremtim, mbi njerëzoren e pathemel.

Si në "*Puthësi i paligjshëm*" ku themeli i njerëzimit është i – marueshëm – (identike sipas koncepteve të Publikes në ekzistencializëm), duke e ndaluar 'dashurinë; dhe aq më shumë në "S*hënimet e krimbit Smolinski*" ku themeli i njerëzimit është një qark i cili e dhunon dhe e dënon veten në mungesë të Gjykatësit – Zotit të të gjitha gjykimeve, qeniesimi përmban krimbin brenda vetes. Në anën negative të tij krimbin e dashurisë, dhe në anën pozitive të qeniesimit, krimbin e "subterrenit".

Themeli i njerëzimit është i pazëtorueshëm, është i papronësueshëm, është i paparashikueshëm dhe me këtë përkujtues i nevojës për "Qëndrueshmërinë" e njeriut që ndien dashurinë, i nevojës për përballje/hapje ndaj po kësaj mungese themeli në afërsinë e vdekjes të pakontrollueshme në lirinë e njeriut.

LOJA E VDEKJES DHE PËRJETËSISË NË LIRIKËN DASHURORE TË FATOS ARAPIT

nga Alisa Velaj

Në teoritë dhe diskutimet e pafundme mbi natyrën e artit të fjalës, **ne i trajtojmë poezitë sikur ato na vijnë me padurim, ndërsa në të vërtetë shumë nga poezitë më të mëdha duken si të jenë shkruar me gjak. Ato vijnë nga burimet më të thella të qenies.** (Hirsch, Edward. *How to read a poem*). Në këtë kontekst, poezia është e vërteta më e thellë e shpirtit të poetit. Një e vërtetë e shkruar me gjakun e qenies. Gjak ku gjakon jeta e vargjeve, pa kurrfarë mëdyshje apo kompromisi. Poetët e vërtetë nuk rendin kurrë pas vet'harrimeve, por në heshtjet e tyre më të humnershme, tek dëgjojnë gjakun si u buçet nëpër kapilarë, në atë grimëkohën sa një e rrahur zemre që i paraprin zbrazjes së këngës së tyre në letër, ata vetëm sa na dëshmojnë apoteozën më të kulluar të dritës së unit lirik. Këtë proces aq kthjelltësisht të ndërlikuar poeti Fatos Arapi do ta përshkruante me fjalët: "*(...)* **një poezi e botuar je ti, është shpirti tënd. Jo ai që ti mendon për veten, por ai që ti je në të vërtetë**. (Arapi, Fatos. *Dy fjalë*, Parathënie në *Më jepni një emër,* 2005). Qenia e vërtetë poetike, ajo e vluara dhe e përndritura në zjarrin e dashurisë, është pa dyshim nga qeniet më të bukura të poetikës së Arapit dhe krejt opusit më përfaqësues të poezisë shqipe. Arapi shkroi për dashurinë që në agimet e krijimtarisë në vitet '60 dhe deri në fundin e udhëtimit të tij tokësor. Kredoja e tij poetike për lirikën e dashurisë vjen bukur mirë në poezinë minimaliste *Në supin e kohës sime (vëllimi Poema dhe vjersha, 1966)* me vargjet: *Mbi supin e kohës sime,/ si mbi supin e Asaj,-/ rashë në mendime.*

Dashuria është vetë koha dhe koha merr trajtë vetëm e vetëm falë dashurisë. Poeti është gati ta ndalë kohën për të shpejtuar ardhjen e asaj *(rreth vetvetes rruzullin do vërtitnja,/...të rrjedhë koha shpejt/ e ti të vish...). Koha përshpejtohet vetiu, ose merr tjetër rrjedhë kur qenia është e dashuruar* (*Brenda hijes së qerpikëve të tu/ Rruzulli mund të fluturojë më lehtë). Për shkak të dashurisë, uni lirik bëhet kambanë që kumbon vetiu në hapësirën mes tokës e qiellit (Unë isha kambana që diku në muzgje/ kumbonte në qiell vetiu prej ere) dhe beson në kohën e ardhjes e pranverës vetëm kur e ndien stinën në shtatin e së dashurës (Të shkopsita bluzën: duart e mia u ngjyen/ me diellin e zemrave të luleve të limonit.../ E besova: kishte ardhur pranvera). Qenia nën qiejt e dashurisë e mat kohën e vet në mënyrë të tjetërllojtë nga vdekatarët e tjerë (Jam burri që mati kohën e vet,/ jo me tiktakun e kësaj ore mesnate,/ po me hapin e lehtë të këmbëve të tua). Mrekullia e pushtimit nga dashuria e bën kohën universale, duke e kthyer përkohshmërinë në pavdekësi apo liri absolute (Në çastin kur ti erdhe tek unë,/...diçka universale/ duhet të ketë ndodhur diku), ndërsa vjeshta-grua e gruaja-vjeshtë shkrihen në një, falë kohës së përbashkët kur piqen trishtimet (Sillte me vete vjeshtën, gruan/ me trishtimet e pjekura).*

Dashuria si koha e qenies plazmohet herë në vargje të caktuara brenda poezive dhe herë në krejt ashtin e poezisë. Janë lirika ku Arapi mediton thellë mbi kuptimin e dashurisë, larg trishtimit apo dhimbjeve që shkakton dashuria në pjesën tjetër të krijimtarisë së tij. Lirika më antologjike në këtë kontekst Është një lojë vjen e botuar në vitin 1972 në vëllimin Më jepni një emër. Vargjet e cituara përmbajnë jo vetëm ndërthurjen e qenies me kohën e dashurisë dhe e anasjella, por edhe pjesën dërrmuese të atyre koncepteve bazë të lirikës së dashurisë të poetit.

Është një lojë e madhe e dashur
.....
lojë e mallit, e dhimbjes së bukurisë,
loja jote dhe imja:
lojë e vdekjes dhe e përjetësisë,
.....
Është një lojë e gjithanshme, e mira ime,
që quhet: Dashuri...

Malli, dhimbja e bukurisë së dashurisë dhe loja e vdekjes e përjetësisë janë tri dimensionet që ngjizin frymëmarrjen e gjerë e të thellë të lirikës dashurore të Arapit. Në lirikat ku poeti këndon për *vajzën prej shirash e zërash vjeshte*, të largëtën e një kohe të pakohë, malli vjen i përzier me aq dhimbje sa mund të përmbajë çdolloj nostalgjie njerëzore për dikë që e ka dashur dikur diku. Në kësi lloj përjetimesh jo shumë të shpeshta dashuria është drita prijatare në terrin e jetës, kuptimi i thelbësor i ekzistencës në një çast të dhënë, por jo një robëri kujtimi që ia mpak hapësirat e shpirtit në të tashmen hipotetike.

Lirika arapiane vjen përgjithësisht si *mall i brishtë e dhimbje universale.* Sipas poetit Sadik Bejko, Arapi është **poet i dashurisë që nuk është erotike, por dramatike dhe përsiatëse**. Ky përcaktim merr vlerë për pjesën dërrmuese të lirikave antologjike të poetit, por ka raste përjashtimore, kur kjo lirikë vjen si një krijesë thellësisht erotike. Mund të përmendim poezinë *Te gryka e pusit të fshatit*, ku shpirti i dashurisë bëhet një me dëfrimin e shpirtit të dheut e





të ujit. Poezia ku erosi shpërfaqet vetëm si eros, larg çdo natyre përsiatëse apo dramatike. Madje, po të analizojmë gjithë shënjuesit tekstualë të poezisë prej titullit e deri në vargun e parafundit, kemi të bëjmë me një risjellje nga më të bukurat në poezinë shqipe të aktit më intim dashuror. Sintagma të tilla, si: *gryka e pusit, heqje të shpirtit të mbrëmjes së gushtit, prafullimë zërash, stërkalash, përndizen pulpave, pulpave të ujtë të vajzave, një britmë hënore këlthet* dhe *dëfren shpirti i errët i dheut dhe i ujit,* e bëjnë të padukshëm kufirin mes erotikes dhe seksuales. Një eros ëmbëlak që shumëfishon imazhe trupash të lakuriqtë vajzash, nën syrin e një mashkulli që i dëshiron etshëm format e tyre fizike. Ndërsa vargu i fundit *Ullinjtë solemnë si ndër funerale* risjell në vetëdijen e lexuesit atë lojë të vdekjes dhe përjetësisë aq shpesh të ndërthurur me ndjenjën e dashurisë te ky poet. Në poezinë tjetër *Ndarja* kjo lojë dramatike shprehet kështu:

Tek unë zgalemi i plagosur rrokullisej furtunës.
Dhe jeta e vdekja klithnin një klithmë të bardhë, -
atje ku ndarja ka fundin
dhe nis prap' fillimin e saj.

Bëhet fjalë për një lloj dhimbjeje të padurueshme, për një dashuri në një kohë të shkuar, por që poetit ia mpak përherë qiejt e së tashmes. Një dhimbje që ai kërkon ta ketë përherë të re *(Si ta bëj dhimbjen time të re?) dhe ka ngjizur lirika me një ndjeshmëri të rrallë, ku dashuria si premtim shtrihet deri në kufijtë e përtejvdekjes. Kjo e fundit duhet thënë se perceptohet përherë si një vazhdë e tokësores dhe jo si fundi i saj. Në këtë kontekst atmosfera e vdekjes në këto poezi shpreh sa frikën e humbjes së pareshtur përmes ndarjes në jetën tokësore, sa dashurinë që do të vazhdojë ta mbartë edhe në botën tjetër. Thënë ndryshe, përjetësinë e dashurisë.* **Kurdoherë që një poezi miraton atë për të cilën bëhet fjalë, ajo krijon një mënyrë për të jetuar në mënyrë dramatike brenda lexuesit. Bëhet një përvojë më vete.** (Hirsch, Edward, po aty). Në këtë dhimbje që e bën përherë të re, ajo, e dashura, është *dhe lindje eterne dhe vdekje eterne e dashurisë.* Disa nga lirikat më përfaqësuese në këtë frymë *(*krahas shumë të tjerave*),* janë *Ç'dhembje qenka të dashurosh ty*, *Ti do të më dashurosh patjetër* dhe *Si s'të desha pak më shumë*.

Në lirikën *Si s'të desha pak më shumë* uni lirik "rrëfen" prej fillimit se kufijtë e të dashuruarit paskan qenë të pakufij. Poeti ose shpirti dashuronjës e pozicionon veten larg së dashurës. Ai është në një areal të papërcaktuar, ndërsa ajo "rri mes zotave". Njëkohshëm, para kësaj flet për një ndarje në një kohë të pakohë. Fjala e Arapit mbetet ambingue si në tërë opusin e vet, edhe në lirikën erotike. Mund të mendojmë se kjo lirikë i është kushtuar një të dashure me të cilën e ka ndarë vdekja (*unë e desha përtej vdekjes*), një të dashure me të cilën është ndarë dhe ajo pastaj ka vdekur (*t'i them ndarjes: – Prit, ca pak...*), dikujt që është larguar papritmas nga jeta, duke i lënë njëherazi pengun e largimit, ndarjes, mallit dhe moskthimit më kurrë, apo dikujt që vërtet është ndarë, por tani që ajo ndodhet larg në mënyrë të pakthyeshme (ku midis Zotave mund të deshifrohet si një hapësirë e pambërrijtshme), atij (unit lirik) nuk i mbetet tjetër veçse t'i betohet se do ta dojë edhe pas vdekjes së tij. Do ta dojë me një lloj dashurie hyjnore, të përjetshme, shumë larg vdekatares, në atë hapësirën "përtej botës", "përtej jetës"! Lirika brenda pengut të pafalshëm që qenia ka ndaj vetes dhe një ndjenje faji e thyen shpirtin e tij në copëra dhimbjeje, mbart gjithashtu edhe nuanca të elegjisë. Një dhimbje apokaliptike që shtrihet mes poleve "pak më shumë" dhe "pak më tepër". "Pak më shumë" është njerëzore, "pak më tepër" apo tepria është përmasë që kërkohet me ngulm, e mbartshme veç prej poetëve, që kërkojnë përherë dimensionin e panjohur në atë "ca pak tjetër"!

Poezia asnjëherë nuk e humb kuptimin e misterit të shenjtë. (Hirsch, Edward, po aty.) Shkrirja e kufijve mes ëndrrës e reales (*Si ta duroj ditën/ që më sheh me sy ëndrre*) plazmohet në lirika, si *Mos eja në ëndërr*, *E paëndërrta ime*, *Jemi takuar e ndarë në një*

ëndërr, *Gjysmë ëndrre në sy* etj. Uni lirik në përhumbje pafundësish dhe dhimbja e bukurisë së dashurisë janë dy boshtet kryesore që ngjizin misterin e shenjtë dhe paralelisht e shenjtërojnë këtë mister. Qenia e mbarsur me atë lloj dashurie që hutohet nga kumbimi i vetvetes, ashtu e lëmekur mes detit e qiellit, mvishet me frymëmarrjen e një lirie të pafund dhe të paanë (tipare qenësore të dashurisë gjithashtu). Ndërkohë dhimbja e një bukurie në kufirin mes jetës e vdekjes, ku e dashura është shndërruar në ikonë, e perception dashurinë si dritën që josh e përmbush në tokë dhe në qiej. Dashuria si diell shpirti dhe mision i përtëritjes së shpirtit.

-Uh, murga! Gjallë bukuria e vdekjes...
Dalë prej ikone...

"Për të lexuar ndjenjat në gjuhën njerëzore duhet të jeni në gjendje të lexoni njerëzisht, me tërë veten tuaj", - shkruan Harold Bloom. (Bloom, *How to read and why*). Mirëpo, përpara se të ndodhë ky proces, vetë poezia duhet të mbërrijë te lexuesit me shqisa ndijimi e perceptimi krejt të zbuluara. Lexuesi duhet t'i pushtojë këto të fundit si pushtohet një tokë krejt e panjohur. Subjekti lirik në poezinë e Arapit e derdh veten para lexuesit me dhimbje që mund të preken gati-gati me dorë dhe ethe ndjesish që tjetri (në rolin e lexuesit) e përjeton pikëllimën shpirtërore si ta këtë të tijën me të vërtetë dhe jo përmes imagjinatës. Gjendje të tilla plot ankth ekzistencial të parrokshëm, si *shih duart e mia/ qenkan ato fole klithme pulëbardhash*, apo dhimbjesh të drejtpërdrejta fizike të tipit, *E unë kam dhimbje koke dhe në ëndërr, e dashura ime*, e bëjnë qenien lexues të shkrihet në një me qenien poet, në mënyrë aq të natyrshme, sa qenies lexues i duket se tjetri (në rolin e rrëfyesit të shpirtit) është duke kënduar këngët e tij si t'i ketë të vetat. Ky është ai lexuesi i thellë i skutave më të padukshme të pavetëdijes së autorit, i cili pyet habitur se kush e ka shkruar këngën e tij. Lexuesi i lirikës dashurore të Arapit mund ta bëjë natyrshëm dhe jo rrallë këtë pyetje.

Lirika e dashurisë së Arapit na përshkruan tri lloje lirish. Së pari, lirinë e papritur. Ajo liria e lirë dhe e pandalshmja në vallëzimin e saj si koha, që na e mbjell dashurinë si dritë dhe rreng. Si një ndodhi të pashpjegueshme në fatin tonë tragjik prej njeriu. Pa qenë kurrë të zotët ta parashikojmë nëse ky fat tragjik do të na bëhet më i përzishëm apo më i përndritur prej dritës vetë. Drita si gëzim dhe pikëllim, me arsyet dhe mosarsyet që varen sa prej saj, sa prej çasteve në të cilat ajo do të frymojë.

D.
Dhe ajo erdhi
Ishte e gëzuar,
vallëzonte, -
dhe e lumtur si një dritëz që ecën në errësirë,
hyri në fatin tim tragjik
prej njeriu.

Dy liritë e tjera janë: liria e pavetëdijes prej së cilës uni lirik nuk shpëton dot dhe liria e vetëdijes që i duhet qenies si oazë për t'u arratisur nga gjendjet e pashpresa që i sjell malli i një dashurie askurrë të mpakur. (*Harrimi i pushtetshëm kujtesën e mpak,/ po kurrë mallin për të*). Ajo dhimbja që poeti duket se e bën përherë të re është në të vërtetë ajo liria e pavetëdijes që përtërin vetveten, pa i marrë leje poetit. Ndaj qenia thërret lirinë e vetëdijes për t'u qëndruar sa më larg rihumbjeve ciklike. Harrimi i pushtetshëm si oazë lirie jepet më bukur se kudo në poezinë *E fundit dashuri*, ku poeti është shndërruar në predikues dhe dishepull të tempullit të dashurisë, duke na shpallur ungjillin e tij me tri pyetje të njëpasnjëshme retorike: *Ku varrosen erërat, veçse në gjirin e erërave? Cili altar është më i denjë për këngët e vdekura,/ pos këngëve vetë? Dhe ne ku mund ta vendosim dashurinë tonë,/ Veçse në një tjetër dashuri?*

Në fund të fundit, një udhë triumfi do të gjendet përherë për rihumbjet ciklike. Mision që mund ta kryejë mrekullisht bukur vetëm dhe vetëm poezia e vërtetë.

Vlorë, janar 2021

Shënim
Të gjitha citimet e poezive të Arapit janë marrë prej veprës poetike të botuar nga shtëpia botuese "Neraida" në vitin 2005. Ndërkohë sintagmat apo fjalitë e plota me kursive janë vargje të poetit të ndërkalluara në artikull prej poezive *Ti do vish*, *Natashës*, *Kur vija tek ti*, *Kur vinte pranvera*, *E njoh ecjen tënde*, *Patjetër*, *Shiu i parë*, *Vjeshtë*, *Është ajo dashuria*, *Si ta bëj dhimbjen time të re?*, *Ç'dhembje qenka të dashurosh ty*, *Mos eja në ëndërr*, *Oh, si qenkan zemrat!*, *Tana* dhe *Dhe nata u zgjua*.

NJË VËSHTRIM PAS: ÇFARË QE E RËNDËSISHME NË JETËN TIME AKADEMIKE?

nga Jan Blommaert

Përktheu: Dr. Elsa Skënderi Rakipllari

Dy prej maîtres à penser-ëve të mi vdiqën në moshë relativisht të re. Mishel Faucault-ja ishte 57 vjeç, ndërsa Erving Goffman-i ishte 60 vjeç. Ka shumë gjasa që edhe unë të vdes relativisht i ri. Tani jam 58 vjeç dhe jam diagnostikuar me kancer të fazës së katërt në mesin e marsit të vitit 2020. Përderisa më mbetet shumë pak e ardhme për t'u planifikuar, për të spekuluar apo ëndërruar, njeriu priret që t'i përdorë këto çaste shënjuese si nxitje për të reflektuar për të shkuarën. Pyetja udhërrëfyese në këtë rast është tepër e qartë: Ç'qe e rëndësishme?

Do t'i kufizoj reflektimet e mia vetëm për pjesët profesionale të jetës sime. Ky është, pa dyshim, një segmentim artificial dhe lexuesit duhet të kenë parasysh se pjesa profesionale e jetës sime ka qenë gjithnjë e ndërthurur me pjesët joprofesionale, shpesh në mënyra të jo thjeshta ose të keqbalancuara. Ndoshta ajo histori duhet rrëfyer tjetërkund. Tani për tani, do të përqendrohem te ajo pjesë e imja që quhej "akademike".

*****

Lermëni të parashtroj shkurt çfarë vijon duke përmbledhur çfarë nuk ishte e rëndësishme.

Çfarë nuk ishte i rëndësishëm ishte konkurrimi dhe vetitë e tij te sjellja dhe marrëdhëniet e konkurrencës, dëshira ose nxitja për të bërë më të mirën, për të fituar konkurse, për t'u parë si kampion, për të lëvizur në mënyrë taktike, për të farkëtuar aleanca strategjike e çmos tjetër. Nuk e kam pasur ndjesinë se doja të isha pjesë e një klike ose e një rrjeti të caktuar dhe nuk mendoj se kam bërë ndonjëherë përpjekje të mëdha për t'u afruar me njerëz, që konsideroheshin të rëndësishëm. Nëse kam qenë pjesëtar i rrjeteve të këtilla, ka ndodhur më tepër në mënyrë të rastësishme sesa në mënyrë të qëllimtë.

Nuk e kam menduar kurrë veten si gjeni, i krahasueshëm individualisht me të tjerët dhe individualisht përgjegjës për prodhimin e gjërave fantastike, që të gjithë duhej t'i lexonin, t'i dinin, t'i citonin dhe t'ua caktonin studentëve si detyra. Krejt e kundërta: E kam parë veten si jopërjashtimor dhe si një njeri, të cilit gjithnjë do t'i duhej një ekip i mirë përqark, për të arritur diçka. Nisur nga fakti që jeta ime akademike, në rastin tim, nuk ishte diçka që e kisha dëshiruar e kërkuar pa ndalur, por një dhuratë që mora nga të tjerët, kam ndjerë detyrimin për të qenë i mirë, aq i mirë sa të mundesha dhe më i mirë nesër se sot. Kështu që kam punuar fort, veçanërisht duke i marrë të dhënat nga të tjerët – nga literatura sigurisht (një komunitet i të tjerëve shpesh i lënë në hije, kur flitet për arritje akademike), por gjithashtu nga kontaktet me miq, me të cilët mund të krijoheshin grupe pune. Diskutimi dhe stuhia e mendimeve ishin aktivitetet e mia të parapëlqyera; ishin, në kuptimin e vërtetë të fjalës, përmasat lojcake, zbavitëse dhe të kënaqësisë së jetës akademike. Gjëja kam bërë vetëm, zakonisht, ka qenë analiza e ngadaltë dhe e kujdesshme e të dhënave. Por ajo është e vetmja gjë, që ka qenë realisht individuale në mesin e një sërë aktiviteteve kolektive dhe përfshinin bashkëndarje, shkëmbim dhe bujari. E madje edhe analiza e të dhënave zakonisht i lihej gjykimit të të tjerëve përpara se të prezantohej publikisht. Ishin vërtetë shumë gjëra që bëja me të tjerët, për t'u konsideruar kërkuesi shkencor vetmitar, unik dhe i pavarur.

Në kontekste të tilla të shkëmbimit kolektiv, të kushtëzuar nga bujaria në maksimum, të ndryshuarit e mendjes është i vetëkuptueshëm. Qëllimi i diskutimeve dhe i stuhive të mendimit, si "një shkëmbim idesh", është që idetë të mund të shkëmbehen dhe ndryshohen dhe kjo është diçka që e bën personin të dalë nga një sesion i tillë, me gjëra më të mira në kokë se ç'pati pasur para sesionit. Të nxënit këtu është çelësi dhe nëse do të isha i gatshëm për t'i vënë një etiketë vetes, është etiketa e nxënësit të përjetshëm, të pangopur.

Kjo është edhe arsyeja pse kam lexuar me shumicë gjatë gjithë jetës. E teksa një pjesë e atij leximi ishte "thjesht" lexim, një pjesë tjetër ishte studim. Pjesën më të madhe të karrierës sime, kam qenë i përfshirë në ndonjë formë studimi, mbledhjeje dhe përzgjedhjeje shkrimesh, prej të cilave doja të mblidhja qëmtime të thelluara, të vlefshme për projektet kërkimore, ku isha i angazhuar. Kam studiuar, për shembull (dhe lista nuk është shteruese), strukturalizmin, ekzistencializmin, fenomenologjinë, gjërat e mistershme si veprat e Rudy Botha-s për Chomsky-n dhe përpjekjet e Gramatikës Funksionale të Simon Dik-ut, Talmy Givon-it dhe M.AK. Halliday-it; por gjithashtu veprën e plotë (ose të paktën pjesën më të madhe nga ç'kam mundur të siguroj) të autorëve: Michel Foucault, Carlo Ginzburg, Bakhtin, Freud, Durkheim, Simmel, Parsons, Eric Hobsbawm, E.P. Thompson, Pierre Bourdieu, Charles Goodwin, Dell Hymes, Michael Silverstein, Erving Goffman, Aaron Cicourel, Harold Garfinkel, Anne Rawls, Fernand Braudel, J.K. Galbraith, Immanuel Wallerstein, Arjun Appadurai dhe disa të tjerëve. Kam studiuar Marksin dhe marksizmin në versionet e veta të larmishme, Zgjedhjen Racionale, Makiavelin, Darvinin veprën dhe ndikimin e G.H. Mead-it, Dewey-n, Paolo Freire, Ngugi wa Thiong'o, Okot p'Bitek, Walter Rodney, Issa Shivji dhe pak nga teoria politike afrikane e viteve '50, '60 dhe '70. Për të kuptuar shumë prej saj, më është dashur të studioj veprat e Mao Ce Dunit dhe historinë e Revolucionit Kulturor në Kinë. E kështu, e kështu me radhë.

Nëse kam pendesa tani, është për faktin se disa prej këtyre studimeve do të mbeten të pambaruara. Kam marrë shumë kënaqësi prej tyre.

Kam pasur mospëlqim dhe mospëlqim të thekshëm për zhvillimin e kulturës industriale akademike, dëshmitar i së cilës jam bërë përgjatë karrierës sime, me matje thuajse totalitare të punës akademike individuale dhe të performancës, me konkurrencë konstante ndërindividuale, që i shpinte kolegët e rinj e të brishtë drejt niveleve ekstreme dhe të rrezikshme të stresit dhe të investimit në punë e jo në jetë dhe me menaxherë që theksonin, pa ndonjë barrë prove, se "artikulli me një autor të vetëm në revistë shkencore" (botuar, dukshëm, pas një tarife të lartë) është pika kulmore e performancës akademike dhe standardi i artë për të matur "cilësinë" e një kërkuesi shkencor. Shtuar kësaj, gjë për të cilën kam qenë gjithashtu dëshmitar, edhe zhvillimin e një kulture të mirëfilltë të famshmish në botën akademike, ku megakonferencat marrin formën e festivaleve të popit me titullarët rockstar-ë, të cilët sjellin hitet e tyre më të mëdha përpara një audience akademikësh të keqpaguar, që e harxhojnë buxhetin e tyre të pushimeve për të blerë një biletë në evente të këtilla. Punë e mirëfilltë intelektuale aty bëhet pak. Dhe kryekëput si në festivalet e popit, gjurma e karbonit në koncerte të tilla akademike rroku është skandaloze.

Sinqerisht, e gjitha kjo është në formën më të thjeshtë dhe elementare antiakademike dhe antiintelektuale. Është receta për shkencë të keqe, jo për risi dhe përmirësim. Kam marrë pjesë në të gjitha, sepse e gjitha u bë "moda e re", teksa unë isha aktiv dhe qe kultura që përcaktoi karrierën time. Ajo kulturë që më përcaktoi mua si një prej këtyre rokstarëve për ca kohë e kësisoj më vuri në mënyrë të vazhdueshme në shoqërinë e një tarafi të vogël rokstarësh të ngjashëm. Kjo nuk është diçka që do të më mungojë, pasi ishte pandryshueshmërisht e çuditshme dhe tehuajsuese e shpesh tmerrësisht e mërzitshme. Dhe kjo kulturë e re largoi dhe delegjitimoi një kulturë pararendëse, atë të dialogut kolegjial, të bashkëpunimit, ngadalësisë, kohës për të menduar, reflektuar dhe dyshuar, të periudhave të padukshmërisë dhe të mungesës në skenat publike, ngase mund të ishe duke bërë një pjesë serioze kërkimi, për shembull. Dhe një kulturë ku dikush do të shkruante kurdo, ngaqë diçka e re duhej raportuar, jo ngaqë duhej të arrinte kuotën e produktit vjetor ose një tjetër artikull "super", për të qenë i pranueshëm për promovim, mandat ose emërim.

Një fusnotë: një tjetër pjesë e asaj kulture përcaktuese ishin riorganizimet e universitetit, menaxhimi dhe shkurtimet e buxhetit, me një rritje të garës për vende pune (për të cilat bota intelektuale paguan një çmim të tmerrshëm), programe akademike "me orientim nga klienti", që duhej të kontrolloheshin nga ata tipat e marketingut, për meritat që kanë në një treg produktesh akademike, bjerrja e "stafit mbështetës", që është jetik dhe shndërrimi thuajse tërësisht i produktit akademik në mall, shih argumentin për artikujt e revistave shkencore "me vetëm një autor" dhe shto këtu edhe maninë e metrikës dhe impaktit. Botimi akademik, si një industri, është bërë faqja e zezë dhe pengesë për shkencën e jo një lehtësues (le më aktor i domosdoshëm). Botimi është shndërruar në një formë terrori për kërkuesit e rinj, ndërsa në fakt duhet të jetë një instrument për liri, për të gjetur zërin dhe vendin e tyre në këtë fushë. Ezaurimi (burnout-i) është bërë tanimë një rrezik profesional endemik në akademi, ngjashëm

me depresionin, marrëdhëniet e pamira njerëzore dhe stilin e pashëndetshëm të jetesës. Kështu, ky mjedis është tepër jotërheqës për krijimtarinë njerëzore, teksa në fakt duhet të jetë një mjedis i specializuar, i përshtatur pikërisht për ta nxitur krijimtarinë.

Kështu që sa më lart ishin të parëndësishme. Gjërat e rëndësishme mund të përmblidhen me pak fjalë kyçe: të japësh, të edukosh, të frymëzosh. Një fjalë kyçe të katërt do ta shtoj më vonë.

Siç e përmenda më herët, jeta ime akademike ishte një dhuratë që e mora prej të tjerëve. Ishte e papritur si dhuratë dhe isha i papërgatitur për të. Kur fillova detyrën e parë akademike në 1988, mora në konsideratë kryesisht njerëzit që i konsideroja shembuj të këqij dhe vendosa të mos i bëja gjërat siç i bënin ata. Në thelb, vendosa të bëhem akademiku, që unë vetë do të doja ta hasja, po të isha student. Nëse më duhej të mësoja, duhej të jepja mësim në ato klasa, që do t'i ndiqja me kënaqësi. E nëse më duhej të shkruaja, duhej të shkruaja tekste të cilat unë vetë do t'i lexoja me qejf. Është një disiplinë e thjeshtë, që e kam ndjekur gjatë karrierës sime: nuk ka të bëjë asnjëherë me mua, ka të bëjë kurdoherë me studentët dhe roli im është t'iu jap atyre mjete dhe burime të vlefshme e të dobishme për ta, jo për mua.

Që herët e kuptova se roli im në jetët e të rinjve, që ishin studentët e mi, ishte roli i një edukatori, jo thjesht i një mësuesi a lektori. E kur e kuptova, e mora shumë seriozisht këtë gjë. Përgatisja me detaje çdo lëndë që jepja (dhe kanë qenë shumë të tilla) dhe gjithnjë bëja prova për çdo leksion. Asnjëherë nuk kam hyrë në një auditor leksioni pa një histori tërësisht të zhvilluar dhe pa skenar në mendjen time për sesi do të shpjegoja. Nëse të duhet të japësh mësim, bëje dhe mos e bëj në mënyrë të pakuptimtë. Bëje çdo minutë në klasë të vlefshme për studentët dhe kujdesu që ata të mësojnë diçka në secilën nga orët e tua. Diçka e tillë duket e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, por nuk është. Në fakt është fort e zorshme.

Nis nga refuzimi për të nënvlerësuar studentët e tu. Shumë nga ish-studentët e mi do ta mbajnë mend se unë zakonisht filloja lëndën duke shpallur që synoja të arrija vetëm 1 inç mbi kokat e tyre, në mënyrë të tillë që ata të zgjateshin pak për ta ndjekur ritmin dhe përmbajtjen e lëndës. Gjithnjë e bëja diçka të tillë: iu jepja studentëve pjesë për të lexuar, përmbajtje dhe detyra që shpesh nga kolegët e mi gjykoheshin se ishin tepër kërkuese ose "mbi nivelin e tyre", për shembull studentëve të vitit të parë iu duhej të lexonin një libër nga Fukoja. Epo, fakt është që ata e lexonin dhe mësonin shumë prej tij. Ndaj se çfarë saktësisht është "niveli i tyre" është e pëlqyeshme të mbetet për t'u parë pas procesit të të mësuarit dhe jo para tij. Para tij, askush nuk është "gati" për llokma të caktuara dijeje; ata bëhen gati përmes punës së të mësuarit. Të mos e kuptosh këtë fakt elementar dhe të pretendosh se studentët "kanë" një nivel të caktuar, me të cilin ne mësimdhënësit duhet të përshtatemi, është gabim dramatik. Në karrierën time kam parë shumë shpesh se si ky gabim shpie te trajtimi si fëmijë i të rinjve jashtëzakonisht të talentuar dhe te arritjet, që në fakt janë vetëm një fraksion i asaj që mund të ishte arritur realisht. Ju lutem, asnjëherë mos i nënvlerësoni studentët tuaj.

Në vend të kësaj, jepuni atyre më të mirën që mundeni. Kjo do të thotë: mos iu jepni studentëve informacion të vjetruar dhe të rëndomtë, por jepuni qëmtimet e mendimet më të reja e më të përparuara. Udhëhiqini ata në botën e kërkimit tuaj aktual, vërini ata përballë me çështjet dhe diskutimet më të përparuara të fushës, tregojuni atyre të dhëna të ndërlikuara dhe sfiduese dhe lejojini ata të hyjnë në kuzhinën tuaj, jo vetëm në shitore. Në pjesën dërrmuese të karrierës sime kam pasur ngarkesë shumë të madhe mësimore. Ia dilja që orët e mësimit të ishin interesante për studentët dhe për mua duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta dhe të menjëhershme mes hulumtimit që po bëja dhe mësimit që jepja. Merrja analiza gjysmë të përfunduara të të dhënave të reja në klasë dhe e mbaroja analizën aty me studentët e mi, duke i lënë që të shihnin si gaboja, si më duhej të kthehesha te fazat paraprake, si i kapërceja disa pika, që ishin veçanërisht të vështira e kështu me radhë. Gjëja e mirë ishte se: orët e shumta mësimore që kisha, nuk ma gllabëronin kohën për hulumtim; ato ishin kohë hulumtimi dhe studentët kishin të bënin me një studiues, që iu fliste për një problem të ri dhe konkret që kërkonte një zgjidhje.

*****

Mendoj se është pikërisht në këtë pikë, që "mësimdhënia" kthehet në "edukim". Si mësimdhënës ne nuk transferojmë dije dhe nuk jemi, kësisoj, një lloj i sofistikuar e i çuditshëm buldozeri apo piruni mallrash me anë të cilit një sasi e caktuar të mirash shpihet nga një vend (mendja jonë) te një tjetër (mendjet e studentëve). Kjo është mënyra se si menaxherializmi akademik bashkëkohor parapëlqen të na shohë. Gjë që e kam refuzuar më lart.

Jo. Na pëlqen ose jo, ne jemi shumë, shumë më tepër se aq për studentët tanë dhe ashtu duhet të jemi. Të gjithë ende i mbajmë mend shumë prej mësuesve tanë, nga kopshti e deri në universitet. Disa nga kujtimet që kemi për ta mund të zbehen gradualisht dhe disa nga mësuesit mund të mbijetojnë vetëm në kujtesën tonë si skica të mjegullta e sipërfaqësore, të lidhura me çaste të caktuara në jetë. Por disa nga këta mësues janë, në fakt, tepër të rëndësishëm në historitë që ndërtojmë me veten; dhe për mësues të tillë shpesh kemi kujtime jashtëzakonisht të pasura dhe të detajuara. Madje, disa nga këta mësues kanë shërbyer (dhe shërbejnë) si modele ose si njerëz, që kanë përcaktuar trajektoret tona dhe identitetin tonë në çaste vendimtare në jetë. E kur njerëzit flasin për të tillë mësues, vëmë re nga sa afër dhe sa në mënyrë kritike e kanë vëzhguar ata edhe aspektin më të vogël të sjelljes së mësuesve të tyre; fjalët e tyre dhe si, kur e pse janë thënë; gjestet e veçanta që bënin ose shprehitë e fytyrës; rrengjet e surprizat, që bënin e kështu me radhë.

Kam qenë shumë i vetëdijshëm për faktin se, si mësues, do të kujtohesha nga studentët e mi. E dija në çdo çast të ndërveprimit me studentët se ky çast do të linte një gjurmë në zhvillimin e tyre dhe se shpesh do të merrte një nivel të caktuar rëndësie, që nuk mund ta kishte kurrë për mua. Në tërësi, kuptova se si mësues çdo çast në të cilin ndërveproja me studentët e mi do të ishte një çast edukimi, formësimi i një njeriu, duke përdorur materialet, që do t'iu ofroja gjatë atij çasti të caktuar ndërveprimi. E gjithë sjellja ime ndaj tyre do të ishte një material edukues potencial, në një kuptim. Dhe gjithë sjellja ime ndaj tyre, për pasojë, duhej organizuar në atë kuptim. Duhet t'i lejoj studentët që të më njohin, së paku, të njohin një version të vetes sime, që të mund të mbahet mend si dikush që ka kontribuar për mirë në zhvillimin e tyre si qenie njerëzore madhore. Respekti, mirësjellja, integriteti, korrektesa profesionale, empatia, mbështetja, besimi, përkushtimi: të gjitha këto fjalë përfaqësojnë formula sjelljeje që kërkojnë zbatim të vazhdueshëm për të qenë të vërteta.

Disa herë në karrierën time, studentët më kanë treguar gjëra që mund të konsideroheshin si "sekrete", për çështje personale delikate, që zakonisht iu thuhen anëtarëve të një rrethi të ngushtë intim. Dy herë, studente të reja më kanë ardhur në zyrë, në gjendje të rënduar psikologjike, duke më rrëfyer se ishin përdhunuar dhe unë isha njeriu i parë, të cilit po i kërkonin ndihmë. Teksa çaste të tilla qenë sigurisht çorientuese dhe më zunë papandehur, më mësuan se si mësues isha vërtet pjesë e jetës së studentëve në mënyra dhe shkallë, që as që i kisha kuptuar tërësisht. Dhe më mësuan përgjegjësinë e madhe, që vinte bashkë me një fakt të tillë: jemi shumë më tepër se "akademikë" për këta të rinj. Ne jemi qenie njerëzore plotësisht të formuara, sjellja e të cilëve mund të jetë e dobishme, e rëndësishme, madje vendimtare për të rinjtë. Duhet të sillemi pa e harruar diçka të tillë dhe të mos i ikim këtij roli të gjerë edukues që kemi.

*****

Fjala e tretë kyçe është 'të frymëzosh' dhe tani duhet ta bëj një hap pas. E përmenda më lart ngazëllimin që kam marrë gjithnjë nga studimi. Kënaqësia e vërtetë që mora prej tij ishte frymëzimi – studiuesit e tjerë dhe puna e tyre më frymëzoi për të menduar në kahe të veçanta, për të menduar gjëra që nuk i kisha menduar dot më parë, për të bërë gjëra në mënyra të caktuara, për të eksploruar teknika, metoda, linja dhe argumente e kështu me radhë. Lërmëni ta theksoj shumë këtë pjesë. Nuk mbaj mend t'i kem studiuar ndonjëherë gjërat për t'i ndjekur, në mënyrën se si një disiplinë ndjek diktatet e një mjeshtri ose sesi çiraku ndjek rregullat e tregtarit, ose të paktën mbaj mend se çdo përpjekje në atë drejtim ishte dështim dëshpërues. Asnjëherë nuk kam qenë në gjendje të përthith një ortodoksi dhe të jem, për shembull, i lumtur që të mbaj etiketën e, le të themi, analistit kritik të diskursit apo të analistit të bisedës.

Kurdo që studioja, doja të frymëzohesha nga ç'po studioja dhe e kam përshkruar frymëzimin më lart: është forca që papritur hap fusha dhe drejtime mendimi, tregon embrionin e një ideje, ofron një formulim të caktuar të aftë për të zëvendësuar shumicën e formulimeve të tjera e kështu me radhë. Frymëzimi ka të bëjë me të menduarin, është forca që nxit të menduarin dhe që na çon drejt elementeve kyçe të jetës intelektuale: ideve. Dhe shkenca pa ide nuk është shkencë, por një lojë e drejtuar nga rregulla ku suksesi përkufizohet nga shkalla e pakrijueshmërisë që dikush shfaq në punën e tij. Kryekëput e kundërta, me fjalë të tjera, është çka shkenca duhet të jetë. Shkenca nuk mund të jetë asnjëherë e nënshtruar, as çështje e "të ndjekurit të një procedure" apo e një "kornize". Ajo ka të bëjë me të ndërtuarin e procedurave dhe kornizave.

Ka pasur shumë çaste në karrierën time kur studentët e masterit më prezantonin punën e tyre dhe e parashtronin duke thënë gjëra si: "kam përdorur Halliday-in si metodë". Zakonisht përgjigjja ime ishte një pyetje: "si u bë Hallday-i metodë?". Përgjigjja është, sigurisht, përmes të ndërtuarit të metodës së vet dhe përmes refuzimit për të ndjekur metodat e hartuara nga të tjerët. Njerëzit që "bëhen metodë", thënë kështu, kanë shfrytëzuar lirinë themelore që duhet të përfshijë kërkimi shkencor dhe kanë refuzuar kufizimet, që shpesh ngatërrohen me "praktikën shkencore". Liria themelore e kërkimit është liria për çmenduar atë që konsiderohet si e vërtetë, si e vetëdukshme ose e mirënjohur, dhe për ta ri-kërkuar, literalisht siç është fjala re-search "kërko përsëri". Është liria e disidencës – diçka që shpesh fshehim, në diskurset tona të institucionalizuara, pas frazës "mendim kritik". Për mua disidenca është detyrë në kërkim dhe një prej aspekteve më tërheqëse të tij. Besoj se është pikërisht ky aspekt, që ende i bind njerëzit të zgjedhin një karrierë në kërkim shkencor.

Frymëzimi e merr rëndësinë e vet nga detyra për të çmenduar, (ri)kërkuar dhe vënë në pyetje, çka e shoh si themelin e kërkimit shkencor. Mund ta bëjmë më të lehtë (jam i bindur edhe më produktive) punën e të çmenduarit dhe të (ri)kërkimit, kur i lejojmë vetes të frymëzohemi nga tërësia e stërmadhe e veprave ekzistuese dhe pafundësia e ideve të dobishme, që ato përmbajnë, si dhe nga ndërveprimet me miq, kolegë, studentë, bashkëmoshatarë, të cilët duhen lejuar të na ndikojnë pikëpamjet, të na formësojnë pikëpamje të reja dhe të na ndihmojnë të ndryshojmë mendje për gjërat. Gjithashtu, në praktikat tona duhet mbase gjithashtu të përpiqemi, vetëdijshëm dhe qëllimshëm, që të frymëzojmë të tjerët. Me këtë dua të them se: nuk duhet t'iu japim të tjerëve doktrinat dhe ortodoksitë tona vetjake. Duhet t'iu japim idetë tona edhe nëse janë të patheparuara, të papërfunduara apo gjysmë të vërtetuara dhe të shpjegojmë se si ide të këtilla mund ta pasurojnë, jo ta zëvendësojnë, atë që tanimë ekziston.

Jam rrekur që në mënyrë të vazhdueshme të frymëzoj të tjerët dhe t'iu përcjell atyre rëndësinë që i kam kushtuar frymëzimit, si habitus në punë dhe në jetë. Në shkrimet e mia, shpesh kam kërkuar t'i çoj lexuesit në kufijtë e vetëdijes sime dhe t'iu mundësoj t'i hedhin një sy të asaj që mund të shtrihet më përtej, në fushën e hapur, për të cilën shkrimet e mia nuk ofrojnë hartë, por të cilën shkrimet e mia mund të shërbejnë për ta shquar si të çelur për eksplorim. Kjo i ka bërë disa pjesë të veprës sime "kontroversale" dhe/ose "provokuese", cilësime këto që zakonisht synojnë të jenë negative, por që pashmangshëm gjithashtu artikulojnë sa të përshtatshme janë dhe sugjerojnë një shkallë risie. Përgjithësisht kam qenë i kënaqur, kur kam marrë atribute të tilla, që asnjëherë nuk më kanë irrituar. As nuk jam irrituar, kur dikush me të cilin kam biseduar, nuk më ka njohur mirë, nuk ka lexuar veprën time dhe as nuk është shtirur sikur e ka lexuar. Zakonisht, këto kanë qenë takimet që më kanë gazmuar më tepër.

*****

Këto tri gjëra, ishin pa dyshim pjesët më të rëndësishme të jetës sime profesionale: të krijoja një habitat të të dhënit, të ndaja dhe të isha bujar në marrëdhëniet me të tjerët; duke qenë i vetëdijshëm për detyrën që kisha për të edukuar dhe për përgjegjësitë që vinin për pasojë, si dhe duke e marrë shumë seriozisht atë detyrë; dhe duke e bërë frymëzimin instrumentin qendror dhe qëllimin e praktikës akademike e intelektuale. Mund të them se jam përpjekur t'i ndjek dhe t'i zbatoj këto tri aspekte gjatë gjithë karrierës sime. Nuk mund të pretendoj se e kam bërë diçka të tillë pa të meta dhe në mënyrë të përkryer, nuk ka asnjë dyshim që kam bërë çdo gabim, që njeh njerëzimi dhe këtu nuk po flas si shenjtor. Por, tri elementet që trajtova këtu kanë qenë, them tani që mund të shoh mbrapa më prej së largu, gjithnjë të rëndësishme, gjithnjë parime udhërrëfyese dhe gjithnjë pika referimi për të vlerësuar veprimet dhe sjelljen time.

*****

Tani duhet të shtoj një fjalë kyçe të katërt: të jesh demokratik. I përket një rendi pak më të ndryshëm.

Jam rritur dhe kam studiuar në sistemin e edukimit të shtetit të mirëqenies të Belgjikës dhe nisur nga statusi modest socio-ekonomik i familjes sime, me gjasë nuk do të kisha bërë dot kurrë shkollë të lartë, në sisteme të tjera me tarifë. Jam më së shumti produkt i një përpjekjeje kolektive të madhe dhe të strukturuar, të njerëzve –taksapaguesve- që nuk më njihnin, pavarësisht se kush isha unë. Jam produkt i një shoqërie demokratike.

Kam qenë tepër i vetëdijshëm gjatë jetës sime si i rritur për faktin dhe qëndrimin tim politik si një akademik profesionist, në një vijë me shkencën që prodhoj, jam një burim për shoqërinë, dhe duhet t'i jap mbrapsht shoqërisë atë që shoqëria ka investuar te unë. "Shoqëria" në këtë kuptim, përfshin çdokënd dhe jo thjesht një segment të saj. Është me doemos një koncept

Vijon në faqen 18

NJË VËSHTRIM PAS: ÇFARË QE E RËNDËSISHME NË JETËN TIME AKADEMIKE?

Vijon nga faqja 17

përfshirës. Dhe shkenca në këtë këndvështrim duhet të jetë një burim i përbashkët dhe i vlefshëm, në dispozicion të të gjithëve, një aset për njerëzimin. Zbatimi i këtij parimi sa erdhi e u bë më i vështirë, për arsye të zhvillimeve, që kam përmendur tashmë më sipër: shndërrimi i shpejtë dhe i përhapur i produktit akademik në mall dhe zhvillimi i industrisë akademike gjatë karrierës sime. Institucionet akademike dhe puna akademike janë bërë e po bëhen jashtëzakonisht përjashtuese dhe komoditete elitare, ndaj ajo punë akademike që nuk është në proporcion me vlerën si mall të produktit akademik, në përgjithësi nuk përkrahet dhe zhvlerësohet. Do t'i kthehem kësaj pike në vijim, por duhet të vijoj si fillim me narrativën autohistorike.

Duke qenë se kam punuar shumë në Afrikë dhe me afrikanë gjatë karrierës sime, nuk kam nevojë të ma tregojnë se dija, siguristi në trajtë akademike, nuk ishte në dispozicion të të gjithëve dhe se një pjese të njerëzimit i është dhënë vetëm qasje te dorëshkrimet nga pjesët më të privilegjuara. Kjo mund të ilustrohet edhe konkretisht: shumë nga tekstet shkollore, që përdoreshin në Tanzani në fillim dhe në mes të viteve '80, ishin libra të shkëputur nga silabuset në Mbretërinë e Bashkuar dhe të transportuara me anije si produkte plehrash, në fakt por nën epitetin ledhatues: asistenca për zhvillimin e edukimit për Tanzaninë. Dhe thuajse çdo student apo akademik që kam takuar në Universitetin e Dar es Salaam (që do të bëhej shtëpia ime e dytë, qysh në fazat e hershme të karrierës sime) do t'i përgjigjej "libra dhe revista shkencore", pyetjes "çfarë është gjëja që ju mungon më tepër këtu në universitet"? Raftet e librave në departamente ishin me të vërtetë thuajse boshe (edhe në të ashtuquajturat salla leximi) dhe ato koleksione të vogla librash, që mbaheshin privatisht nga akademikët (zakonisht të mbledhura gjatë punës pasuniversitare jashtë vendit) çmoheshin, mbroheshin dhe rrallë iu viheshin në dispozicion të tjerëve. Në librarinë universitare në kampus, raftet ishin po ashtu bosh, burimet ishin mjerane dhe shumica e vëllimeve që ofroheshin ishin të vjetëruara. (Megjithatë cepi më i braktisur dhe më i pluhurosur u bë për mua një thesar i fshehtë, ku mund të gjeheshin vëllime të lira të veprave të Marksit, Leninit dhe Mao Cedunit, të dhuruara kohë më parë nga qeveritë e BRSS-së, RDGJ-ja dhe Kina). Biblioteka ime personale në shtëpi, bibliotekë pune e një studenti doktorate, ishte shumë herë më e madhe se vëllimet e departamenteve, që kisha parë në Dar es Salaam. Për aq sa "privilegji i të bardhëve" ka ndonjë kuptim, kisha një vetëdije tepër të mprehtë për të, që në fillim të karrierës sime.

Pabarazia u bë tema qendrore në punën time dhe në praktikën akademike, që nga momenti i parë që e nisa. Dhe nuk e braktisa kurrë. Doja të kuptoja pse vetë të kuptuarit është objekt pabarazie. Konkretisht, doja të kuptoja përse historia e një afrikani aplikant për azil ishte sistematikisht e keqkuptuar dhe skualifikohej nga zyrtarët e azilit në Belgjikë dhe tjetërkund; përse historitë e disa dëshmitarëve të caktuar në Të vërtetën e Afrikës së Jugut dhe në Komisionin e Pajtimit shiheshin si "të paharrueshme", ndërsa të tjera ishin harruar ose nuk ishin marrë kurrë seriozisht; përse kaq shumë histori nga periferitë nuk konsiderohen as të denja që të merret mundimi të dëgjohen, le më pastaj të ruhen apo shqyrtohen; përse disa grupe njerëzish nuk pranohen si interlokutorë, si zëra legjitimë, që kërkojnë respekt dhe vëmendje, e kështu me radhë. Ky shqetësim i përgjithshëm më çoi, gjatë gjithë karrierës sime, në margjina të shoqërisë ku banoja e jetoja dhe ma bëri të pashmangshme përballjen me racizmin, seksizmin dhe forma të tjera strukturore të pabarazisë.

Gjithashtu, më shpuri drejt disa vendimeve praktike për se si duhej ta organizoja punën time. Do të nënvizoj tri vendime të tilla.

Një. Përvojat e mia në universitetet afrikane më bëri tepër të vetëdijshëm për ekzistencën e një sërë botëve akademike, dhe jo të vetëm një "komuniteti akademik", të evokuar ndonjëherë si trop. Dhe vendosa t'i kanalizoj përpjekjet e mia në punën dhe në favor të asaj që tani quhet "Global South". Jam krenar për punën zyrtare që kam bërë me Universitetin Western Cape në vitet 2003-2008, ku koordinova një projekt shumë të madh bashkëpunimi akademik në emër të Këshillit Ndëruniversitar Flamand. Universiteti "Western Cape" ka qenë historikisht një universitet jo i bardhë dhe ende mbante vragat e aparteidit në 2003-shin: universiteti ishte krejtësisht pa burime dhe kishte mangësi në infrastrukturë si edhe përvojë në krijimin e një kulture bashkëkohore kërkimi shkencor. Përmes të punuarit ngushtësisht me lidershipin e universitetit vendas, skuadra më frymëzuese dhe energjike që kam takuar ndonjëherë, e që prej atëherë miq të përjetshëm, mendoj se qemë në gjendje ta kthenim kursin e anijes. Gjatë këtij procesi njoha një komunitet të madh njerëzish të mrekullueshëm, që më mësuan shumë për çfarë ishte përkushtimi i vërtetë: që nga kancelari, Desmond Tutu deri te Allisteri, njeriu që bëhej edhe ustai edhe shoferi im, kurdo që gjendesha në Cape Town.

Jozyrtarisht, kam bërë çmos për të punuar me dhe për studiuesit dhe institucionet në "Global South", duke ngritur ngadalë rrjete kontaktesh në disa vende dhe duke u përpjekur t'iu gjendesha në një sërë formash. Njerëzit që kam takuar përmes këtyre rrjeteve, zakonisht nuk kishin para të udhëtonin në konferencat, ku unë shkoja dhe as para për të blerë librat e mi. Ndaj kjo më shpie te vendimi im i dytë.

Dy. Doja ta bëja punën time të arritshme përmes qasjes së hapur dhe të krijoja mekanizma me të vërtetë demokratikë të qarkullimit dhe shpërndarjes së saj. Mbani mend çfarë thashë më herët për shkencën si e mirë e përbashkët: e kam marrë me seriozitet diçka të tillë. Ndaj, që shumë herët, fillova disa seri revistash teknike, që mundësonin botimin e materialeve cilësore, duke anashkaluar tarifën e botuesve komercialë. Dhe sapo uebi u bë faktor i rëndësishëm në tregtinë tonë, e përdora atë si formë qarkullimi dhe shpërndarjeje. Çdo gjë që shkruaj botohet fillimisht në një blog (në këtë blog) dhe mandej zakonisht zhvendoset në formatin e revistave teknike në Tilburg Papers in Culture Studies, përpara se ta gjejnë rrugën te revistat e shkencore apo librat e shtrenjtë. Gjithashtu, jam bërë anëtar që herët i platformave të shpërndarjes akademike si Academia.edu dhe ResearchGate. Dhe jam shumë krenar të shoh se një pjesë e madhe e atyre që i lexojnë dhe shkarkojnë materialet e mia janë studiues nga "Global South", ata të cilët nuk i përballojnë dot versionet komerciale të punës sime.

Por vëzhgimi im për qasjen e hapur nuk është i kufizuar vetëm te çështja e lexuesit të "Global South"-it. Vetë studentët e mi, që kanë punuar me mua në një universitet të mirëfurnizuar me burime, në një vend të kamur, nuk e përballojnë dot që t'i blejnë librat e mi. Siç e thashë më herët, biznesi i botimeve akademike është bërë faqja e zezë dhe përjashton një numër në rritje të atyre, që absolutisht kanë nevojë të kenë qasje ndaj produkteve të tij. E kam parë si

pjesë të detyrës sime që ta përmbys atë sistem, të shpërndaj dhe të përhap gjëra që zakonisht nuk janë të lira të shpërndahen ose përhapen dhe ta bëj këtë me materiale të kohëve të fundit. Pasi vënia në dispozicion gjerësisht e teksteve të vjetra është diçka e mirë dhe e dobishme, por nevoja reale e studiuesve në shumë pjesë të botës është që të kenë qasje te materialet e kohëve të fundit, të bëhen pjesë e debateve në zhvillim e sipër, ta vënë kërkimin e tyre shkencor në një vijë me atë, që diku tjetër është më përparimtari. E industria e botimit akademik bën përpjekje brilante, me të vërtetë të magjishme për ta ndaluar pikërisht diçka të tillë.

Ne nuk duhet të jemi pjesë e asaj industrie, nuk duhet të jemi avokatët e saj dhe nuk duhet të ndihemi të detyruar t'iu shërbejmë interesave të asaj industrie. Ne jemi forca e saj punëtore dhe i japim punë falas e të papaguar. Ne firmosim kontrata me ta, të panegociueshme zakonisht, në të cilat të gjitha të drejtat e punës sonë dorëzohen, pronësohen dhe privatizohen, në këmbim të një numri doi dhe të një pdf-je. Shfrytëzohemi prej asaj industrie deri aty sa shumë prej njerëzve të tjerë të ftilluar iu duket diçka e tillë qesharake. Si akademikë, ne e kemi një ide për audiencat e punës tonë, që është shumë më e përpiktë se e cilitdo oficer marketingu në një firmë botimesh akademike. Dhe neve na duhet thjesht një uebsajt për të publikuar punën tonë, kur është gati për botim, duke e ofruar atë pa pagesë pa kufizime për ta ndarë me çdokënd të interesuar për të, dhe jo te të gjithë ata që kanë paguar një shumë parash për të.

Tre. Gjatë karrierës sime nuk kam reshtur së drejtuari audiencave joakademike. Kam mbajtur jo më shumë jo më pak se me qindra leksione, uorkshope, trajnime dhe debate publike për profesionistë dhe aktivistë në një sërë fushash si: edukim, punë sociale, shëndetësi, ligj, politikëbërje, antiracizëm, feminizëm, mbështetje për refugjatët, organizata rinore, bashkime tregtare dhe parti politike. Si rregull, e kam bërë diçka të tillë pa pagesë (shih çfarë kam thënë më lart për të dhënin mbrapsht shoqërisë) dhe përgjigjja e paracaktuar ndaj ftesave ishte "po". Gjithnjë aktivitete të tilla më janë dukur shpërblyese dhe audiencat me të cilat takohesha shpesh më përcillnin jashtëzakonisht shumë energji. Po ashtu vijova të shkruaja materiale në holandisht. Më shumë se një duzinë libra, në mos gabohem dhe pirgje artikujsh, të gjitha të shkruara për audienca të paspecializuara, shpesh mbështetur në hulumtimin që po kryeja dhe shpesh të përdorura në programe trajnimi profesional. Kjo ishte mënyra ime për t'u përpjekur të sillja shpejt shkencën e kohëve të fundit te një forum publik më i gjerë. Punonjësve socialë ose mësuesve në klasa shumëgjuhëshe nuk duhet t'iu jepet informacion, që ishte i vlefshëm një dekadë më parë; ata duhet të marrin njohuritë më të përparuara dhe interpretime të disponueshme, që t'i vënë në përdorim në praktikë.

Kam përdorur një etiketë për gjërat që i kam përmendur në këtë seksion. E kam quajtur "aktivizëm dijeje". Në një botë ku dija është më në fund më gjerësisht e disponueshme se çka qenë ndonjëherë më parë, dhe më ekskluzive dhe elitare se kurrë më parë, dija është një fushë beteje dhe ata që janë profesionalisht të përfshirë në të duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë fakt. Për mua: një qëndrim neutral ndaj dijes është i pamundur, pasi do ta bënte dijen sedative, të pafuqishme, vlerëpaktë në sytë e të ekspozuarve ndaj saj. Ndaj na duhet një qëndrim aktivist, një ku beteja për pushtet përmes dijes të jetë e angazhuar, ku dija të aktivizohet si një instrument kyç për çlirimin e njerëzve dhe si një mjet themelor i çdo përpjekjeje për të arritur një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë. Unë kam qenë profesionist i dijes, me të vërtetë. Por është më e thjeshtë të kuptoj çfarë kam bërë si profesionist, kur dikush kupton aktivizmin, që, së paku për mua, e ka bërë të vlefshëm të qenit profesionist.

*****

Do të ndalem këtu. Kam shqyrtuar katër gjëra që më janë dukur të rëndësishme, teksa hidhja vështrimin pas në karrierën time si akademik, që nisi në vitin 1988 dhe është në përfundim. Siç e thashë, kjo përmbledhje nuk duhet lexuar si principet e rëndësishme të autobiografisë së një shenjtori. Është e kuptueshme se nuk kam qenë i përkryer, kam bërë shumë gabime, kam qenë i padrejtë me njerëzit, kam bërë gabime gjykimi, ia kam lejuar vetes kënaqësinë nga kultura e yllit akademik dhe e arritjeve me tepri, që duhej t'i kisha identifikuar qysh në fillim, si sipërfaqësore dhe të parëndësishme; ndonjëherë kam qenë i lodhshëm në bashkëpunim, nervoz dhe i pakëndshëm dhe më shumë herë të tjera, e kështu me radhë. Jam një njeri i zakonshëm. Por vërtet e besoj, që mund të them, se e kam organizuar pjesën profesionale të jetës sime sipas katër pikave të diskutuara këtu dhe se përpjekja, modeste siç ishte, ma bëri atë pjesë të jetës sime të vyer. Kënaqësia që marr prej saj është e mjaftueshme për ta mbyllur atë pjesë të jetës pa brejtje ndërgjegjeje dhe pa ndjesinë e të mbeturit mbrapa apo i të qenit i mashtruar nga të tjerët. Jam i lumtur të ndaloj këtu.

PSE DUHET TË LEXOJMË ISMAIL KADARENË?

Nga David Bellos

David Bellos është profesor i letërsisë frënge dhe letërsisë krahasuese në Princeton University dhe përkthyes i shumë autorëve nga frengjishtja. I shkolluar në Oksford,Bellos është autori i biografive të Georges Perec dhe Jacques Tati, i një studimi për Romain Gary-n dhe një hyrjeje në studimet e përkthimit. Libri i tij i fundit është një studim i kryeveprës së Viktor Hygosë, *Të mjerët*.

Arsyeja kryesore dhe më e rëndësishmja pse duhet të lexojmë Ismail Kadarenë është se ai është një rrëfimtar i shkëlqyer. Rrëfen histori të mrekullueshme - dhe rrëfen shumë.

Në disa aspekte, Kadare është si Balzaku. Por Balzaku u kufizua në një vend të quajtur Paris, dhe në një kohë, në vitet 1820 (me vetëm disa ekskursione në provincat franceze dhe në Rilindje), ndërsa Kadare na çon kudo: në Egjiptin e lashtë, në Kinën moderne, në një vendpushim turistik në Balltik, në Moskë dhe Austri dhe në Perandorinë Otomane. Ka një aftësi gati si të Zhyl Vernit për të udhëtuar nëpër botë.

Nëse lexoni Ismail Kadarenë, përshkoni të gjitha epokat që nga shpikja e shkrimit: nga Keopsi që ndërton Piramidën e Madhe te debatet mbi trashëgiminë e Enver Hoxhës në Shqipërinë e viteve 1980-të, e deri te ngjarjet dhe situatat që ndodhin në Evropën Perëndimore pas rënies së komunizmit.

Numri më i madh i historive të Kadaresë ndodhin në shekujt nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë. Ngjarjet e Prilli i Thyer zhvillohen në vitet 1930, Kronikë në gurë në vitet 1940, Gjenerali i ushtrisë së vdekur në vitet 1950-të, Vajza e Agamemnonit në vitet 1970-të. Këto rrëfenja të lejojnë të lexosh historinë e Shqipërisë - dhe të botës - përmes prizmit të prozës letrare. Kjo është një arsye e fortë pse duhet ta lexoni Kadarenë, dhe pse më pëlqen kaq shumë ta bëj. Kadare ka krijuar, le të themi, një univers paralel, i cili ka një marrëdhënie të thellë me atë në të cilin jetojmë. Është e gjithë bota e kthyer në formë letrare.

Natyrisht përveçse romancier, Kadare është lëvrues i shumë gjinive. Ai është dramaturg dhe eseist, dhe për disa kohë ka qenë edhe gazetar dhe redaktor. Në fillim të një karriere të gjatë, ai u bë menjëherë i famshëm si poet - si poeti i ri i madh i Shqipërisë moderne. Por lexuesit e gjuhës angleze mund ta njohin vetëm si prozator. Kjo s'është ndonjë hata, sepse deri tani pjesa më e madhe e veprimtarisë së tij letrare ka qenë në gjininë e romanit.

Por Kadare nuk shkruan vetëm një lloj romani. Disa nga historitë e rrëfyera janë të vogla, vetëm pesë faqe të gjata, si Ëndërr mashtruese; të tjerat janë saga të mëdha që shtrihen në më shumë se pesëqind faqe. Në mes, qëndrojnë historitë e gjata, si *Vajza e Agamemnonit*, dhe pastaj janëdisa romane që Kadaresë i pëlqen t'i quajë "romane të shkurtër", (mikro-romane) siç është *Ikja e shtergut*. Ka romane me gjatësi standarde si *Prilli i Thyer,* dhe pastaj romanet-sagë, ku përfshihet *Koncerti* dhe *Dimri i Madh*. Pra, sa i përket formave të njohura romanore, është një larmi e jashtëzakonshme formash të tilla për t'u hulumtuar brenda një vepre e cila në vetvete hulumton të gjithë botën.

Është e zakonshme ta lexosh Kadarenë si shkrimtar që flet për jetën e tij në Shqipëri nën regjimin e Hoxhës. Ka sigurisht një të vërtetë në pikëpamjen që të gjitha vendet dhe kohët e ndryshme të universit të Kadaresë janë imazhe të zhvendosura të një vendi dhe kohe të veçantë. Por nuk të duhet ta dish këtë dhe as nuk ke nevojë ta vësh re në mënyrë që ta lexosh Kadarenë. Mund t'i lexosh historitë e Kadaresë thjesht si krijime letrare. Ai ka aftësinë të të ngjall kërshërinë për fantazmat, për nuset që kalojnë qindra kilometra brenda natës me një kalë që rend me galop, për të vdekur që ngrihen nga varri...dhe për të gjitha llojet e gjërave që s'para e tërheqin një lexues racional modern si unë. Por, njësimi që ai i bën mitit me folklorin dhe me portrete të mendjeve moderne dhe realiteteve vendase është aq mjeshtërore sa unë e gjej veten të zhytur në këtë lloj bote dhe kështu ndodh me çdo lexues. Universi i Kadaresë ka shumë nivele që përfshijnë atë joracional, transhendent dhe të çuditshmen.

Një nga tiparet më të goditura dhe të vazhdueshme të botës së Kadaresë është prania e përhershme e disa miteve të Greqisë së lashtë: jo të gjithë mitologjisë greke, por e atyre miteve që dramatizojnë urrejtjet familjare dhe efektin helmues, korruptues dhe të frikshëm të afërsisë me pushtetin.

Tipari i dytë që është gjithmonë i pranishëm te Kadareja janë rrëfenjat popullore ballkanase. I quaj "ballkanase" dhe jo thjesht shqiptare sepse këto rrëfenja popullore ekzistojnë edhe në shumë gjuhë të tjera të rajonit. Në të vërtetë, Kadare dramatizon pikërisht çështjen e origjinës etnike të kulturave ballkanike në romanin *Dosja H*, një nga rrëfenjat e tij më magjepsëse, mbështetur në gjetjet historike të folkloristëve amerikanë në tokat kufitare shqiptare në vitet 1930.

Veçoria e tretë mbizotëruese që dua të përmend është se Kadare hulumton gati në çdo histori të rrëfyer marrëdhëniet midis vetjakes dhe politikes. Jo politikes në kuptimin e çështjeve aktuale apo partiake-politike, por politike në kuptimin e gjerë, domethënë se si grupet dhe individët i manipulojnë të tjerët dhe ushtrojnë pushtet mbi ta.

Veçori tjetër e botës së Ismail Kadaresë - le ta quajmë Kadariana - është moti, i cili, siç kanë thënë të tjerët, funksionon pothuajse si një personazh më vete. Moti në Kadarianë është gjithmonë i kobshëm, dhe kjo e bën klimën e Skocisë të duket po aq e butë sa riviera italiane. Si lexues, mësohesh shpejt me përmasën gati komike të kronikave klimaterike të Kadaresë (mjegull, shi i imët, shtrëngatë, dëborë, mot i ftohtë, qiell me re), pasi klima e Shqipërisë është në të vërtetë më shumë si riviera italiane se sa brigjet e Loch Lomond-it. Ato s'janë përshkrime të përpikta të ndonjë skene ku ndodhin ngjarjet, por treguesit kryesor të gjendjes shpirtërore, e cila të tregon se nuk do të lexosh një histori të lumtur. Por bëjnë shumë më tepër sesa kaq: ata ju thonë se s'do të ketë asnjë shoqe flokëverdhë ndanë traktorëve shndritës që sjellin të korrat e grurit të pjekur nga dielli dhe se vepra nuk do të ketë skoda me normat e imponuara në letërsinë shqipe nga doktrinat sovjetike të realizmit socialist. Kjo është në të vërtetë një mënyrë shumë e stërholluar për të gdhendur një pozitë unike kritike brenda një shoqërie ku kritika ishte, le të themi, seriozisht e nënvlerësuar.

Shumë nga personazhet njerëzore të Kadaresë shpesh s'janë të sigurt nëse janë zgjuar apo në gjumë. Hyrjet tipike në jetën e brendshme të protagonistëve fillojnë me: "Iu duk se...", "S'ishte fort i sigurt nëse...," dhe kështu me radhë. Kufiri midis të qenit në gjendje të shohësh qartë dhe pamundësisë për ta bërë këtë s'është kurrë plotësisht i dallueshëm. Kështu kur të keni mbaruar së lexuari një roman, pavarësisht nëse është ritregimi i një legjende si *Kush e solli Doruntinën* apo rikrijimi gati historik si te *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, s'jeni shumë të sigurtë nëse keni parë apo jo një ëndërr. Kadare na shtyn vazhdimisht të vëmë në dyshim ndryshimin midis gjendjes së zgjimit dhe ëndërrimit dhe na bën të reflektojmë për mënyrat me të cilat jeta është si një ëndërr dhe në çfarë mënyre makthet janë si jeta.

Prandaj s'është për t'u habitur që *Pallati i Ëndrrave* (titulli i motërzmit të parë ishte *Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave*) është kolona qendrore e botës shumëplanëshe të trilluar të Kadaresë: një roman që në qendër të një shoqërie ogurzezë dhe të paparashikueshme autokratike ka një institucion të përkushtuar ndaj manipulimit të ëndrrave, dhe në qendër të



këtij institucioni është një i ri i ndjeshëm dhe i hutuar që me të vërtetë s'e di se çfarë po bën, ose pse përfundon duke u bërë strumbullari i të gjitha ngjarjeve.

Në fund, në rast se e gjithë kjo ju frikëson, pasi s'mund të tërhiqeni menjëherë nga mendjet e mjegullta që enden brenda dhe jashtë peisazheve të ëndrrave ku bie shi dhe dëborë, duhet të shtoj, dhe vërtet të këmbëngul që rrëfimi i Kadaresë është me të vërtetë mjaft argëtues. Duhet ta lësh veten të zhytet thellë në këtë univers paralel, por pasi ta bëni, do të zbuloni një humor dredharak, përtallës, që përcillet si nga situatat ashtu edhe nga fjalët. Ndoshta çuditërisht, stërhollimet e humorit dredharak të Kadaresë vijnë edhe në përkthim të larmishëm.

Kadare ka thënë në më shumë se një rast se lexuesit dhe kritikët e tij s'duhet t'i kushtojnë vëmendje të tepërt kontekstit. Në mbështetje të kësaj mënyre leximi, do të theksoja se mënyra e rrëfimit dhe natyra e historive që rrëfen Kadareja, s'ka ndryshuar aspak gjatë gjashtëdhjetë viteve të fundit, edhe pse konteksti shoqëror, gjeografik dhe politik ka ndryshuar në mënyrë të jashtëzakoshme. Është sikur e gjithë bota imagjinare e Kadaresë të jetëshfaqur plotësisht e formësuar që në fillim fare dhe se dyzet apo pesëdhjetë historitë dhe romanet që ai ka rrëfyer qysh atëherë s'janë veçse pjesë të një tërësie më të madhe, të ndërlidhur dhe të pandryshueshme.

Ajo që thekson ndërlidhshmërinë e opusit të veprës së Kadaresë është ripërdorimi sistematik i vendndodhjeve, objekteve, historive dhe aluzioneve. Në *Murin e Madh*, për shembull, ekziston një simbol që rikthehet tek *Ura me tri harqe*; tek *Dosja H* është një han që rishfaqet në disa histori të tjera; te *Qorrfermani*, është një djalosh që do të bëhet më vonë protagonist i *Pallatit të Ëndrrave* dhe në atë roman, këndohen disa këngë epike që na çojnë sërish te *Dosja H*... Kjo është një teknikë si e Balzakut me "personazhet e rishfaqur" në *Komedinë Njerëzore*, por për mendimin tim tek Kadareja është shumë më e mprehtë, pasi nuk lidh edhe aq subjektet rrëfimore të romaneve sesa tërë strukturën e tyre të aluzioneve dhe referencave. Kjo përbën një arritje të jashtëzakonshme, dhe gjithashtu do të thotë që secila histori që lexon nuk është vetëm ajo histori - është një kontribut në kujtesën tënde dhe në kuptimin e historive të tjera që ke lexuar, dhe forcon ndjenjën e përgjithshme se vërtet je në një botë të ndryshme që është çuditërisht si ëndërr.

Sigurisht, sa më shumë që lexon, aq më shumë përkap mijëra fije që lidhin së bashku veprat e Kadaresë. Për fat të keq, deri më sot është përkthyer në anglisht vetëm rreth një e treta e saj. Kjo është një arsye mjaft e mirë për të mësuar frëngjisht, nëse nuk provoni të mësoni gjuhën shqipe aq sa të jeni në gjendje për të lexuar këtë mjeshtër të madh të letërsisë moderne evropiane. Le të shpresojmë se është edhe një arsye mjaft e mirë për botuesit britanikë dhe amerikanë që të porosisin një mori përkthimesh të reja, pasi janë nxitur nga dhënia e Çmimit Neustadt.

Përktheu: Granit Zela

Radikalizmi i Charles Dickens

Nga GARETH JENKINS

Lektor i letërsisë angleze në Universitetin e Greenwich. Aktualisht i tërhequr në pension

Si do ta kishte paraqitur Çarls Dikens, vallë, Britaninë e sotme? Me gjithë ndryshimet e ndodhura, për të do të kishte qenë shumë i njohur ai grumbullim i paturpshëm i pasurisë, lufta e të varfërve për mbijetesë, ndarja copë-copë e mirëqënies, si edhe përbuzja e epërme e atyre që na drejtojnë.

Në kohën e vet, Dikens njihej për kumtin e tij reformues, aq sa njëri prej romaneve të tij është akuzuar për "socializëm të errët". Ai nuk tërhiqej aspak nga kasta aristrokratike që drejtonte Britaninë. Ai, siç është shprehur vetë, kishte besim tek ata njerëz që qeveriseshin, më tepër sesa tek ata njerëz që qeverisnin.

Dikens e urrente trajtimin që u bënte shoqëria fëmijëve dhe, veçanërisht, mënyrën me anë të së cilës arsimi i shndërroi mendjet e të rinjve në enë të vogla, të cilat i mbushi me lloj-lloj faktesh. Nëse ai ishte më tepër sesa krijuesi i gëzueshëm të frymës së Krishtlindjes, çfarë radikali mund të ishte Dikens?

Çarls Dikens dhe Varfëria

Vitet më formues për Dikens, kanë qenë fundi i viteve 1830 dhe fillimi i viteve 1840 – një periudhë kjo, e një shndërrimi të trazuar kapitalist të qyteteve të mëdha, e një konflikti të madh social midis forcave të ndryshme shoqërore, si edhe e një turbullimi të egër ideologjik.

Edhe vetë familja e Dikens e përjetonte, në një mënyrë të caktuar, këtë pasiguri të përhershme. Ata ishin të detyruar të lëviznin, shpesh herë, nga një shtëpi në tjetrën, për t'u shpëtuar kreditorëve të tyre. Babai i Dikens u burgos për borxhe dhe, vetë Dikens, qe i detyruar të linte shkollën për të kryer punë të rënda në një fabrikë lustrimi këpucësh.

Këto të gjitha ishin, padyshim, përvoja poshtëruese, por për të cilat Dikens ka heshtur. Në të njëjtën kohë, falë përvojës së drejtpërdrejtë, ai ishte shumë i vetëdijshëm për jetën e mjerë të të varfërve. Tmerri i vërtetë, që Dikens ndjeu nga varfëria, me të cilën u ndodh aq afër, si edhe simpatia e tij për viktimat e saj, formuan atë bosht krijues të shumicës së shkrimeve të tij. Ato, po ashtu, përcaktuan edhe radikalizmin e tij.

Në këtë botë të re borgjeze, dislokimi shoqëror krijoi gjithashtu mundësinë e përdorimit të talenteve të njerëzve, për të ecur përpara në jetë. Dikens ishte pikërisht një rast i tillë: i ngjashëm me një fabrikë letrare përbërë prej një njeriu të vetëm, ai pati sukses duke prodhuar një cikël romanesh, tregimesh të ndryshëm, si edhe duke u marrë me gazetari, që tërhoqi një rreth të ri lexuesish.

Ai s'kishte asgjë tjetër, përveç përçmimit të mirëfilltë, për atë lloj koncepti aristokratik se të fituarit e jetesës vinte si pasojë e lindjes dhe edukimit të njeriut. Në këtë kuptim, Dikens ishte një radikal i padurueshëm, që kërkonte ta nxirrte shoqërinë nga parazitizmi i mpirë, i cili e mbyste iniciativën private.

Në të njëjtën kohë, ai ishte thellësisht dyshues ndaj asaj forme tjetër radikalizmi, e përfaqësuar nga shumë të tjerë si ai, që kërkonin të reformonin rendin ekzistues. Ky ishte një radikalizëm që fokusohej në disiplinimin e të varfërve dhe shtresave të pambrojtura. Të "reformuarit" e ligjit të të varfërve dhe e shtëpive të punës, për ta bërë "mirëqenien" (në atë gjendje që ishte) sa më të pakëndshme të ishte e mundur, për ata që s'para kishin dëshirë të punonin, provokonte, në fakt, zemërimin e Dikens – siç shihet në librin "Oliver Tuist" (1839).

Kjo ishte periudha kur idetë e "tregut të lirë", së bashku me interesat kapitalistë të cilëve u shërbenin, po bënin hapa përpara. Ideja se ata që i takonin pjesës së poshtme të shoqërisë, duhet të fajësonin veçse veten e tyre për urinë që vuanin, e tronditi rëndë Dikens si një ide mizore, në një kohë kur kishte pasuri të mjaftueshme për plotësimin e nevojave të tyre

Hapja

Dikens përkrahu dhe bëri thirrje me idenë se ne të gjithë, përtej ndarjes shoqërore, ndajmë së bashku faktin se jemi njerëz. Ai mbajti këtë qëndrim, për t'iu kundërvënë asaj që po bëhej shumë shpejt një realitet i shoqërisë borgjeze: mungesa e interesave të përbashkëta që ajo shfaqte.

Thirrja e anës "së mirë" të shoqërisë borgjeze, përkundrejt anës "së keqe", është diçka që e shohim në librin "Kënga e Krishtlindjeve" (1843) dhe në mënyrën sesi Skragu i pashpirt me grushtet e fuqishëm, shndërrohet në bamirësin bujar të



të varfërve. Kjo është sentimentale, pa dyshim, por paraqet një protestë ndaj atij nocioni, se nuk kishte asnjë alternativë tjetër.

Romanet e hershëm të Dikens janë të qartë dhe episodikë. Teknika seriale e shkrimit të romaneve çdo muaj dhe, herë pas herë, edhe çdo javë, ishte një teknikë që Dikens e sajoi virtualisht, në mënyrë që të tërhiqte një audiencë të re.

Ishte kjo ajo që i dha atij mundësinë të paraqeste karaktere të reja dhe të adresonte çështje të caktuara (realiteti i një ligji të dobët apo mizoritë në fushën e edukimit, që mund të sfidonin ndjenjat dhe ndërgjegjjen e kësaj audience). Gjerësia e formës, gjithashtu, i dha atij mundësinë ta zgjeronte jashtëzakonisht botën shoqërore të romanit: të pasurit dhe gjithë ata që gëzonin begati, duhej t'u hapnin rrugë personanazheve me prejardhje nga klasat e ulëta. Zërat plebej u ngritën, që fjala e tyre të dëgjohej!

"Hapja" e shoqërisë, parë kjo, për shembull, në zhvendosjen e shkaktuar nga ndërtimi i hekurudhave në qendër të Londrës, përshkruar në mënyrë mbresëlënëse në romanin "Dombi dhe i Biri" (1848), i sjell këto zëra të përjashtuar deri atëherë, në afërsi me zërat e establishmentit. Kështu, biznesmeni kryelartë, z. Dombi, është i detyruar të dëgjojë ngushëllimet e shoferit të trenit, bashkëshortja e të cilit ka ushqyer djalin e tij që po vdiste, diçka që e ofendon ndjenjën që ai ruan për distancimin shoqëror.

Këtyre personazheve plebej, shpesh herë u mungon personaliteti apo individualiteti i përpunuar mirë. Rrethanat i kanë reduktuar ato në diçka më tepër sesa një frazë apo gjest përkufizues dhe i caktuar. Por, është mënyra me të cilën ata e shpalosin veten vazhdimisht, nëpërmjet përdorimit të tyre idiomatik të gjuhës, e cila u jep atyre jetë dhe energji.

Nëse qeniet njerëzore nuk fuqizohen, atëherë qyteti që i rrethon, mund të duket se merr një jetë më vete, sikur jetësohet nga forca që, vetë njerëzimi, nuk mund t'i kontrollojë. Ju nuk mund ta lexoni plotësisht Dikensin, pa u tronditur nga mënyra sesi romanet e tij rrokin, në formë komike apo groteske, aspektet qendrore të tjetërsimit kapitalist.

Çarls Dikens dhe Turma

Dikens, më pas, është më pak i bindur se individi mund të dalë fitimtar ndaj një shoqërie përherë e më shtrënguese. Toni i tij është më pak shpërthyes dhe komedia bëhet më e errët. Romanet e tij, shkruar ndërmjet viteve 1850 dhe 1860, kanë forma më të përmbledhura, janë më pak episodikë, ngjajnë sikur në njohje të sistemit, atij legal, gjyqësor apo financiar, ato e lidhin individin apo çdo gjest dashamirësie të tij, me pafuqinë apo edhe më keq se aq!

Në librin "Shtëpia e Braktisur" (1853), personazhet nuk mund t'u shpëtojnë kthetrave të një procesi gjyqësor, që në fakt është proces i njëanshëm për një trashëgimi. Në romanin "Dorriti i Vogël" (1857), burgosja fizike, mendore dhe gjuhësore, i mbërthen njerëzit në koncepte vdekjeprurës të asaj çfarë është sjellje e mirë dhe e duhur. Romani i fundit i plotë i Dikens, "Miku ynë i Përbashkët" (1865), e tregon shoqërinë si një grumbull pluhuri, bamirësinë si të ishte thjesht biznes, ndërsa jetimët në rrezik për t'u nxjerrë si mallra tregu (një ndryshim i thellë nga Dikens i hershëm).

Dikens haset me vështirësi, atëherë kur në vend që të flasë për të përjashtuarit, ai përballet me ç'thonë të përjashtuarit për veten e tyre. Nxitja e reformës shoqërore në emër të viktimave, apo mbrojtja e të drejtave të tyre, është njëra anë – përqëndrimi konsiston në vlerat morale dhe shpirtërore të heroit, pozicioni i të cilit edhe mund të luhatet ndërmjet të privuarve, por nuk është pjesë e tyre.

Është fare tjetër gjë, kur vetë viktimat përbëjnë një subjekt aktiv dhe nuk kanë aspak nevojë që të përfaqësohen nga ndonjë hero. Romanet më të dobët të Dikens, janë ato në të cilët viktimat paraqiten si një masë kryengritëse ose revolucionare – "Barnaby Rudge" (1841) dhe "Një tregim i dy qyteteve" (1859) — ose kur rrëfejnë mbi mundësinë për t'u

bërë një forcë sindikale kolektive (si në romanin e tij të vitit 1854 "Kohë të vështira", kushtuar "gjendjes në Angli").

Ideja e Të Qenit Zotëri

Është veçanërisht e dukshme dobësia e Dikens, lidhur me aftësinë për t'i treguar gratë sentimentale dhe për t'i idealizuar ato. Gratë reduktohen në disa lloje: fëmija nuse, figura e shenjtë, objekt i një dëshire romantike, apo "gruaja e rrëzuar". Ata veprojnë në kontekstin e idealit shtëpiak, rol që heroi e dëshiron shumë, siç ndodh, për shembull, në romanin "David Koperfild" (1850), ku fëmija nuse që sfidon intelektualisht Davidin, vdes në një mënyrë tejet të përshtatshme, për t'i hapur udhë bashkëshortes së "përsosur", që do të plotësonte arritjen e tij si shkrimtar.

Ndodh që ka personazhe gra, të cilat të bëjnë të mendosh se Dikens, në një mënyrë të vakët, ka qenë i vetëdijshëm për kompleksitetin real të jetës së gruas. Ky rast haset në romanet e tij të vonshëm, veçanërisht te "Shpresat e Mëdha" (1861), roman ku Dikens iu afrua më shumë trajtimit të natyrës problematike të heroit borgjez. Të dy romanet, "Shpresat e Mëdha" dhe "David Koperfild" përqendrohen rreth çështjes sesi mund të bëhesh një "zotëri" i vërtetë, jo thjesht për shkak të origjinës, por për shkak të arritjeve në jetë.

Mbrojtësi dhe mentori i Davidit të ri, Stirforth, mund t'i kishte hirin dhe manierat aristokratike, por ai sillet në një mënyrë egoiste dhe shkatërrimtare, veçanërisht ndaj grave. Fisnikëria e vërtetë që mëson Davidi, varet nga cilësitë borgjeze të vetëbesimit, si edhe përkushtimi ndaj idealit familjar.

Por ka një anë të keqe të përparimit borgjez, të përfaqësuar nga Uriah Hipi i "përulur", i cili duke pasur qëllim përparimin në jetë, nuk ngurron të përdorë dinakërinë, mashtrimin dhe hipokrizinë. Statuset shoqërorë të Uriah dhe David, mund të mos jenë edhe aq të ndryshëm, por neveria që David ndjen ndaj Uriah e s'mund ta përmbajë as në gjestet fizike (krejt ndryshe nga keqardhja që David ndjen për fatin e Stirforth aristokrat), tregon diçka tjetër

Ky kontrast në reagimin emocional, bën që të besojmë se natyra e vërtetë e David, e ndodhur nën aksidentet e privimeve të hershëm dhe varfërisë, është një natyrë e fisme: ai asnjëherë nuk mund të sillej si Uriah.

Kritika Sociale

Te "Shpresat e Mëdha", që pa dyshim është romani më i shquar i Dikens, fisnikëria e brendshme shqyrtohet në një mënyrë më kritike, nëpërmjet eksplorimit kërkues të turpit dhe të pasojave që ka një person, i cili mohon origjinën e tij.

Pipi jetim, ndryshe nga David që mbeti jetim, është me një origjinë vërtet modeste: mbajtësi i shtëpisë, Joe Gargery, punon si kovaç. Ajo që e shtyn Pip të bëhet zotëri, nuk është aspak ideali borgjez i punës së palodhur dhe as morali i ndriçuar, por turpi i thellë për statusin e tij social, si edhe supozimi i pabazë (por mjaft tregues), se origjina e fshehtë e prejardhjes së tij, i takon një plani më të lartë social.

Përfundimisht Pip e mëson burimin e vërtetë të pasurisë së tij: jo znjsh. Haversham, aristokratja e rënë nga vakti, por kishte qenë i dënuari Maguiç, të cilin Pip e kishte ndihmuar kur kishte qenë i vogël. Kur Maguiç kthehet fshehurazi nga kolonia ndëshkuese e Australisë, për të parë e takuar zotërinë që kishte krijuar vetë, Pip realizon me tmerr se ishte kthyer në një lloj përbindëshi të Frankenstein (Dikens i referohet historisë) — në një përbindësh mosmirënjohës.

Duke hedhur poshtë të kaluarën e tij (që shihet fare qartë në episodin kur Pip vizitohet në Londër nga Joe dhe ndjehet thellësisht i turpëruar, që detyrohet ta pranojë njohjen e tyre), ai aty sakrifikoi njerëzillëkun e vet!

Nuk ka kthim prapa. Këtë herë të vetme, Dickens përmbahet që të mos krijojë një fund sentimental. Pip mund të jetë penduar, por ajo që u prish, nuk mund të ndreqej më. Estela, gruaja që ai dashuron dhe përbuzja e së cilës për një djalë që ishte thjesht një punëtor dhe aq njeri ordiner, i nxitur nga dëshira rinore për të ecur përpara në jetë, kishte mbetur edhe ajo vetë po aq e zhveshur nga bujaria, sa edhe ai.

Dikens e lë të paqartë nëse ata martohen, apo jo. Fundi i parë i lë ata të ndarë; ai i dytë, i botuar, është ambivalent. Ky është një roman, që nuk i lë vend besimit se, ajo që është njerëzore, mund të shpëtohet nga shoqëria borgjeze – një ndjesi kjo, që ia vlen të mbahet edhe sot parasysh.

Përktheu S. Haxhimusaj

Luljeta Lleshanaku nominohet për çmimin "Poeti Europian i Lirisë"

Në përbërje të jurisë është edhe Olga Tokarczuk, fituese e Nobel-it në letërsi

Pak ditë më parë, u bë publik, lajmi se poetja e njohur Luljeta Lleshanaku është nominuar për çmimin "Poeti Europian i Lirisë", organizuar nga qyteti Gdańsk në Poloni. Fituesi i këtij çmimi të një rëndësie të veçantë do të përzgjidhet nga një juri, në përbërje të së cilës është edhe Olga Tokarczuk, fituese e Nobel-it në letërsi për vitin 2018. Gjithashtu, në juri do të jenë edhe Krzysztof Czyżewski (Kryetar), Paweł Huelle, Zbigniew Mikołejko, Stanisław Rosiek, Anda Rottenberg dhe Beata Stasińska.

I ndarë për herë të parë në vitin 2010, çmimi "Poeti Europian i Lirisë" i jepet një poeti të gjallë nga Europa i cili, sipas jurisë, ka përshkruar lirinë në mënyrën më origjinale. Ai synon të nderojë dhe promovojë fenomenet në poezi që trajtojnë lirinë, një nga temat më thelbësore për lexuesin bashkëkohor si dhe karakterizohen nga vlera të jashtëzakonshme artistike.

Është pikërisht qyteti i Gdańskit që e ndan çmimin, pasi ai krenohet me traditën e tij në luftën për liri, në reflektimin e vërtetë të këtij nocioni si dhe në mbështetjen e pakursyer të dhënë atyre aktiviteteve që lirinë e konsiderojnë parësore.

Edhe në edicionin e tij të dytë, Luljeta Lleshanaku ka qenë nominuar, atëherë me "Fëmijët e natyrës". Ndonëse atë vit Lleshanaku nuk fitoi, përkthyesja e saj Dorota Horodyska u nderua me një çmim elitar nga revista letrare polake "Letërsia në Botë" pikërisht me "Fëmijët e natyrës" si përkthimi më i mirë i poezisë në polonisht.

Deri më datë 31 korrik, përkthyesja ka afatin për të përfunduar gjithë punën e saj, pasi librat e pesë finalistëve do të botohen në muajt tetor – dhjetor të këtij viti. Ndërsa finalja në Gdańsk do të jetë në mars, 2022.

Përgjatë viteve, këtë çmim e kanë fituar poetë të njohur si Uladzìmìr Arloŭ, Durs Grünbein, Dorta Jagić, Ana Blandiana, Alice Oswald dhe Sinéad Morrissey.

Rreth këtij nominimi, Lleshanaku tha për ExLibris:

"Në 2012, unë e konsiderova kapitull të mbyllur punën e çmimeve në Gdańsk, por ja ku jemi prapë… Natyrisht që ndjehem mirë që jam midis finalistëve, sepse çdo herë që futesh në garë, bën një lloj testimi të vetes; gjërat lëvizin, ndryshojnë, madje shumë shpejt, e kështu edhe shijet e lexuesit, dhe ti nuk e di kurrë nëse je në kohë si autor. Nga ana tjetër, ky konkurs zhvillohet në Poloni, në vendin që gjatë shekullit XX i ka dhënë botës katër poetë të mëdhenj: Szymborkskën, Herbertin, Mikloszin dhe Zagajewskin, kështu që po konkuron në një vend me një traditë nga më të mirat poetike.

Vështirësia e kësaj gare është se përveçse të jetë e pëlqyer, poezia duhet edhe të trajtojë temën e lirisë, por të lirisë në botën moderne, një koncept që fillon te liria politike dhe mbaron te liria seksuale. Natyrisht, të gjitha poezitë në një mënyrë a në një tjetër, sikur të çojnë te liria, por në këtë rast ky element duhet të jetë i prekshëm dhe i zhvilluar mirë. Kur i kam shkruar poezitë, natyrisht që nuk kam pasur asgjë të tillë në mendje, por duke i parë nga ky këndvështrim, tani, përveç temës së lirisë politike (sidomos tek "Ujë dhe karbon"), mendoj se ka diçka tjetër, pak më të veçantë si temë dhe që përbën një nga konfliktet e brendshme të njeriut modern: liria dhe identiteti. Zhvillimi i vrullshëm i teknologjisë së informacionit, nxori në mënyrë të ndjeshme në pah nevojën e vjetër të individit për identitet: facebook-u, instagrami, televizioni me prirjet e veta drejt reality show-t … Vetë historia e eksploratorëve të Polit të Jugut te "Homo Antarcticus", qe një model se si çlirimi nga identiteti dhe statusi social, e zgjeron lirinë deri në pakuptimësinë e saj, deri në absurditet.

Mendoj se kam qenë me shumë fat që përkthyesja ime është Dorota Horodyska dhe i jam mirënjohëse që ka zgjedhur poezitë e mia për konkurim. Me Dorotën njihem prej 10 vjetësh, e njoh mënyrën se si punon dhe tashmë e di që nëse diçka nuk do të funksionojë, nuk do të jetë për shkak të përkthyesit. Dhe si çdo herë tjetër, uroj të jetë një garë e pastër, se për ndryshe çfarë kuptimi ka e gjitha kjo?!"

Eveline

tregim nga

James Joyce

E ulur pranë dritares ajo vështronte mbrëmjen që kaplonte rrugën e madhe. Koka i mbështetej në perdet e dritares, ndërkohë që në flegrat e hundës kishte depërtuar një erë e fortë kretoni të përhimët. Ishe e lodhur.

Të pakët ishin ata që përshkuan rrugën. Personi që jetonte në godinën e fundit, po kthehej në shtëpi; ajo dëgjoi hapat e tij tek trakullinin në trotuarin e betonuar, e më pas, tek kërcisnin mbi rruginën e shtruar me skorje qymyri të djegur që të çonte drejt shtëpive të kuqe të sapo ndërtuara. Dikur aty kishte pasur një fushë në të cilën, çdo mbrëmje, ne luanim me fëmijë të tjerë. Më vonë, dikush nga Belfast-i e bleu fushën dhe ndërtoi aty shtëpi – jo si ato shtëpitë e vogla ngjyrë kafe, por shtëpi me tulla të ndritshme dhe çati që shkëlqenin. Fëmijët që banonin buzë rrugës së madhe – ata të familjes Devine, Water, Dunn, uloku i vogël Keogh, ajo, si edhe vëllezërit e motrat e saj – e kishin bërë zakon të luanin te fusha së bashku. Ernest-i, gjithsesi nuk luante kurrë: mosha, tepër e madhe që ai kishte, bëhej pengesë për të. Shpeshherë, babai i saj i dëbonte fëmijët nga fusha me një thupër kullumbrie në dorë; zakonisht, vogëlushi Keogh, bënte roje dhe njoftonte sa herë që ai shquante babanë e saj të vinte drejt tyre. Sidoqoftë, dukej se ata ishin mjaft të kënaqur. Në atë kohë, babai i saj nuk ishte dhe aq i keq; veç kësaj, mamaja ishte akoma gjallë. Vitet rrodhën. Ajo, bashkë me vëllezërit dhe motrat u rritën, mamaja ndërroi jetë. Tizzie Dunn ndërroi jetë, gjithashtu; ndërkohë, familja Waters u kthye në Angli. Çdo gjë ndryshon. Tashmë kishte ardhur radha e saj që të largohej, ashtu si edhe të tjerët, të ikte nga shtëpia.

Shtëpia! Ajo hodhi një vështrim përqark dhomës, tek pa edhe një herë tjetër të gjitha orenditë e njohura që i kishte pastruar një herë në javë për kaq vite me radhë, pa ditur ama ta shpjegonte se nga vinte gjithë ai pluhur. Ndoshta, orenditë e shtëpisë, nga të cilat asnjëherë nuk kishte ëndërruar të ndahej, nuk do t'i shihte më kurrë. Megjithatë, gjatë gjithë këtyre viteve, ajo nuk kishte mundur ta mësonte emrin e klerikut, fotografia e zverdhur e të cilit qëndronte varur mbi mur sipër harmoniumit të prishur, përbri një kopje të stampuar me premtimet që i drejtoheshin Shenjtores Margaret Mary Alacoque. Kleriku kishte qenë shok shkolle me babanë e saj. Sa herë që fotografinë ia tregonte një vizitori, babai ia kalonte atij në dorë duke shtuar fjalë të rastit:

'Tani ai ndodhet në Melbourne.'

Ajo kishte dhënë pëlqimin e saj për t'u larguar, për të ikur nga shtëpia. A ishte ky një veprim i mençur? Ajo u përpoq t'i peshonte mirë të dy anët e çështjes. Gjithsesi, strehimin dhe ushqimin i kishte të siguruar në shtëpi; aty kishte dhe njerëzit e vet të cilët i kishte pasur pranë gjithë jetën. Sigurisht, ishte e detyruar të bënte shumë punë në shtëpi, por edhe të punonte me këmbëngulje. Çfarë do të thonin për të në dyqanin ku punonte në çastin që do ta merrnin vesh se ajo ishte rrëmbyer me pëlqim nga një djalë? Ndoshta do të thonin se ishte një budallaçkë; dhe me anën e një njoftimi në gazetë, vendin e saj të punës do ta zinte një tjetër. Zonjusha Gavan do të gëzohej. Ajo gjithmonë kishte pasur epërsi ndaj saj, veçanërisht në rastet kur të pranishëm ishin edhe njerëz të tjerë, të cilët dëgjonin.

'Zonjusha Hill, a nuk e shikoni që zonjat po presin?'

'Gjallërohu pak, zonjusha Hill, ju lutem.'

Ajo nuk kishte ndërmend që të derdhte lot pasi të largohej nga dyqani.

Por në shtëpinë e saj të re, në një vend të largët e të panjohur, gjërat do të ishin ndryshe. Më pas, do të martohej – ajo, Eveline. Njerëzit do ta respektonin. Ajo nuk do të trajtohej ashtu siç ishte trajtuar mamaja e saj. Madje edhe tani, ndonëse i kishte mbushur të nëntëmbëdhjetat, ajo ndjente rrezikun e një dhune të mundshme nga ana e babait. Ishte e vetëdijshme se një mendim i tillë i shkaktonte regëtima në zemër. Deri para disa vitesh, ai kurrë nuk i ishte vërsulur asaj siç i ishte sulur Harry-t dhe Ernest-it, ngaqë ajo ishte vajzë, por kohët e fundit ai kishte filluar ta kërcënonte, t'i thoshte se çfarë do t'i punonte për hir të nënës së saj që nuk jetonte më. Njeri që ta mbronte nuk kishte. Ernesti kishte vdekur, kurse Harry, i cili merrej me mirëmbajtjen e kishave, pothuajse gjithmonë ishte diku në jug të vendit. Veç kësaj, zënka e përhershme për para të shtunave në mbrëmje kishte filluar ta lodhte në mënyrë të papërshkrueshme. Ajo, gjithmonë, rrogën e saj e jepte të plotë në shtëpi – shtatë shilinga – ndërsa Harry dërgonte aq sa kishte mundësi; çështja ishte se, t'i merrje mbrapsht të holla babait, ishte problem. Ai thoshte se ajo i bënte paratë rrush e kumbulla, se ishte pa mend në kokë, dhe se paratë që ai i kishte fituar me vështirësi nuk kishte ndërmend t'ia jepte asaj që ajo t'i harxhonte lart e poshtë, e shumë të tjera kësisoj; natën e çdo të shtune ai shndërrohej në një njeri mjaft të lig. Më në fund, ai i jepte asaj një shumë dhe e pyeste nëse kishte ndërmend ta bënte pazarin për drekën e së dielës. Më pas, asaj i duhej të vërshonte jashtë sa më shpejt që të ishte mundur për të bërë pazarin, shtrëngonte fort kuletën e lëkurës në dorë, hapte rrugën me bërryla në mes të turmës, dhe nën peshën e ushqimeve të blera kthehej vonë në shtëpi. Ajo ishte e detyruar të punonte shumë për ta mbajtur shtëpinë në rregull, si edhe për t'i marrë masat që të dy vëllezërit e vegjël që i kishte në ngarkim të shkonin në shkollë rregullisht, pa harruar që ata ta merrnin ushqimin e duhur me vete. Ishte punë e vështirë – jetë e vështirë – por tani që ishte gati për ta braktisur atë jetë, ajo nuk iu duk dhe aq e padëshirueshme.

Së shpejti, ajo do të zbulonte një jetë të re me Frank-un. Ai ishte shumë i sjellshëm, burrëror, dhe i çiltër. Kishte rënë dakord që, bashkë me Frank-

un, të nisej me anijen e mbrëmjes për t'u bërë bashkëshortja e tij, por edhe për të jetuar me të në Buenos Ayres ku ai kishte dhe shtëpinë e vet që po i priste. Sa mirë që e mbante mend momentin kur e kishte parë për herë të parë; ai kishte marrë me qira një dhomë në një shtëpi që ndodhej në qoshe të rrugës ku ajo shkonte për të vizituar të njohur. Dukej sikur kishin kaluar vetëm pak javë. Ai po qëndronte tek porta e jashtme, kasketën e kishte shtyrë pas koke, ndërsa flokët i binin mbi fytyrën e bronztë. Më pas, ata u njohën me njëri tjetrin. Çdo mbrëmje ai e priste vajzën jashtë dyqanit dhe e përcillte atë deri në shtëpi. E ftuar nga ai, vajza u ngazëllua kur pa shfaqjen Vajza Boheme, sepse ishte ulur pranë tij në një pjesë të teatrit ku nuk kishe pasur rastin të ulej më parë. Ai ishte shumë i dhënë pas muzikës, ndaj dhe këndonte pak. Të gjithë e dinin se ata ishin në fazën kur kërkonin t'ia fitonin zemrën njeri tjetrit, kështu që kur ai këndonte për vashën që kishte rënë në dashuri me një marinar, ajo gjithmonë, këndshëm, e humbte toruan. Me shaka, ai e thërriste Poppens. Në fillim, ajo ndjehej e entuziazmuar që kishte të bënte me një djalë të ri, më pas, filloi ta pëlqejë. Ai dinte shumë histori për vendet e largëta. Kishte filluar si marinar i thjeshtë, për një stërlinë në muaj, në një anije që i përkiste shoqërisë Allan Line dhe që bënte udhëtime drejt Canada-së. Ai i tregoi asaj emrat e të gjitha anijeve në të cilat kishte punuar, si edhe emrat e shërbimeve të ndryshëm. I tha se kishte kaluar përmes Ngushticës së Magelan-it, por i tregoi edhe histori për patagonianët e tmerrshëm. Në Buenos Ayres i kishte ecur, u shpreh ai, ndërsa në atdhe ishte kthyer për pushime. Natyrisht, babai i saj kishte marrë vesh për marrëdhëniet e dashurisë midis tyre, ndaj e kishte ndaluar të bijën që të takohej me të.

'I njoh unë këta djemtë marinarë,' u shpreh ai.

Një ditë, ai bëri sherr me Frank-un; pas asaj ndodhie, ajo u detyrua që të dashurin ta takonte fshehurazi.

Në mbrëmje, jashtë u terratis. Bardhësia e të dyja letrave, të cilat pushonin në prehrin e saj, u zbeh. Njëra letër i drejtohej Harry-t; tjetra babait. Ernest-i kishte qenë i preferuari i saj, por edhe Harry-n e pëlqente. Ajo vuri re se babai kishte filluar të plakej; ajo do t'i mungonte. Herë pas here ai bëhej shumë i mirë. Para pak kohësh, kur ajo kishte qëndruar një ditë e sëmurë në shtrat, ai i kishte lexuar një histori me fantazma dhe i kishte përgatitur një sanduiç me bukë të thekur në zjarr. Një ditë tjetër, kur mamaja ishte akoma gjallë, të gjithë kishin shkuar në Hill of Howth. Ajo solli në mend çastin kur babai kishte veshur kapelën e mamasë për t'i bërë fëmijët të qeshin.

Koha po kalonte shpejt, por ajo vazhdoi të qëndrojë e ulur pranë dritares, me kokën të mbështetur te perdet tek thithte ajrin bashkë me erën e fortë të kretonit të përhimët. Diku nga fundi i rrugës dëgjohej muzika e një organo. Melodinë e njihte mirë. Ishte çudi, ama, që ajo po dëgjohej atë natë, si për t'ia kujtuar premtimin që i kishte dhënë mamasë, premtimin se shtëpinë do ta mbante të bashkuar për aq kohë sa të kishte mundësi. Asaj iu kujtua nata e fundit e sëmundjes së mamasë; në kohën që mamaja qëndronte e mbyllur në dhomën e errët në anën tjetër të sallonit, veshi i kishte kapur një melodi melankolike italiane. Muzikanti që lunate në organo ishte urdhëruar të largohej që andej pasi kishte marrë gjashtë pence. Asaj i erdhi ndër mend momenti kur babai, i krekosur, ishte futur në dhomën ku ishte mamaja e sëmurë, dhe kishte thënë:

'Mallkuar qofshin italianët. Kanë zbritur të gjithë këtu!'

Tek bluante këto në mendje, vegimi i mëshirshëm i jetës së mamasë i lidhi magji në të gjithë qenien e vet – një jetë me sakrifica të zakonshme që i afrohej cakut të një marrëzie përfundimtare. Ajo u drithërua kur dëgjoi sërish zërin e mamasë që me këmbënguljen e një të marre thoshte:

'Derevaun Seraun! Derevaun Seraun! Pas Kënaqësisë, Vjen Dhimbja!'

Ajo kërceu në këmbë me një vrull të papritur terrori. Mbathja! Duhej t'ia mbathte! Frank-u do ta shpëtonte. Ai do t'i jepte asaj jetë, dhe ndoshta dashuri gjithashtu. Ajo donte të jetonte. Përse vallë duhej të ishte fatkeqe? Ishte e drejta e saj të bënte një jetë lumtur. Frank-u do ta merrte në krahët e tij, do ta mbështillte në krahët e tij. Ai do ta shpëtonte.

Ajo qëndroi në mes të turmës që kolovitej, sa nga njëra anë në tjetrën, brenda stacionit të portit në North Wall. Ai e mbante nga dora; ajo e kuptonte se ai po i fliste, dhe në mënyrë të përsëritur po i thoshte diçka në lidhje me udhëtimin me anije. Stacioni ishte i mbushur me ushtarë të pajisur me çanta të mëdha. Përmes dyerve të gjëra të stacionit të udhëtarëve, asaj i kapi syri masën e zezë të anijes që mbështetej në murin e kalatës, dhe që dritaret e rrumbullakta të kabinave i kishte të ndriçuara. Ajo nuk u përgjigj. Preku me dorë fytyrën e saj të zbehtë e të ftohtë dhe iu lut Zotit që t'ia tregonte rrugëdaljen nga ai labirint pikëllimi, por edhe që t'ia përcaktonte se cila ishte detyra e saj. Anija shfryu një sirenë të trishtueshme nëpër mjegull. Nëse nisej, të nesërmen do të ishte në mes të detit me Frank-un, në anijen avullore që do të lundronte drejt Buenos Ayres-it. Biletat e anijes ishin porositur. A kishte ajo akoma mundësi të tërhiqej mbrapsht pas gjithë atyre gjërave që ai kishte bërë për të? Angështimi zgjoi një të pështjellë në trupin e saj, ndërsa buzët vazhdoi t'i lëvizte tek bëri një lutje të qetë e të zellshme. Një zile vringëlloi në zemrën e saj. Ajo ndjeu që ai ia shtrëngoi dorën fort:

'Eja!'

Të gjithë detet e botës u shembën me forcë në zemrën e saj. Ai po e tërhiqte atë drejt atyre deteve: ai do ta mbyste. Me të dyja duart ajo u mbajt te kangjellat e hekurta.

'Eja, pra!'

'Jo! Jo! Jo! Ishte e pamundur. Duart e saj rrokën hekurin; ajo vet dukej si një e ndërkryer. Në drejtim të të gjithë deteve ajo lëshoi një britmë ankthi.

'Eveline! Evvy!'

Ai mori rend përtej derës së kontrollit të biletave dhe i thirri asaj që ta ndiqte. Ai dëgjoi një zë që i thoshte të vazhdonte, megjithatë ai përsëri e grishi atë. E plogët, si një kafshë e pashpresë, ajo kthehu fytyrën e zbehur nga ai. Sytë e saj nuk shprehnin asnjë shenjë dashurie, lamtumire apo miratimi.

Përktheu: Aristidh Shqevi
Oslo, 14.01.2021



ERMIR NIKA

Fillimet e modernitetit në prozën romanore shqipe



Onufri